


E lindur në vitin 1961 në Martinaj të Plavë-Gucisë – është artiste multidisciplinare dhe profesoreshë e pikturës, me bazë në Prishtinë. Prelvukaj ka ekspozuar punën e saj në galeri të panumërta kombëtare dhe ndërkombëtare, veprat e saj janë pjesë e koleksionit të Muzeut Kombëtar të Grave në Art në Washington D.C., Galerisë NW në Cambridge dhe Galerisë Kombëtare të Kosovës. Ka kuruar ekspozita, shkruan shkrime kritike për artin, disa prej tyre të botuara në gazeta vendore. Po ashtu, ka realizuar murale, kostumografi dhe skenografi, art publik dhe ekspozita.

ZAKE PRELVUKAJ REVOLUARTI

Bisedoi: Fatlum Mehulli

(fq. 2)



Kaman Aliko, një humbës i madh!

Nga Agron Xoxa (fq. 8)

Baritoni Kaman Aliko ka realizuar kryerole në opera, si ai i Don Basilio, ("Il barbiere di Seviglia"), Gjon Flamura ("Skënderbeu"), Gjini ("Mrika"), Nourabad ("Peshkatarët e perlave"). Ka interpretuar edhe në "Carmen" "Traviata", "Rigoletto", "Tosca" etj.

Mynxyrat e kritikës letrare

Nga Agim Vinca (fq. 9)

SHËNIME MBI LIBRAT

Mbi Visar Zhitin

Kur shkrimtaria i ngjan një lutjeje për liri

Nga Rahim Ombashi (fq. 5)

Rreth romanit të Mehmet Krajës

Fenomeni Bukovski në romanin "Im atë donte Adolfin"

Nga Qazim Muja (fq. 7)

Libri i ri "Dhimitër S. Shuteriqi, rilindasi i fundit dhe regjimi komunist" i Dashnor Kaloçit

Një monografi antologjike dhe dokumentare për eruditin e kohërave të zymta

Nga Dr. Aleksandër Çipa (fq. 10)

"Prekje në mjegull" i Armela Hysit

Libër i dhimbjes globale

Nga Thanas Medi (fq. 11)

Vështrime semiotike për romanin "Gega i Motit"

Nga Viktor Gjokolaj (fq. 18)



Libri "Jam mysliman" i Ben Blushit

Midis Shillës dhe Karibdës

Nga Zija Vukaj

Libri "Jam mysliman" erdhi si një vepër e guximshme, kundërthënëse e deri Ldiku "e papritur" për lexuesit shqiptarë. Autori Blushi, me intuitën e një romancierit virtuoze ka luajtur që në fillim një lojë të hollë dhe elegante, një *trompe-l'œil*, duke "rrezikuar" me titullin deklarativ, kallëzuesor dhe gati të çuditshëm: "Jam mysliman". (fq. 6)

Më 15 korrik 1904
Anton Çehov u nda nga
jeta në Gjermani

Hajnrih Bël për Çehovin

Zhan Pol Sartri: "Përse e refuzova Çmimin Nobel"

Deklaratë për gazetarët
suedeze, Paris, 23 tetor 1964



BIBLIOTEKË

— Arben Bllaci (fq. 12)

Tabuti i Kristo Kromidhës

— Petro Çerkezi (fq. 14)

Më lëndon gëzimi yt

— Zylfi Tola (fq. 15)

Vajza nga Kolonja...

— Ndue Dedaj (fq. 19)

Ati ynë që je në tokë

— Biser Mehmeti (fq. 20)

Drita e zezë

— Arben Meksi (fq. 23)

Karikatura e së shtunës

Fundviti i studimeve në
Beograd dhe afrimi me Jakovin

Nga Dhurata Xoxa (fq. 16)


Poezia, hapësirë e lirisë,
dritës dhe dashurisë

Nga Ndue Ukaj (fq. 21)

Libri shqip në SHBA & KANADA

Dërgesa të shpejta
dhe të sigurta

www.albibris.al



F. M.: Vitet '90 në Kosovë ishin kohë izolimi, pasigurie dhe mungese të hapësirave institucionale për kulturën. Si i kujtoni ato vite si artiste? Çfarë ju shtyu të vazhdonit të krijonit në një realitet aq të vështirë?

Z. P.: Mendoj se njeriu, e sidomos artisti, ka nevojë të provokohet nga koha në të cilën jeton. Ajo që kemi përjetuar ne në vitet '90, në moshë të re, ka qenë një realitet krejt i veçantë dhe kjo është reflektuar natyrshëm edhe në artin që krijojmë. Duke e parë sot nga distanca kohore, mund të them se shumica e shprehjeve artistike të asaj kohe kishin një dimension të fortë konceptual. Krijonim performanca, ekspozita dhe forma të ndryshme të shprehjes që lindnin drejtpërdrejt nga rrethanat në të cilat jetonim.

Vitet '90 ishin një rrëmujë e madhe në kuptimin politik e shoqëror, por paradoksisht ishin edhe vite me energji të jashtëzakonshme krijuese. Kishte gazetarë të huaj, kishte lëvizje, kishte komunikim dhe, mbi të gjitha, kishte vende ku arti merrte frymë. Një fat i madh për ne ishte ekzistenca e kafiterive, sepse aty ndodhte gjithçka. Ato u shndërruan në qendra të jetës urbane dhe kulturore. Nuk bëhej fjalë për art digjital apo për format që njohim sot. Ishte art i pastër, me të gjitha shprehjet e tij multidisiplinare.

Më kujtohet veçanërisht periudha kur, rreth viteve 1995–1996, u hap “Hani i 2 Robertëve”. Ishte një hapësirë e vogël, një kafene-restorant, por aty zhvillohej një pjesë e rëndësishme e jetës artistike dhe kulturore. Aty diskutonim, ekspozonim, eksperimentonim me ide dhe ndërtonim forma të reja të mendimit artistik.

F. M.: Kur galeritë dhe institucionet mungonin, arti gjeti strehë në hapësira alternative dhe forma të improvizuara ekspozimi. A e përjetuat këtë si kufizim apo si një lloj lirie të re krijuese?

Z. P.: Singerisht, nuk e kam përjetuar si kufizim. Përkundrazi, mendoj se ajo periudhë na dha një liri të jashtëzakonshme krijuese. Në vitin 1997 realizova një performancë para Shtëpisë së Mallrave, ku e lyva trupin tim me ngjyrë të zezë. Shumë njerëz e kanë parë atë vepër vetëm si art feminist, por për mua ajo ishte shumë më tepër. Natyrisht që reagimet nuk munguan. Kishte njerëz që thoshin: “Nuk të merr kush për grua”, apo komente të tjera të ngjashme. Por pikërisht ajo forcë e brendshme për të cilën folëm më herët të shtynte të krijoje edhe më shumë. Sa më i madh presioni, aq më e madhe dëshira për të bërë art.

Arti i asaj kohe nuk ishte vetëm art revolte apo rezistence. Edhe kur trajtonte këto tema, ai e bënte në mënyra origjinale, pa kopjuar askënd. Kishte individualitet dhe karakter. Sot informacioni qarkullon me shpejtësi dhe gjithçka mblidhet në një vend, ndërsa atëherë secili formësohej më shumë nga përvoja e vet.

F. M.: Në veprat tuaja, trupi nuk paraqitet vetëm si figurë, por si një hapësirë ku ndërthuren kujtesa, politika dhe përvoja njerëzore. Çfarë ju ka tërhequr drejt këtij mediumi?

Z. P.: Një nga simbolet që më ka provokuar më së shumti gjatë krijimtarisë sime është X-i, të cilin e kam trajtuar pothuajse si një ekuacion filozofik dhe artistik. Forma që kam përdorur shpesh lidhet me këtë simbol, sepse trupi i femrës për mua nuk duhet të shihet vetëm si një trup i bukur për t'u vizatuar. Ai është natyrë, përvojë, kujtesë dhe bartës i shumë kuptimeve të tjera.

Në këtë qasje ndërthuren disa koncepte. Njëri prej tyre lidhet me aktin performativ si formë revolte, një proces që e kam rikthyer herë pas here, zakonisht çdo tre deri në pesë vjet. Arsyeja është e thjeshtë: çdo njeri në këtë planet lind për të vdekur. Edhe trupi i femrës, pavarësisht të gjitha metodave moderne

ZAKE PRELVUKAJ REVOLUARTI

Bisedoi: Fatlum Meholli

që synojnë ta sfidojnë kohën, ndryshon vazhdimisht. Një ditë i themi mirëseardhje jetës, ndërsa gradualisht mësojmë t'i themi edhe lamtumirë.

F. M.: A ju ka ndodhur ndonjëherë që publiku të fokusohet më shumë te trupi sesa te mesazhi artistik? Si e përjetoni një keqlexim të tillë?

Z. P.: Po, e kam pritur një gjë të tillë dhe është e vërtetë që shumë njerëz i kanë parë disa prej veprave të mia pikërisht në atë mënyrë. Megjithatë, ata që merren me art, që vizitojnë ekspozita, lexojnë dhe e ndjekin procesin artistik, zakonisht e kanë kuptuar mesazhin që kam dashur të përcjell.

Kam qenë shpesh e keqkuptuar, por në të njëjtën kohë jam befasuar pozitivisht nga reagimet e publikut. Më kujtohet një ekspozitë për të cilën do të flasim më vonë, ku në mesin e vizitorëve ishte një burrë i moshuar, i veshur me tesha kat dhe me plis. Në fund të ekspozitës ai erdhi dhe më përqafoi. Kishte jetuar për vite të tëra në Gjermani si punëtor krahu dhe reagimi i tij më la mbresë të jashtëzakonshme. Kjo më ka bindur se arti mund të komunikojë me njerëz shumë të ndryshëm, pavarësisht prejardhjes apo profesionit të tyre. Asnjëherë nuk kam krijuar për t'u përshtatur pritjeve të të tjerëve. E kam bërë atë që kam ndjerë, pa u ndikuar nga paragjykimet apo nga presioni i jashtëm, kam thënë thjesht: “Dua ta bëj”, dhe pastaj e kam bërë.

F. M.: Pas luftës duket se në krijimtarinë tuaj ndodh një zhvendosje nga urgjenca e rezistencës drejt eksperimentimit artistik. Si e përjetuat atë periudhë dhe çfarë ndryshoi në mënyrën se si iu qasët artit?

Z. P.: Pas luftës filluam të punonim edhe me medime të reja, përfshirë në një masë edhe kompjuterin. Për mua, kthimi pas luftës ishte një moment shumë i veçantë. Në atë kohë kisha punuar për organizatën “Save the Children” në Mal të Zi, si mbikëqyrëse, dhe kisha qëndruar edhe në Sarajevë. Vitet '90 i kam të dokumentuara me kujdes dhe gjithmonë kam ndjerë nevojën t'i ruaj jo vetëm ngjarjet, por edhe peizazhin vizual të asaj kohe.



Kur u ktheva, doja të dokumentoja gjithçka: natyrën, ambientin, ndryshimet që kishin ndodhur. Fotografitë e para që realizova ishin në Pejë. Më kujtohen disa lule të verdha, peizazhe dhe fragmente të jetës së përditshme që më tërhoqën vëmendjen menjëherë pas kthimit. Por ajo që më provokoi më së shumti ishin grafitet. Shprehje si “Mo e prekl” dhe “Shpija jeme” më ngacmuan thellë si artiste.

Menjëherë pas luftës dola në terren, fillimisht në Drenicë dhe më pas në shumë zona të Pejës. Pashë grafitet nga më të ndryshmet. Disa prej tyre ishin jashtëzakonisht domethënëse, ndërsa të tjera pasqyronin revoltën e njerëzve. Megjithatë, ajo që më interesonte ishte të mos binim në të njëjtin mentalitet të dhunës. Kam besuar gjithmonë se, edhe kur përjeton tragjedi, nuk duhet ta humbësh humanitetin. Prandaj në shumë prej punëve të mia u përpoqa ta shndërroj revoltën në reflektim artistik, duke përdorur grafitet dhe satirën si elemente të pikturës.

Më vonë politika filloi të merrte një vrazhdësi që na pengonte. Nuk kam pasur dëshirë të përfshihem në ato struktura dhe role që nuk më përkisnin. Më interesonte më shumë të vëzhgoja dhe të reagoja përmes artit. Edhe aty ku shfaqej ironia, satira apo kritika, ajo vinte natyrshëm nga përvoja ime.

Në të njëjtën kohë, nuk iu largova asnjëherë artit erotik dhe as frymës së revoltës, megjithëse pas luftës ato morën forma të tjera. Në fakt, edhe para luftës arti nuk ishte vetëm rezistencë; ekzistonin shumë

“
Sa më i madh
presioni, aq më
e madhe dëshira
për të bërë art.

gjuhë dhe qasje të ndryshme artistike. Pas luftës fillova të vërej dimensione të reja që më parë nuk i kisha menduar, ndaj shpesh krijoja art të angazhuar, me synimin për të vetëdijësuar përmes imazhit dhe dokumentimit.

Shumë nga fotografitë që realizova në terren i përdora më vonë në ekspozita. Njërin prej tyre e zhvillova në Shqipëri, duke trajtuar pikërisht gjurmët e revoltës dhe nevojën për reflektim. Njerëzit kishin kaluar përvoja të rënda dhe kjo ndihej në çdo shenjë të lënë pas.

Pas luftës fillova të punoja më lirshëm, sepse edhe vetë ndihesha më e lirë. Megjithatë, në thelb, ajo energji krijuese kishte ekzistuar edhe gjatë viteve '90. Besoj se politika kulturore është mbi çdo politikë tjetër të një shteti. Nëse Italisë, për shembull, do t'ia hiqim kulturën, do të mbeteshin vetëm gërmadhat.

Një kritikë që e kam shprehur shpesh lidhet me idenë se arti bashkëkohor në Kosovë paska filluar vetëm pas luftës. Nuk pajtohem me këtë. Përkundrazi, mendoj se një keqkuptim i artit bashkëkohor i ka dëmtuar shumë artistë. Në përpjekje për t'u dukur modernë, disa kanë humbur identitetin e tyre krijues, ndërkohë që mund të kishin zhvilluar një art konceptual shumë të fuqishëm, të lidhur organikisht me pikturën dhe me përvojën e tyre autentike.

F. M.: Zifti u bë një nga materialet më karakteristike të një cikli të rëndësishëm të punëve tuaja. Çfarë ju tërhoqi te ky material dhe çfarë mundësish të reja ju hapi në shprehjen artistike?

Z. P.: Fatlum, gjithçka filloi në një takim artistik në bjeshkët e Kërçovës. Ishim dhjetëra artistë nga vende të ndryshme të Evropës, secili i suksesshëm në fushën e vet: skulptorë, piktorë e krijues të profileve të ndryshme. Ishte një ambient i jashtëzakonshëm. Dilnim në natyrë, vallëzonim, këndonim, diskutonim për artin dhe herë pas here pinim edhe nga një gotë raki.

Përballë vendit ku punoja unë ndodhej një shtyllë e vjetër elektrike (bander), të cilën të gjithë e njihnin si “vendi i Zakes”. Në vapën e verës, kur temperatura arrinte rreth 36 gradë, nga ajo shtyllë kullonte zift. Kisha me vete disa hamera gjermanë me përmbajtje të lartë tutkalli dhe, e nxitur nga kurioziteti, mora disa shkallë të gjata dhe u ngjita lart. Të tjerët më shikonin të habitur.

Aty lindi një teknikë që më vonë do të bëhej pjesë e rëndësishme e punës sime. Përmes atij materiali nxora grafika që më pas ngjallën interes të madh edhe jashtë vendit. Punime të këtij cikli përfunduan në koleksione dhe institucione të rëndësishme, përfshirë Galerinë NW në Cambridge dhe Muzeut Kombëtar të Grave në Art në Washington.

Zifti më provokoi jashtëzakonisht shumë si material. Më vonë nuk u mjaftova vetëm me përdorimin e tij të drejtpërdrejtë. Në studio fillova të eksperimentoja me kombinime të ndryshme: ngjitës këpucësh, bitumen, betulin, vaj dhe ngjyrë. Këto përzierje nuk thaheshin për muaj të tërë, por krijojnë një patinë të veçantë dhe i jepnin pikturës një cilësi që nuk mund ta arrija me materiale të zakonshme.

Arsyeja ishte edhe teknike. Zifti thahet, plasaritet dhe çahet. Prandaj kërkova mënyra që lidhshmëria e materialit të ishte më e fortë dhe më e qëndrueshme. Kam punuar edhe me neostik në sipërfaqe të mëdha, deri në dy metra e gjysmë, duke krijuar piktura ku materiali derdhej dhe bëhej pjesë organike e kompozimit.

Nuk kam kërkuar kurrë të di nëse dikush tjetër i ka përdorur apo jo këto metoda. Thjesht kam ndjerë nevojën t'i zhvilloj vetë. Ishte një kërkim personal.

Grafikat e para që realizova në Kërçovë vazhduan të jetojnë dhe të zhvillohen me kalimin e viteve. Edhe sot punoj nëpër shtylla

të vjetra elektrike, në vende të ndryshme. Shpesh shkoj në Mal të Zi me motoçikletë, herë me ekip e herë vetëm, dhe kërkoj shtyllat e vjetra për të realizuar grafikë e mia. I bëj sepse ato janë 'grafikat e Zakes'. Nuk kam parë askënd t'i realizojë në këtë mënyrë, në këto sipërfaqe dhe në këto kushte.

Ka një atraktivitet të veçantë edhe vetë procesi i realizimit. Ndonjëherë shtylla ndodhet në mes të malit, larg çdo njeriu. Herë të tjera terreni është i vështirë ose shtyllat janë të rrëzuara. Është një proces që kërkon përkushtim, durim dhe ndonjëherë edhe sakrificë. Ka raste kur më digjen duart nga materialet. Megjithatë, zifti dhe të gjitha këto eksperimente teknike zënë një vend shumë të rëndësishëm në identitetin tim si artiste.

F. M.: Në veprat e kësaj periudhe shfaqen shpesh fjalë, shkronja dhe referenca që lidhen me identitetin, kujtesën dhe përvojën kolektive. Sa ndikuan vitet e mëparshme në formësimin e këtyre cikleve artistike?

Z. P.: Vitet që kemi jetuar nuk zhduken kurrë. Ato shtrihen në kujtesën tonë, ashtu si unazat e drurit. Çdo përvojë lë një gjurmë dhe, në një moment të caktuar, ajo rikthehet në krijimtari. Arti lëviz vazhdimisht mes së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes.

Kur e kthej kokën pas te cikli "X-at flasin", ndjej një kënaqësi të veçantë, sepse aty janë përmbledhur shumë prej ndjenjave dhe përvojave të asaj kohe. Ai cikël u realizua në Galerinë Dodona dhe simboli i X-it nuk duhet parë vetëm si një ekuacion matematikor. Për mua, X-i është revoltë, target. Është njëkohësisht shpirtëror dhe fizik. Për këtë arsye kam përdorur shprehje si "Unë jam kurban i Ballkanit", apo më vonë "Unë jam viti 1999". I kam shkruar qëllimisht në gjuhën shqipe, e më pas janë përkthyer. Ka qenë e rëndësishme që ato të ruanin karakterin e gjuhës që më lidhte drejtpërdrejt me përvojën e asaj kohe.

F. M.: Profesoreshë, si një lexuese e rregullt, cilët autorë do t'i veçonit dhe a kanë ndikuar veprat letrare e filozofike në krijimtarinë tuaj?

Z. P.: Leximi ka qenë gjithmonë jashtëzakonisht i rëndësishëm për formimin tim si njeri dhe si artiste. Që nga koha e studimeve kam lexuar filozofi, histori dhe letërsi, sepse besoj se arti nuk mund të zhvillohet i shkëputur nga mendimi dhe njohja.

Kam lexuar me interes të veçantë autorët ekzistencialistë, si dhe letërsinë moderne të shekullit XX. Këto lexime kanë ndikuar në mënyrën se si e kuptoj njeriun, kohën dhe krijimtarinë.

Ndër autorët që do të veçoja, një vend të veçantë zë Osho. Veprat e tij kanë pasur ndikim të rëndësishëm në formimin tim estetik dhe artistik. Ato më kanë ndihmuar të reflektoj ndryshe mbi jetën, lirinë dhe procesin krijues.

Natyrisht, nuk mund të lihen anash as shkrimtarët tanë. Duke filluar nga Kadareja e më tej, kemi autorë me identitet të fortë krijues, të cilët i çmoj shumë dhe që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në kulturën tonë.

F. M.: Pothuajse paralelisht me rrugëtimin tuaj si artiste, keni ndërtuar edhe një karrierë të gjatë në mësimdhënie. Si kanë ndikuar këto dy role te njëri-tjetri gjatë viteve?

Z. P.: Mund të jesh një artist i shkëlqyer, por kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se mund të jesh edhe pedagog i mirë. Po ashtu, është shumë e vështirë të jesh pedagog i mirë nëse nuk e njeh artin në përgjithësi.

Që nga fillimi i viteve '90, kur diplomova dhe fillova të punoja si docente me studentët në hapësira të improvizuara, jam përpjekur të mos krijoj kurrë një distancë artificiale mes vetes dhe tyre. Nuk kam vepruar sikur jam



mbi studentët e mi; përkundrazi, kam qenë me ta. Kur e shihnin se dëgjonim të njëjtën muzikë – blues, jazz apo rock – krijohej menjëherë një afërsi e natyrshme. Dilnim bashkë, vinim në studion time, diskutonim për artin dhe mbi të gjitha u jepja liri.

Kam besuar gjithmonë se studenti nuk duhet të traumatizohet nga procesi i të mësuarit. Nëse dikush nuk dinte diçka, nuk e shihja si problem. Flisnim, diskutonim, ndanim ide dhe përvoja. Shpesh më pyesnin: "A guxoj, profesoreshë?" Dhe përgjigjja ime ishte gjithmonë e njëjtë: "Bëje!"

Shumë herë ata e kanë realizuar një ide edhe më mirë sesa e kisha imagjinuar vetë. Kjo është bukuria e mësimdhënies. Ti ua hap një derë të vogël dhe ata hapin një derë shumë më të madhe.

Kur i shoh sot, ndihem krenare për rrugëtimin e tyre. Studentët e mi kanë korrur suksese në fusha të ndryshme të artit, sepse kanë pasur guximin të eksperimentojnë dhe të gjejnë zërin e tyre. Edhe në organizime artistike ndërkombëtare ku kemi marrë pjesë së bashku, kemi qenë ndër grupet më të vlerësuara.

Një nga përvojat më të rëndësishme për mua, si koordinatore kryesore, lidhet me aktivitetet artistike ku ka marrë pjesë edhe Albin Kurtin, me konceptet e tij. Një moment

kyç ishte kur e mbyllëm "Boro e Ramizin", i cili u shndërrua në një hapësirë artistike. Pas muajsh përgatitjesh me studentët, ngjarja bashkoi performanca, instalacione, kujtesën e luftës, simbolikën "bukë, krypë e zemër", konceptin "past, present, future" dhe kritika ndaj UNMIK-ut, duke mbetur një nga projektet më domethënëse të pasluftës për mua.

Më kujtohen edhe ekspozitat që organizonim në kushte të vështira, kur i ftohti ishte aq i madh sa hapjen e ekspozitës e bënim nën dritën e qirinjve. Ishin kohë sfiduese, por edhe jashtëzakonisht frymëzuese. Ishin gjenerata të arta studentësh, prej të cilave sot kanë dalë emra të dëshmuar të artit bashkëkohor.

F. M.: Çfarë keni mësuar nga brezat e rinj të artistëve që ju ka ndihmuar të vazhdoni të sfidoni veten dhe praktikën tuaj krijuese?

Z. P.: Kam mësuar shumë prej tyre. Ka pasur shumë raste kur studentëve u kam dhënë një ide, një sugjerim apo një drejtim fillestar, ndërsa ata kanë shkruar shumë më larg se sa e kisha parashikuar. Shpesh kanë qenë më kreativë se ne profesorët. Pikërisht kjo më ka frymëzuar vazhdimisht.

Hulumtimet, projektet dhe punimet që

kanë realizuar studentët gjatë viteve më kanë nxitur edhe mua të vazhdoj të punoj më shumë për veten. Më kanë dhënë energji, motivim dhe një vullnet të veçantë për të mos ndalur kurrë së kërkuari forma të reja shprehjeje.

Do të ishte e pamundur të flisja për secilin student veç e veç. Shumë prej tyre sot janë aktivë në Kosovë dhe jashtë saj, duke ndërtuar karriera të suksesshme artistike. Por ajo që më gëzon më së shumti është fakti se ata janë formuar këtu. Janë shkolluar këtu, janë zhvilluar këtu dhe kanë dëshmuar se talenti dhe cilësia nuk kanë nevojë të vijnë domosdoshmërisht nga jashtë.

Për mua, mësimdhënia është një proces i vazhdueshëm shkëmbimi. Është një marrëdhënie që funksionon mbi parimin "merr dhe jep".

F. M.: Në një pjesë të rëndësishme të krijimtarisë suaj trajtohen tema që për një kohë të gjatë konsideroheshin tabu në shoqërinë tonë. Çfarë ju shtyu të hapni këto tema përmes artit? Po ashtu, ekspozita "Sexibition" solli një diskutim të drejtpërdrejtë mbi trupin, seksualitetin dhe dhunën ndaj grave. Sa e rëndësishme ishte për ju që këto çështje të trajtoheshin përmes artit dhe jo vetëm përmes debatit publik?

Z. P.: Nuk është e lehtë, sidomos për një pedagoge, ta përdorë trupin e vet si medium artistik, aq më pak kur ai trup paraqitet pa rroba. Në një nga punët e mia kam trajtuar pikërisht këtë fenomen: shikuesi shpesh e drejton vëmendjen menjëherë tek organi gjenital, ndërsa harron ta shohë gruan si tërësi, si mendje, si qenie, si identitet.

Unë nuk i kam parë kurrë raportet mes gruas dhe burrit si një përballje. Nuk i përkas asaj qasjeje që e sheh tjetrin si kundërshtar. Për mua, gruaja dhe burri janë si dita dhe nata, të ndryshëm, por plotësues të njëri-tjetrit. E dua maskullin në maskulloren e tij dhe e shoh këtë raport si pjesë të natyrës njerëzore.

Megjithatë, përvojat që kam përjetuar gjatë punës sime në terren, para dhe pas luftës, më kanë tronditur thellë. Kam takuar dhe kam dëgjuar histori të shumë grave të dhunuara. Dhuna që kam parë nuk ka qenë vetëm ajo e luftës dhe e ushtarëve; ajo ka ekzistuar edhe brenda shoqërisë, brenda familjeve dhe në situata të ndryshme ku gruaja shpesh nuk është pyetur as për jetën e vet.

Pikërisht për këtë arsye lindi "Sexibition". Përmes kësaj ekspozite kam dashur t'i jap fuqi gruas, t'i jap zë përvojave që zakonisht heshten. Në të janë trajtuar tema si skamja, ofshama, prostitucioni, përdhunimi, por edhe dhunimi ndaj burrave. Sepse lufta nuk ka kursyer askënd. Ka pasur edhe burra të dhunuar dhe mendoj se këto histori meritojnë të dëgjohen.

Megjithëse ekspozita lindi nga përvoja jonë, ajo kishte një karakter universal. Nuk fliste vetëm për gratë e Kosovës, por për çdo grua të dhunuar në botë. Në të njëjtën kohë, ajo përfshinte edhe burrat që kishin përjetuar dhunë. Për mua, ishte një ekspozitë për dinjitetin njerëzor.



"Sexibition" mbetet një nga ekspozitat më të rëndësishme të krijimtarisë sime. Në të morën pjesë njerëz nga shtresa të ndryshme të shoqërisë, nga figura të larta institucionale deri te qytetarë të zakonshëm. Ishte një projekt i madh, ku kontribuan edhe artistë të tjerë, secili me pjesën e vet. Nuk është rastësi që e realizova në muze. Kam dashur që ajo të shihej jo vetëm si ekspozitë, por si një histori e dokumentuar, si një dëshmi që ruhet në kujtesën kolektive.

F. M.: Sipas jush, a kanë sot gratë artiste më shumë hapësirë dhe liri krijuese sesa gjenerata juaj, apo sfidat thjesht kanë marrë forma të tjera?

Z. P.: Sot gratë artiste kanë shumë më tepër hapësirë dhe liri se sa kishte gjenerata



Zake Prelvukaj, *New Rules*, 2021

Zake Prelvukaj, *Sexibition 1*, 2005Zake Prelvukaj, *Fytyrat tona në të ardhmen*

ime. Në vitet '90 kushtet ishin krejtësisht të tjera, ndërsa pas luftës dhe sidomos në vitet e mëvonshme janë krijuar më shumë mundësi, më shumë platforma ekspozimi dhe më shumë kuratorë që kanë punuar me artistët.

Besoj se shumë prej sakrificave dhe përpjekjeve që kemi bërë para luftës janë bërë pikërisht që brezat e rinj t'i gëzojnë frytet e asaj pune. Më gëzon fakti që sot të rinjtë kanë më shumë liri, më shumë mundësi dhe më shumë hapësirë për të qenë produktivë.

Megjithatë, ka diçka që më shqetëson. Nuk mendoj se një artiste duhet të vlerësohet apo të trajtohet para së gjithash si grua. Në momentin që arti fillon të shihet vetëm përmes gjinisë, rrezikojmë të humbim vetë artin. Për mua, para së gjithash ekziston artisti si njeri. Një qenie që bart emocion, revoltë, guxim, ndjeshmëri dhe ide. Këto janë kriteret që duhet të na interesojnë më shumë sesa gjinia.

F. M.: Ekspozita e vitit 2017 me titull "Ofshamë", ndër të tjera, përfshinte edhe elementin e vajtimit. Për çfarë vajtohej?

Z. P.: Në ekspozitën "Ofshamë" kam përfshirë vajin sepse është një element që më ka lënë gjithmonë përshtypje të jashtëzakonshme. Jam rritur në Prishtinë, e rrethuar nga muzika, kitara dhe kultura urbane, por njëkohësisht kam qenë gjithmonë e vetëdijshme për traditat tona dhe për mënyrën se si shqiptarët e kanë shprehur dhimbjen ndër shekuj.

Në një punim përdora edhe kufizimin +18. Përmes tij shpreha pakënaqësinë time ndaj mënyrës se si shoqëritë, jo vetëm te ne por kudo në botë, vazhdojnë t'i përdorin të rinjtë sapo mbushin moshën madhore. Për mua, një tetëmbëdhjetëvjeçar është ende fëmija i dikujt. Nëse dikush duhet të dërgohet në luftë, pse të jetë ai që sapo ka hyrë në jetë?

Në videon e kësaj performance shfaqen duar të mbuluara me gjak. Sa herë që duart lahen, gjaku rikthehet sërish. Është një metaforë për fajin, kujtesën dhe plagët që nuk zhduken lehtë. Disa gjurmë mbeten, pavarësisht përpjekjeve për t'i pastruar apo harruar.

Më vonë, ky kufizim +18 dhe temat

që trajtohen në "Ofshamë" u ndërlidhën konceptualisht edhe me projektin tim "New Rules", duke vazhduar të njëjtin reflektim mbi përgjegjësinë, dhunën dhe mënyrën se si shoqëria ndërton rregullat e saj.

F. M.: Cikli "New Rules" lindi në një periudhë kur pandemia dhe zhvillimet teknologjike ndryshuan mënyrën se si jetojmë dhe komunikojmë. Çfarë ju shtyu të reflektoni mbi këto ndryshime përmes artit?

Z. P.: Gjatë pandemisë, në vitet 2020–2021, fillova ta kuptoj jetën ndryshe. Papritur u gjendëm duke komunikuar përmes një ekrani të vogël, ndërsa sëmunda prekte njerëzit pa dallim. Një nga gjërat që më la më së shumti përshtypje ishte zhvillimi i jashtëzakonshëm i teknologjisë dhe i botës digjitale. Në këtë proces, shpesh kam ndjerë sikur humanizmi fillon të zbehet. Natyrisht, kjo epokë sjell shumë të mira. Nuk mund ta mohojmë zhvillimin, as mundësitë e reja që ai krijon. Por, njëkohësisht, sjell edhe shqetësime të shumta. Në veprat e këtij cikli kam përfshirë edhe temat që më kanë preokupuar prej kohësh, siç është përdorimi i të rinjve në konfliktet dhe strukturat ushtarake. Kam përdorur elemente të ndryshme vizuale dhe instrumente simbolike, duke u përpjekur të krijoj një kundërpeshë pozitive ndaj frikës dhe pasigurisë që ndjeja gjatë asaj kohe.

E them hapur se pandemia më frikësoi. Ishte një periudhë kur u detyruam të pajtoheshim me rregulla të reja, pavarësisht nëse i dëshironim apo jo. Pikërisht ky transformim i përditshmërisë sonë më shtyu të krijoj ciklin "New Rules".

Në fakt, historia e artit ka qenë gjithmonë e lidhur me risitë. Kështu ka ndodhur me fotografinë, me filmin, me kompjuterin dhe me çdo shpikje tjetër që ka ndryshuar mënyrën tonë të të parit. Mjafton të kujtojmë filmat e Charlie Chaplin-it, që në kohën e tyre sollën një mënyrë krejt të re komunikimi artistik, apo më vonë zhvillimet teknike që e bënë të mundur një film si *Avatar*. Edhe në artin shqiptar kemi shembuj të tillë. Shpesh më vijnë ndër mend krijimet e veçanta të Gjeloš Gjokajt, të cilat në shumë raste të

japin ndjesinë e një bote fantashkencore.

Prandaj, përmes "New Rules", kam dashur të theksoj se edhe arti po hyn në një territor të ri. Një territor që sjell mundësi të mëdha, por edhe pyetje të reja për njeriun dhe të ardhmen e tij.

F. M.: A mendoni se arti ka ende fuqinë të na bëjë të ndalemi dhe të reflektojmë në një kohë kur jemi të rrethuar vazhdimisht nga imazhe dhe informacione?

Z. P.: Po, arti e ka ende këtë fuqi, por forma e tij ka ndryshuar. Veprat që kemi krijuar ne, por edhe ato të artistëve të tjerë para nesh, do të vazhdojnë të ekzistojnë dhe të hulumtohen nga brezat e ardhshëm. Nuk po flas vetëm për krijimtarinë time, por për artin në përgjithësi. Çdo periudhë lë pas gjurmët e veta dhe ato bëhen pjesë e historisë kulturore.

Po e përmend sërish Charlie Chaplin-in, sepse ai është një shembull i mirë. Veprat e tij nuk kishin vetëm vlerë artistike, por edhe edukative. Sot filmat e tij duken të veçantë dhe të papërsëritshëm. Askush nuk mund t'i rikrijojë më në të njëjtën mënyrë, sepse ato lidhen me kohën kur u krijuan, me realitetin historik, me përvojën dhe me rrethanat që i prodhuan.

Kështu ndodh me çdo vepër të rëndësishme arti. Ajo nuk është vetëm objekt estetik; është dëshmi e një kohe, e një mendësie dhe e një mënyre të caktuar të të jetuarit. Pikërisht për këtë arsye besoj se arti do ta ruajë gjithmonë fuqinë e tij për të na bërë të ndalemi, të mendojmë dhe të reflektojmë.

F. M.: Gjatë gjithë rrugëtimit tuaj keni folur për rëndësinë e kujtesës, dokumentimit dhe dukshmërisë së grave në art. Çfarë do të dëshironit të mbetej si gjurma më e rëndësishme e punës suaj për brezat që vijnë?

Z. P.: Do të dëshiroja që nga puna ime të mbeteshin karakteri i ekspozitave, fryma e revoltës, rezistencës, vetëdijesimit dhe lirisë krijuese. Në të gjitha ciklet e mia artistike kam kërkuar të trajtoj tema që lidhen me njeriun, shoqërinë, kujtesën dhe kohën në të cilën jetojmë. Një pjesë e rëndësishme e

këtij rrugëtimi ka qenë edhe hapja e derës për gruan artiste, jo thjesht si një çështje kuotash apo përfaqësimi formal, por për gruan që di, mundet dhe ka guximin të shkojë përtej kufijve që i vendosen.

Edhe sot vazhdoj të kërkoj dhe të eksperimentoj. Aktualisht po merrem me një studim që e quaj *Our New Faces*, ku trajtoj transformimet e mundshme të paraqitjes njerëzore në të ardhmen. Janë reflektime që lidhen me evolucionin, teknologjinë dhe mënyrën se si mund të ndryshojë vetë qenia njerëzore. Në këto vizione shfaqen edhe forma të reja trupore, njerëz me pesë, gjashtë apo shtatë gishta, si pjesë e një imagjinate që përpiqet të mendojë përtej së tashmes.

F. M.: Çfarë këshille do t'i jepnit një artisteje të re që sot po përpiqet të gjejë zërin e saj në art dhe në shoqëri?

Z. P.: Para së gjithash, do ta këshilloja të hulumtojë. Të studiojë me kujdes gjithçka që është bërë para saj, jo për ta kopjuar, por për ta kuptuar. Çdo medium artistik ka historinë, gjuhën dhe mundësitë e veta. Sa më shumë të njohësh atë trashëgimi, aq më e fortë bëhet mundësia për të krijuar diçka tënden, diçka të re.

Një artiste e re nuk duhet të dorëzohet kurrë përballë vështirësive. Vetëbesimi është thelbësor. Gjatë rrugëtimit tim kam përjetuar kritika, paragjykime dhe fyerje të ndryshme, por pikërisht ato më kanë shtyrë të punoj më shumë, të jem më këmbëngulëse dhe më e guximshme në atë që bëj.

Sfidat nuk duhet të të thyejnë. Përkundrazi, ato duhet të shndërrohen në energji krijuese.

Dhe një gjë tjetër që e konsideroj shumë të rëndësishme: kurrë nuk duhet të përbuzet mashkulli. Arti nuk ndërtohet mbi përjashtimin e tjetrit, por mbi mirëkuptimin, dialogun dhe respektin. Për mua, krijimtaria është një hapësirë ku njerëzit takohen si qenie njerëzore, me dallimet, ndjeshmëritë dhe përvojat e tyre.

Në fund, ajo që ka më shumë rëndësi është të jesh e singertë me veten dhe me artin tënd. Nëse arrin ta ruash atë singëritet, zëri yt do ta gjejë rrugën vetë.

Visar Zhiti ka dalë me kohë një kokë më lart nga më të lexuarit e letërsisë bashkëkohore shqipe. Krijimtaria e tij spikat për një ndjeshmëri të pazakontë, sepse ai ishte për shkrimtari të lirë dhe që ofron lexues të çliruar nga shablonet dhe trysnia. E kishte ndërë, dhe pastaj zbuluar, se letërsia, siç thotë Orhan Pamuk, është vepra më e çmuar që njerëzimi i ka dhënë vetes për të kuptuar vetveten. Vërtet që ajo konsumohet “gratia sui”, por realizon njëheresh funksione të rëndësishme në jetën vetjake dhe atë shoqërore.

Floririn e dallon argjendari, thuhet në Korçë, prandaj nuk është çudi që çmimin e parë si krijues “Leopardi d’oro”, Milano, 1991, poeti Zhiti e merr në Itali, fill pas rënies së komunizmit, ndërkohë që priste me padurim të dilte botimi i tij i parë në atdhe “Kujtesa e ajrit”, poezi, Tiranë, 1993. Do të pasoj nga përmbledhjet “Hedh një kafkë te këmbët tuaja”, poezi, Tiranë, 1994; “Mbjellja e vetëtimave”, poezi, Shkup, 1994; “Dyert e gjalla”, poezi, Tiranë, 1995; “Kohë e vrarë në sy”, poezi, Prishtinë, 1996; “Si shkohet në Kosovë”, poezi, Tiranë, 1999.

Vargjet e Visar Zhitit ecnin me elegancë në udhën e poezisë sonë të lashtë klasike “Veshun me diell, mbathun me hanë” duke i shpërfaqur lexuesit, dëgjuesit, përkthyesit apo studiuesit shpirtin e vet të lirë. Ishin befasim ngazëllues në motmotet e mugëta të fillimtranzicionit fill pas ndërprerjeve të gjata të komunikimit kulturor midis Lindjes, e cila rrekej t’u ikte ideologjive fillkuqe, dhe Perëndimit, që mbetej i gatshëm ta riniste atë. Ndodhte kësisoj, siç sugjeron dijetari i Qarkut të Parisit Tzvetan Todorov: “..., poezia nuk varet as nga të dëgjuarit, as nga të parët, por kërkon gjithsesi mobilizimin e shpirtit: bukuria e poezisë mbështetet në kuptimin e saj dhe nuk mund të ndahet nga e vërteta e saj.” (“Letërsia në rrezik”, Prishtinë 2007: 44)

Atbotë ra në sy që shqipja totalitare kishte prekur pak apo aspak stilin funksional artistik të letërsisë së dënuar, tipar i spikatur i tërë veprës artistike të Visar Zhitit. Letërsia e njëjton gjuhën si trashëgimi kolektive, duke shkruar ku i do qejfi. Gjuha është pasuri e atyre që e flasin, duke mos pranuar varësi nga politika apo akademia. Totalitarizmi u rrek të na bënte të thoshim *shoqja, shoku, shoq* në vend të *zysh, zonjushë, zonja, zoti, zotni, zotrote; kërkesë* në vend të *ankesë; proletar* në vend të *harbut; kuvend* në vend të *parlament*; fjalë që dolën nga ligjërimi publik duke e varfëruar atë. Aksioni politik gjuhësor filloi duke mpakur spektrin kuptimor të fjalëve *besë, besimtar, hoxhë, at, dom, adhurim, liri, borgjez, oxhak, pionier, sojnik/e, harbutëri, fatos, hallall* duke vijuar me drunjtëzimin e emrave prejfoljorë në togfjalësja të tipit folje + kundrinë *dhënia e tokave, tejkalimi i normave, revolucionarizimi i jetës*. Tri sfera themelore të lëvrimit të këtij ligjërimi, ligjërimi juridik, ligjërimi fetar dhe reklama ranë në kllapi. Mpakja e asortimentit në ekonominë e mbyllur shkoi paralelisht me pakësimin e fjalëve hiponime.

Top of FormBottom of FormEdhe te ligjërimi publik fonetika, semantika, sintaksa janë në themel të gjuhës, kurse leksiku nuk është veçse veshja materiale. Për fat, standardi i ri gjuhësor u përvetësua nga një pjesë e vogël e popullsisë, ajo e pushtetarëve, ndërsa publiku zgjodhi të mbetej i veçuar duke ‘u mbathun’ me heshtje.

Newspeak-u oruellian (shqipja totalitare), nuk pëlqeu të futej te *joycamp*-et (universitetet), ku ‘studionin e shkruanin’ letërsinë e dënuar qëndrestarë politikë, nga të gjitha krahinat e vendit dhe jo vetëm.

Letërsi e dënuar u botua edhe në diasporë nga të syrgjynosur, por për këtë uniken e Shqipërinë politike, te “Panteoni i nëndheshëm ose Letërsia e dënuar – Avitje për të kaluar murin”, Tiranë, 2010: 8, pohohet:

“Unë kam botuar dhe kam rrëfyer shumëçka nga kjo aventurë infernale, e tmerrshme, kur dënoheshin libra, autorë dhe lexues. Ishte e pabesueshme, ndoshta nga ata që i kishin mbushur ato fletë në fshehtësi, se në thasët e burgut kishin të rrasur letërsi të ardhme shqipe, nga ajo e përvuajtura, e ndershmeja, që do të merrte një rëndësi të

Kur shkrimtaria i ngjan një lutjeje për liri

Nga *Rahim OMBASHI*

posaçme, të pabesueshme, të domosdoshme dhe të vyer.”

Te botimi anastatik “Dorëshkrimet e fshehta të burgut”, poezi, Tiranë, 2021, krijimi “Varrimi” mbyll kapakun e arkëmortit ideologjik me vargun: Vazhdimisht dheu ynë po hynte në burg, duke faktuar se Visar Zhiti e pasuroi tematikën e ngurtë, që mbrohej me fanatizëm nga censorët e redaksive, me temën ekzistenciale: “Ringjallja” (“Dorëshkrimet e fshehta të burgut”, 2021) Shumë vdekje paskemi brenda jetës, // Me të fundit të paktën të bëj ç’të dua. // Varrin lëvizës prej xhipsi të degës // Shporre, o Zot, të mos më presë mua. “Diçka për pavdekësinë” (“Dritë që ecën zbatshur”, 2025) Për të mos folur më për Judën, // them se kafshët dhe tiranët // besojnë fort në pavdekësinë e tyre. // Le që kafshët s’e dinë që ekziston vdekja, // Tiranët dinë se vdekjet // janë gjithmonë të të tjerëve. // Unë e qortoj vdekjen dhe e mirëpres...

Më 1998 Visari ishte familisht në Firence te shtëpia e Mario Luzit të shquar. Vizita u bë shkak që Senatori i Përvetshëm të shkruante poezinë “Ogur” (1997). Miku me fat guxoi ta pyeste tetëdhjetëvjeçarin e emëruar për çmimin “Nobel” në letërsi.

VISAR ZHITI: - Ju besoni në Zot? Po vdekja duhet ta trembë njeriun? Vërtet ç’është vdekja?

MARIO LUZI: - Vdekja ka fillesa të njëjta me jetën, dhe kjo është e shenjtë. (246)

Për veprën poetike, albanologu Robert Elsie bën vlerësimin duke gjetur në të tiparin human, i cili ishte antonim i frymës së urrejtjes, që përshkonte letërsinë moralizuese botuar në Shqipëri fill pas Luftës II Botërore: “Kjo kronikë tmerresh të kohës është pa kurrfarë fryme ligësie e urrejtje dhe pa atë tiparin kaq shqiptar – thirrjen e palëkundur për hakmarrje. Visar Zhiti është shkrimtari shqiptar, jeta dhe vepra e të cilit mbase pasqyrojnë më mirë historinë e kombit të tij.”

Poeti Mario Luzi zbulon dritën brenda tyre: “Liria mban vargjet e Visar Zhitit, edhe kur janë të pushtuara nga argumente të zymta...”

Një tjetër krijues vëren që poeti ynë përmes vargut ka krijuar një ‘altro ego’ për të



mos u harruar përfundimisht duke u kthyer teevona në asgjë: “Poet dhe gladiator. Poet dhe muzikant. Poet dhe Kalorës i Varrit të Shenjtë. Poet dhe artist. Poet dhe ushtar. Poet dhe punëtor hekurudhe. Poet dhe fallxhor. Poet dhe mjek. Poet dhe emigrant. Poet dhe engjëll. Për të shmangur dorëzimin në një dëshpërim të pashpresë, Visari shpik pamje dhe role të ndryshme ditë pas dite, sepse në fund ai dëshiron të mbetet vetëm një poet.” (Sebastiano Grasso, President i PEN Klubit italian)

Mbi të gjitha, vepra artistike e Zhitit është humane, ajo nuk përçan, por ndikon te ndjeshmëria e të gjithëve pa dallim. Leximi i saj të kujton çfarë janë njerëzit të aftë të bëjnë dhe pse ky art i tillë sikur bëhet edhe nga ne dhe për ne.

Deri në shkurt të vitit 1979, Visar Zhiti i ishte paraqitur lexuesit vetëm me ndonjë vjershë botuar në të përditshmet e kohës, gjersa në numrin II të revistës mujore “Nëntori” mundi të botojë një cikël poetik; ndërkohë priste me ankth përgjigjen për një përmbledhje poetike të dërguar në të vetmen shtëpi botuese shtetërore të ‘kohës së britmës’, si e këtilloi më pas një libër të vetin.

Viti akademik 2002-2003 më gjeti student (i vonuar) pasuniversitar pranë universitetit “Aldo Moro” në Bari, Itali. Komunikimi me kolegët të jepte mundësinë për të kuptuar se gjer ku kishte shkruar njohja e letërsisë shqipe në atdheun e Dantes, ndërkohë që Visar Zhiti do t’i ofrohej lexuesit italian me vëllimet: “Croce di carne”, Napoli, 1997; “Dalla parte dei vinti”, poezi, Romë, 1998; “La vita”, poezi, Milano, 1998. Që komunikimi kulturor të bëhej i plotë, shërbestari i së vërtetës i dhuroi publikut shqiptar përmbledhjen “Fati i ditës” (italisht: *Sia del destino*) të poetit të madh italian Mario Luzi, e cila u botua në Tiranë në vitin 1998, të përzgjedhur dhe shqipëruar nga ai vetë. Libri u redaktua nga Eugenio Scalabrino. Përveç parathënies shkruar me mirënjohje nga shqipëruesi, vepra përmban edhe një faksimile të një letre personale që poeti Mario Luzi i kishte dërguar mikut të vet shqiptar.

Më herët Zhiti ishte vlerësuar me çmimet: “Leopardi d’oro”, Milano, 1991; “Raçonta il tuo Dio”, Milano, 1992; “Gaetano Salveti”, Romë, 1997; “Ada Negri”, Lodi Vecchio, 1998; “Premio alla carriera”, Romë, 2000, ndërkohë që një vit më parë ishte nderuar me Premio Internazionale per la poesia: “La cultura del mare”, San Felice Circeo.

Po i paraqitte lexuesit në gjuhën e vet atë veten tjetër të zbuluar qysh herët, atë si tjetër njeri (alter ego) te vetja, i bindur për vlerat universale të letërsisë. Asisoj ishte i lirë, kalonte lehtësisht telat me gjemba të kufirit shtetëror si dhe ato të burgjeve, duke kapërcyer provincën plot autencitet. Zhiti ashtu i nderur për liri shkruan i bindur se do të lexohet nga të nëpërkëmburit, si ai vetë, pa dyshuar se një ditë do të bëhej i të gjithëve. “Shokët dhe miqësia ishin e vetmja pasuri imja.”, rrëfhet te “Panteoni i nëndheshëm ose letërsia e dënuar”, që ia kushton të atit. Ndodh me të siç thotë proverbi: “Signori si nasce, non si diventa.”, që i perifrashuar duke zëvendësuar fjalën zotëria me poeti mund të thuhet: “Poeti lind, nuk bëhet.”

Mjedisi i kulturur dhe miqësor i Barit, më grishte për të falënderuar filozofin Umberto Eko, asokohe profesor visitor global, për vlerësimin antologjik që kishte dhënë për shkrimtarin tonë të madh. Ndoshta si specialist i komunikimit, kritik kulture dhe

komentator politik e shoqëror, është joshur të mësojë më shumë të vërteta të detajuara për fqinjin lindor të vetëngujuar gjysmë shekulli? Apo i shtyrë prej ideoesë estetike dhënë nga Georg Vilhelm Fridrih Hegel: “Arti si çast i shpirtit absolut”.

Me eufemizmin prekës “megjithëse titullohet si një lutje për liri” U. Eko ftoi botën pa ndjeshmëri humane t’i çelte portën temës së munguar “megjithatë, duket pothuajse e detyruar t’i kushtojë më shumë se një libër kësaj teme, e cila, në një botë më pak budallaqe, duhet të jetë e jashtëzakonshme - por nuk është”.

Gjendjen e ndërsjellë të tërheqjes së burgut me letërsinë ngjizur qysh në lashtësi, ai e fillon me Zenonin e Elias “i cili burgoset dhe torturohet nga tirani dhe, duke bërë sikur pëshpërit emrat e bashkëpunëtorëve të tij, ia kafshon veshin”. E vijon me Sokratin, që pas burgut përballtet me vdekjen, duke përfunduar me Silvio Pellicon dhe Antonio Gramshin. Nga të mbijetuarit e ferrit aktual veçon shkrimtarin tonë, që i rri aq mirë për shtat fraza e famshme latine “Thyhem, nuk përkulem” (Frangor, non flector), sepse e ktheu burgosjen në një “mjet transporti epifanik”, siç thotë Josif Brodski:

“Shihni historinë e Visar Zhitit në këtë vëllim: e tëra çfarë duhej të bënte ishte të shkruante poezi të konsideruara “të trishtueshme dhe hermetike” nga redaktorët e një shtëpie botuese, dhe për këtë arsye armiqësore ndaj regjimit. Pastaj çështja i kaloi automatikisht Komitetit Qendror të Partisë Shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme, dhe Zhiti me të drejtë fitoi dhjetë vjet burg. Kjo sepse poezia i frikëson regjimet autoritare dhe diktatoriale edhe kur flet vetëm, si në rastin e Zhitit, për trëndafilat.”

Edhe Ekoja e kishte jetuar kohën e fashizmit në vendin e vet, prandaj rreshtohet me të persekutuarit: “Sa shumë qefine, të dizajnuara për ne që nga djepi, letërsia shqyen dhe hedh në fytyrën e shëmtuar të Molokëve që do të na varrosnin të gjallë...”

U riktheva vitin e ardhshëm akademik në kërthizën e Rilindjes Evropiane, përsëri për studime të thelluara në letërsi dhe mbi semiotikën e tekstit, kësaj here në Universitetin e Bolonjës, ku më priti dhe mbështeti plot respekt profesore Daniela Delcorno Branca. Nuk të hiqet nga kujtesa imazhi i adresës “Via Zamboni, 32”, që nis fill pas Kullës Garisenda të anuar frikshëm (Torre Garisenda), të cilën e përmend Dantja te “Komedia Hyjnore” dhe numri i ndërtesës së restauruar të Fakultetit parak.

Në vitin 2001 Maria Pio Pozato, asokohe titullare e lëndës “Semiotika e tekstit” në Universitetin e Bolonjës, kishte botuar librin “SEMIOTICA DEL TESTO. Metodi, autori, esempi”; një tekst universitar i përdorur gjerësisht që detajon metodat e analizës tekstuale, i cili u përkthye me të njëjtin titull, katër vjet më vonë, nga Dhurata Shehri. Ndihej te teksti pesha dhe kontributi bazik i semiotikanit Eko.

Në këto mjedise ishte me fat ta dëgjoje profesorin shtatëdhjetë e ca vjeçar duke kumtuar e dialoguar mbi semiotikën e tekstit. Kisha mundur të gjeja edhe dy botimet e tij në shqip: “Struktura e papranishme”, Pejë, 1996 dhe “Gjashtë udhëtime në pyjet narrative”, Tetovë, 2000. Kisha lexuar e rilexuar romanin “Emri i trëndafilat”.

Atë mesditë fatlume ai ishte veshur me një këmishë blu, me kravatë të kuqe, me syze me xhama të mëdhenj rrumbullakë nën ballin e hapur, që kufizohej me flokë gështenjë. Mjekra e thinjur i shkonte me tonin e paqtë, timbrin e ëmbël dhe të butë italian, edhe kur ligjëronte në anglisht. Kisha para njeriun global që fitoi vlerësimin e botës akademike, me jo më pak se 40 “Honoris Causa” marrë nga universitete, përfshirë Universitetin Brown, të Sorbonnës, atë të Moskës dhe të Jeruzalemit.

E falënderova me zemër. I emocionuar synova të sqaroj se pas fenomenit letrar Visar Zhiti qëndronte djepi kulturor që nuk iu përkul kohës historike, ku spikat i ati, edhe ai shkrimtar i burgosur, përfshi bashkëvuajtësit dhe klerikët katolikë, të dënuar me heshtim, shumë syresh kishin kryer universitetet më në zë të Italisë apo Evropës.

Ngjizja e një vepre letrare si romani “Jam mysliman” i autorit Ben Blushi, përbën një inkursion tejet të guximshëm; një udhëtim në një zonë përvëluese ferri; një kuturisje si ajo e Odiseut në ngushticën e Mesinës- midis Shillës e Karibdës. Po t’i zbresim mitet nga froni e t’i sjellim në realitetin e botës shqiptare, ato do të na tregojnë në përngjasim me përbindëshat e detit të Mesinës, tabutë tona, gjërat e paprekshme, etnocentrizmin, sakralitetet zyrtare, popullore dhe tribale, simpatitë dhe aversionet e natyrshme, të panegociueshme dhe të pafalshme, indoktrinimet integrale dhe tejet simetrike mes komuniteteve të ndryshme, që e kanë ndarë botën njerëzore në ngastra ndjenjash, besimesh, shpeshherë edhe në kulla të vogla si spore integralizmi. E midis këtyre ngastrave ka ngushtica thuhetse të papërshkueshme, që nuk ka odise që i kalon pa u lagur. E nga këto ngushtica që shpesh izolojnë komunitete dhe grupe të tëra të çdo ngjyre, bindjeje e feje, që janë kongruente, dhe kaq simetrike sa ngjajnë me njëra- tjetrën si pika uji, krijohen vraga të pashlyeshme e të trashëgueshme, nga të cilat rrjedhin rrëke moskuptimesh e helmesh, që mbase kanë nevojë të identifikohen, t’u vihet gishti dhe të nxirren për t’u shëruar në diellin e së vërtetës. Mbi të gjitha, vragat dhe burimet e helmimeve shpirtërore e mendore nuk duhen stolitur ngado që të vijnë; ato nuk kanë nevojë për makeup, por kanë nevojë për bisturi. E kirurgu në raste të tilla mund të jetë intelektual, mendimtari, shkrimtari, artisti, individi vizionar që paraprin me shikimin e vet të thellë, të ndershmë e të paanshmë, që i rrok me sy të gjitha anët e horizontit të shoqërisë së vet. Bisturia e tij mund të jetë libri, maja e mprehtë e publicistikës, vepër artistike, artikullimi i ideve përparimtare, njohja e bazës dhe e superstrukturës së shoqërisë dhe mbi të gjitha, dashuria për popullin dhe historinë, respekti për traditën, nderimi për çdo institucion shpirtëror të kombit të vet.

Libri “Jam mysliman” erdhi si një vepër e guximshme, kundërtshënese e deri diku “e papritur” për lexuesit shqiptarë. Autori Blushi, me intuitën e një romancieri virtuoz ka luajtur që në fillim një lojë të hollë dhe elegante, një *trompe-l’œil*, duke “rrezikuar” me titullin deklarativ, kallëzuesor dhe gati të çuditshëm: “Jam mysliman”. Kjo lojë ka funksionuar e funksionon para leximit, madje para marrjes së vendimit për ta blerë librin. Një lexues me bindje myslimane joshet, sepse titulli i përkëdhel ndjenjat fetare dhe e merr ta lexojë, anipse gjysma e parë e librit, sado procedim i lartë artisik në të gjithë komponentët, është një sflitje e pritshmërive të tij. Lexuesit të krishterë ky titull i përplasat befasi dhe mërzitet për apostazinë (felëshimin) e autorit Blushi. Por ka kureshtje ta mësojë se çfarë arsyes pati ky shkrimtar klasi që hyri në këtë mëkat. Dhe e merr librin për të mësuar arsyet. Pas këtij pragu dilematik, lexuesit futen në botën e leximit të këtij romani fort tërheqës dhe e kanë të vështirë të shkëputen qoftë edhe për pak çaste pa i shkuar deri në faqen e fundit. Pra interesimit për librin nuk i shpëton pothuajse asnjë tipologji lexuesi dhe kësaj është zgjidhur që në fillim një nga synimet më të natyrshme e madje kryesore (përveç aspektit estetik) të çdo autori që merr penën të shkruajë. Sepse edhe komercializmi është i vjetër, të paktën sa Shekspiri. Shprehet Noli te introdukti i Jul Çezarit: “*Tragjedia mund të kishte emrin Mark Bruti, sepse Bruti ishte personazhi qendror shumë i pranishëm dhe zembereku i gjithë veprimit, ndërsa Çezari shfaqet fare pak (dyherë e gjysmë), madje herën e tretë del vetëm fantazma e tij në Maqedoni. Por Shekspiri si një biznesmen i mirë anglosakson i vendos dramën emrin e personazhit që kishte hijen dhe peshën më të lartë në histori.*” I sigurt se lexuesit e zgjuar mund

Shënime rreth librit “Jam mysliman” të shkrimtarit Ben Blushi

Midis Shillës dhe Karibdës


Nga Zija Vukaj

ta kenë nuhatur ironinë e autorit që pa e shfletuar dhe janë skeptikë ndaj kësaj dashurie të çuditshme apo depistazhi, autori Blushi ka bërë me mjeshtëri një hap tjetër të bukur, që rrezaton mirësi, empati, humanizëm dhe zhdukje dilemash. Në fillim të librit ka vendosur këtë shënim kushtues:

“Këtë libër ua kushtoj myslimanëve që më rritën. Xhamia e tyre ishte familja, Zoti i tyre ishte dashuria, feja e tyre ishte nderi. Unë jam po aq mysliman sa ata.”

Pas kësaj formule magjike dhe përdëlyese, autori ndihet më i lirë të shkruajë ashtu siç ndjen dhe gjykon, shpesh pa pasur nevojë të kalojë nëpër filtrat diskretë të komunikimit, pa u tutur të shpallë pëlqimet, mospërputhjet, neveritë, simpatitë e personazhit të vet shkrimtar-*alter ego*, përgjatë rrëfimit të tij ironik, psikologjik e filozofik mbi bëmat gëzimet, ndeshtrahat, dertet që i përgatit dinaku fat në Rugën e Kavajës që bashkon Dajtin me Adriatikun. Dhe qysh te ky përcaktim hapësinor i habitatit të tij lexuesi ndjen parashenjën e një letërsie të këndshme, të pangjashme, të zgjuar, të shkathët e me elementë magjikë. Në këtë univers, protagonistin përballat me islamizmin dhe islamistët, botën e tyre të mistershme, doktrinat dhe dogmën e tyre, ritet, shijet, praktikat e tyre, sjelljet, veshjet, mënyrën e jetesës etj., duke u zhgënjyer dita ditës nga ky komunitet i cili me sa duket ka qëllime të islamizojë ngadalë gjithë shoqërinë shqiptare. Ky komunitet ka Sharian për kushtetutë, një ligj që lejon dhunën dhe dënon pafajësinë. Faqe të tëra i kushtohen undergroundeve të funksionimit të jetës së këtyre njerëzve, por edhe përshkrimet të individëve me mjaft kolorit e mjeshtëri. Por sado e zymtë është Rruga e Kavajës, sado e madhe është vetmia e shkrimtarit, ai gjen në këtë shkretë shpirtërore edhe ishuj qetësie. Nuk është i keq gjithë komuniteti. Aty është edhe miku i tij Ali Baba, plak babaxhan dhe filozof jete, sipas mënyrës së tij. Ndërkaq ditët shoqërohen me ngjarje të ndryshme, me martesë poligamike, me ndëshkime macabre dhe ndodhi që implikojnë doradorës edhe jetën e vetë protagonistit, qetësinë e tij familjare dhe kulmojnë me simulimin e shembjes së monumentit, gjithçka konform parimit të arsyes së realizmit me hijezime magjike.

Kjo atmosferë që mbizotëron gjithë pjesën e parë, ndryshon me rastin e udhëtimit të protagonistit me gruan e tij të dytë në Arabi, ku shoqërohet me arabin fisnik Al Xhual. Gjatë qëndrimit atje dhe vizitës në Mekën e shenjtë heroit shikon një realitet tjetër. Realitet që s’kishte të bënte me islamikët e Rugës së Kavajës. Aty edhe ndriçohet shpirtërisht dhe formulon dy koncepte: myslimani dhe islamiku. I pari, fetari i ndershmë, i çiltër, i fisëm- qytetar i denjë i gjithë




botës. I dyti, më shumë se i indoktrinuari, devijuar nga mësimet origjinare të fesë, i fshehtë, invadent dhe i manipuluar nga qarqe me qëllime kolonizuese, që urren simbolet shpirtërore të kombësisë tjetër. Në një fjali koncize autori shprehet: “*Myslimanen e dua- islamiken e kam frikë*”

I kapluar në këtë lloj dikotomie, ai ka ndërtuar me shembuj konkretë, me përshkrime, digresione, gjykime alternative dhe vëzhgime e depërtime të mprehta pas përvojës në Mekën e Shenjt, logosin e diskursit të vet artistik:

“Në Arabi dhe sidomos në Mekë, janë të gjithë myslimanë. Muhamedi ishte mysliman. Ata që mbulojnë bukurinë e grave me burka janë islamikë. Profeti ishte mysliman. Ata që vrasin në emrin e tij janë islamikë. Islami është mysliman. Sharia është islamike. Ali Baba po ashtu është mysliman. Al Xhuali është mysliman. Imami i Rugës së Kavajës është islamik. Në Arabi gruaja ime është myslimane, kurse në Shqipëri ajo është islamike dhe prandaj kam përshtypjen se jetoj me dy gra të ndryshme. Unë i dua të gjithë myslimanët. E dua Ali Babën, të cilit i kam blerë një palë tespihe... Ato kanë preken time të butë prej ateisti plastik dhe formën e gishtave të mi prej shkrimtari kokëfortë. Kur Ali Baba t’i marrë në duar, të ndjejë vërshimin e dashurisë sime të singertë t’i përshkojë venat. Ai është njeriu që më mësoi të dalloj një mysliman nga një islamik.”

Duke lexuar këtë paragraf dhe shumë të tjerë, duke përshkuar pasazhe të shumta ku autori Ben Blushi pikturon me dashuri, mahnitje dhe një dehje poetike, ngjan sikur jemi në ato buisjet e ëmbla të vargjeve të poemës “Mahomets Gesang” (Kënga e Muhamedit) e shkruar nga J. W. von Goethe në vitin 1773, pjesë e epopesë së famshme lirike “Divani Perëndimor-Lindor” (West-östlicher Divan) (1819). Dhe Gëte, autori i termit Weltliteratur (letërsi e përbotshme), olimpiku i Vajmarit ndriçoi rrugën e vështirë, thuhetse të pakapërcyeshme të “takimit me tjetrin”.

Procedimi artistik brenda këtij libri është kompleks dhe mjeshtëror, që nga kompozicioni, arsenalit stiletik, ritmi i prozës, i dendur me kadenca poetike dhe muzikalitet, leksiku i pasur për të dhënë ndijime shqisore mbi koloritin e jetës e të pamjeve, ngjyrave dhe tingujve ekzotikë të botës shqiptare dhe asaj të lindjes. Veç kësaj, aftësia e ngjizjes dhe e portretizimit të personazheve, shpesh me një tipar dominues, që jep esencën semiotike të një tipi të gatshëm të botës njerëzore, nën një stil të harlisur, që përbën edhe një nga veçoritë e këtij shkrimtari, shpalosur në këtë vepër e cila meriton të lexohet me vëmendjen e duhur për një roman të arrirë që duket sikur ka rezonancat e jeheve hispanike, për nyjëzat narrative që shoqërojnë impulsat dhe dihatjen e nervit poetik të një shpirti të frymëzuar që përcjell jo vetëm ironi, humor, munxëvënie heraherës deri në shpoti, por mbi të gjitha, bëhet kumt i fuqishëm i humanizmit, i dashurisë njerëzore, i altruizmit dhe empatisë, ngjizur e ngritur nga parimet e arsyes.



Romani i Mehmet Krajës, “Im atë donte Adolfin”, është një nga veprat më radikale dhe sfiduese në prozën bashkëkohore shqipe. Edhe pse nga pikëpamja tematike mbetet e rrënjësuar në Shkodrën e pasluftës dhe në çarjet e thella ideologjike mes stalinizmit e nazizmit, kjo vepër e tejkalon kornizën e thjeshtë kronikane, duke u shndërruar në një studim brutal ontologjik të disfatës, të shpërbërjes morale dhe degradimit të brendshëm të individit të zënë në kurthin e historisë.

Pikërisht në këtë dimension ekzistencial mund të bëhet i mundur identifikimi i asaj që do ta quaja ‘fenomeni Bukovski’ në romanin “Im atë donte Adolfin”. Me këtë togfjalësh nuk duhet nënkuptuar ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë apo indirekt, por duhet hetuar një grup parimesh estetike dhe narrative që i bashkojnë të dy shkrimtarët, siç janë - reduktimi radikal i diskursit lirik e metafizik, zhveshja e skajshme e gjuhës (madje deri në regjistrin vulgar), vënia në qendër e antiheroit marginal, insistimi natyralist mbi trupin dhe, mbi të gjitha, trajtimi ironik - grotesk i vdekjes. Kraja, ndonëse i rafinuar në traditën e romanit modern shqiptar, në këtë vepër përdor elemente të realizmit të ashpër në pasqyrimin e vesit njerëzor, mjerimit dhe varfërisë, duke u lidhur drejtpërdrejt me poetikën e papërpunuar të autorit amerikan.

Duke u nisur nga ky diskurs i antiheroit që e karakterizon trashëgiminë letrare të Çarls Bukovskit, mund të analizojmë mënyrën se si Kraja i lëvtron parimet e ashpërsisë, groteskut dhe marginalitetit, duke i transformuar ato brenda kontekstit specifik historik ballkanik. Ky proces nuk është rezultat i ndonjë huazimi intertekstual, por është një analogji e pastër strukturore. Ajo lind vetvetiu nga një impuls estetik i përbashkët - nevoja për ta zhveshur realitetin nga dekorimet romantike dhe për ta ekspozuar atë në substancën e tij më brutale. Megjithatë, aty ku shkrimtari amerikan ndalet te fati i individit të vetmuar, Kraja e zgjeron, gjegjësisht e tejkalon këtë të ashtuquajtur matricë bukovskiane duke injektuar brenda romanit traumën kolektive dhe një metafizikë të veçantë të humbjes në përgjithësi, dhe të humbjes kombëtare në veçanti.

Një nga paralelet më të dukshme me këtë poetikë është përdorimi i gjuhës vulgare, ose ‘pagane’, siç preferojnë ta quajnë shpesh studiuesit e letërsisë perëndimore. Diskursi i Krajës karakterizohet nga fjalë të shfrenuara, imazhe të gjalla fiziologjike, skena të ‘prishjes’ fizike dhe një lloj ndyrësie morale që trondit lexuesin tradicional. “Një shmangie e madhe në letërsinë shqipe...” do ta quante këtë diskurs kritik Basri Çapriqi. Në kapitujt e parë që hapin siparin e romanit, Shkodra nuk paraqitet si qyteti i serenatave, por si një hapësirë klaustrofobike ku vdekja matet ftohtë me arshinë pëlhure. Tregtia e përditshme dhe ritet e varrimit ndërthuren në një skenë makabre, duke krijuar një atmosferë mbytëse.

Në veprat e tij të njohura si “Femrat”, “Posta”, “Faktotum”, “Bukë me sallam”, “Shënimet e një plaku të ndyrë”, “Holivud” apo “Pulp”, Bukovski formësoi tërësisht poetikën e mbetjeve ekzistenciale, duke sjellë në skenë personazhe të dëbuar në periferi, genie të humbura dhe të gërryera nga alkooli e seksualiteti mekanik. Te Kraja, kjo lëndë e papërpunuar jetësore nuk buron nga dekadencia urbane e rrugëve si ato kaliforniane, por nga mjerimi i tejskajshëm ballkanik. Megjithatë, parimi filozofik mbetet i njëjtë - bota zhvishet nga çdo nocion i sublimitetit ose shenjtërisë, duke u reduktuar në një realitet të thjeshtë, fiziologjik dhe shpeshherë dëshpërues.

Ndryshimi thelbësor dhe vija ndarëse mes dy autorëve qëndron te thellësia e vetëdijes historike. Bukovski funksionon si një individualist i pastër ekzistencialist, i cili refuzon sistemin për shkak të absurditetit të tij universal. Nga ana tjetër, Kraja mbetet një autor thellësisht i ndjeshëm ndaj memories historike dhe traumave që pëson një

Rreth romanit të Mehmet Krajës

Fenomeni Bukovski në romanin “Im atë donte Adolfin”

Nga Qazim Muja

komunitet i tërë nën thundrën e diktaturave.

Protagonisti i romanit - Babai (Im Atë) - mbart në vetvete pothuajse të gjitha tiparet tipike të antiheroit bukovskian. Ai shfaqet si një figurë kokëfortë, me një ambivalencë të theksuar morale, shpeshherë qesharak dhe i mjerueshëm në tragjedinë e tij personale. Idolatria dhe adhurimi i tij i çuditshëm ndaj figurës së Adolf Hitlerit nuk përfaqëson një bindje të strukturuar apo ideologji të mirëfilltë politike, por është thjesht një reagim plot inat, një sfidë narrative dhe një protestë e brendshme, e dëshpëruar, kundër shtypjes së egër të regjimit të ri komunist që po instalohej. Ai nuk vepron si ideolog, por si një njeri i thyer nga rrethanat, që kërkon mbështetje psikologjike te një simbol i skajshëm i forcës.

Nëse shkrimtari amerikan krijoi figurën e famshme të Henri Çinaskit si një alter-ego që endet pa qëllim nëpër bare të errëta, marrëdhënie kalimtare dhe disfata të njëpasnjëshme, personazhi i Babait (Im Atë) te Kraja merr të njëjtën rrugë ekzistenciale. Ai endet nëpër rrugicat e Shkodrës, nëpër ura të vjetra, hane të zymta, kafene të zhurmshme dhe rrënoja të mbetura nga përmbysjet

ideologjike. Në të dyja rastet, në këtë paralele, përballemi me një individ që ka humbur plotësisht kontrollin mbi rrjedhën e historisë së madhe, por që refuzon të dorëzohet, duke ruajtur si armë të vetme kokëfortësinë dhe rebelimin e tij absurd.

Dallimi në këtë pikë mbetet vetëm struktural - ndërsa Çinaski pozicionohet si një vëzhgues cinik i dështimit të ëndrrës amerikane, personazhi i Krajës është një viktimë e drejtpërdrejtë e kthesave të dhunshme gjeopolitike. Brutaliteti që ai shfaq ndonjëherë në sjellje nuk buron nga ndonjë prirje hedoniste për të shijuar jetën e rrugës, por shërben si një mekanizëm instinktiv vetëmbrojtjeje ndaj një bote armiqësore.

Skena e vrasjes së Dr. Kotanit në ambientet e Kafes së Madhe, e përshkruar me kaq mjeshtëri, ilustron më së miri mënyrën se si Kraja përdor groteskun e zhveshur nga çdo lloj patetizmi apo glorifikimi. Autori refuzon me vetëdije sentimentalizmin apo vajtimin letrar. Vdekja këtu paraqitet e ‘thatë’ - pa përmbajtje, e ftohtë, e papritur dhe pothuajse administrative në thjeshtësinë e saj tmerruese. Reagimet e dëshmitarëve rreth e rrotull janë minimale, thuhet robotike, dhe




mekanizmi i jetës së përditshme vazhdon rrjedhën pa u shqetësuar nga humbja e një jete njerëzore.

Ky lloj trajtimi të kujton menjëherë indiferencën e ftohtë të Bukovskit ndaj tragjedive njerëzore. Te të dy autorët, tragjedia humb petkun e saj solemn dhe kthehet në diçka të përditshme, banale dhe të zhveshur nga kuptimi më i lartë. Megjithatë, dallohet një nuancë e rëndësishme: ndërsa shkrimtari amerikan ironizon absurditetin e vetë ekzistencës njerëzore në terma universale, Kraja e drejton tehun e ironisë së tij të zezë ndaj absurditetit të sistemeve ideologjike që kërkojnë të tjetërsojnë njeriun e cilitdo soji.

Personazhi piktoresk i Zefit të marrë e intensifikon dhe e çon në një nivel tjetër këtë regjistër grotesk. Njoftimet e tij halucinante dhe thirrjet e përsëritura për mbërritjen e afërt të një anijeje shpëtimtare nga Anglia ngjasojnë shumë me monologët e dehur deri në delirium të personazheve bukovskiane. Por, në të njëjtën kohë, brenda kontekstit të romanit shqiptar, ato funksionojnë si një alegori e thellë politike. Ato përfaqësojnë shpresën e rreme të një populli të përvuajtur dhe fantazmën e një shpëtimi të jashtëm që nuk do të vijë kurrë.

Gjithashtu, dihet se Bukovski njihet si shkrimtar i trupit dhe i proceseve të tij fiziologjike. Kraja, në këtë vepër, pozicionohet po ashtu si një autor që i kushton vëmendje të madhe sensit fizik - por me dallimin se ai analizon trupin e ndodhur nën presionin e jashtëzakonshëm të terrorit shtetëror. Në faqet e romanit, trupi njerëzor shfaqet vazhdimisht i ekspozuar, i përdhunuar, i kërcënuar nga mekanizmat e dhunës, i mbytur dhe i poshtëruar publikisht. Trupi femëror shndërrohet shpesh në një simbol të preکشëm të dhunës sistematike që ushtron regjimi, ndërsa ai mashkullor mbetet metaforë e një krenarie të plagosur e të gjymtuar rëndë. Estetika bukovskiane te Kraja manifestohet përmes këmbënguljes së tij për të mos e fshehur këtë degradim fizik, por për ta kthyer atë në dëshminë kryesore të dhunës historike mbi individin.

Si përfundim, analiza e romanit “Im atë donte Adolfin” përmes qasjes së ‘fenomenit Bukovski’ dëshmon se realizmi i ashpër (krahas atij magjik) dhe diskursi i antiheroit mund të funksionojnë si instrumente të fuqishme për zbërthimin e traumave të mëdha historike. Duke ndarë të njëjtin impuls estetik me shkrimtarin amerikan - zhveshjen e skajshme të gjuhës, fokusin te fiziologjia e trupit dhe trajtimin grotesk të disfatës - Mehmet Kraja krijon një matricë origjinale narrative ku marginaliteti ekzistencial gërshetohet me tragjedinë kolektive ballkanike. Ndonëse Bukovski mbetet një individualist i pastër që ironizon absurdin universal të sistemit, Kraja e përdor këtë estetikë të mbetjeve njerëzore për të goditur direkt absurditetin e diktaturave dhe tjetërsimin ideologjik të personit. Në këtë formë, figura e Babait (Im Atë) dhe personazhet e tjerë periferikë në relacionin mes Shkodrës dhe Krajës së pasluftës shndërrohen në dëshmitarë brutalë të një bote ku cinizmi, kokëfortësia dhe rebelimi absurd mbeten mburojat e vetme dhe të fundit të dinjitetit njerëzor përballë dhunës së historisë.



Kaman Alikon e kam vështruar për herë të parë me njëfarë habie në korridoret e ish-Institutit të Arteve (sot Universiteti i Arteve), atëherë kur kurioziteti djaloshar i një 18-vjeçari endej nëpër ato korridore, klasa e salla, me sy, me veshë dhe me çdo shqisë tjetër, duke përthithur gjithçka që mund t'i zbulonte të ardhmen e vet, i bindur se që nga ai qershor i largët i vitit 1974 e në vazhdim, ato korridore me dhoma të larta do të bëheshin “shtëpia” tjetër, plot dritë e hije, e së ardhmes së tij të afërt.

Pikërisht aty, në ato korridore dhe te dy ulëset prej betoni pranë ish-klasës së pedagogëve, në katin e dytë të asaj godine unike për çdo student që është formuar aty, mbaj mend vagëllimthi se dëgjova dhe u tërhoqa padashur nga një zë basi i thellë, i cili i fliste, herë me shaka e herë me respekt plot adhurim, një ikone të largët të belkantos shqiptare të atyre viteve, tenorit të shkëlqyer dhe profesorit Gjon Athanas, këngëtarit trupmadh, imponues e me zë brilant, të cilin e kisha admiruar vite më parë në rolin e Skënderbeut, në operën me të njëjtin emër të kompozitorit të paharruar Prenk Jakova.

Ai zë basi i thellë, të cilin ende nuk e njihja, ishte pikërisht Kaman Aliko, një zë i shquar i klasës së kantos dhe liriku i ardhshëm i operës shqiptare. Me profesor Gjonin përshëndeteshim herë pas here; unë e admiroja për zërin e tij të bukur dhe figurën po aq mbresëlënëse që krijonte në skenë, ndërsa ai më dërgonte të fala për prindërit e mi, me të cilët e lidhte një respekt i ndërsjellë.

Me Kamanin nuk njihesha dhe, sa mbaj mend, ishte pikërisht ai takim nga i cili lindi e u rrit një miqësi e fortë dhe e singertë njerëzore, e cila na shoqëroi deri në “ikjen” e tij të dhimbshme e të parakohshme.

Detaji i parë i afrimit të asaj miqësie ishte shtatori i largët i vitit 1974, kur ndiqnim të njëjtin kurs studimi, ndonëse në degë të ndryshme, dhe uleshim pothuajse gjithmonë pranë njëri-tjetrit, në rreshtin e fundit të klasave ku zhvilloheshin leksionet e përbashkëta. Detaji tjetër ishte afërsia e datëlindjeve: ai më 13 korrik, unë më 15. Pastaj erdhën edhe të tjera: afërsia e shtëpive tona, pasi ai banonte në një bllok pallatesh pranë pallatit tim; afërsia e familjeve, si edhe respekti i ndërsjellë mes vëllezërve Aliko, sidomos profesorit Haxhi Aliko, vëllait të madh, dhe xhaxhait tim të ndjerë e të paharruar, Aleko Xoxa, ish-profesor i Institutit të Lartë të Kamzës.

Nuk ishim bashkëmoshatarë. Na ndanin shumë hollësi, si njerëzore ashtu edhe profesionale. Por sot, pas kaq shumë vitesh, mendoj se ajo që na bëri bashkë ishte ana humane: mirësia e brendshme që e shtyn njeriun të bëjë mirë; qëndrimi që mban përballë asaj që e quan të drejtë apo të padrejtë; ai këndvështrim i padukshëm që i afron njerëzit pa e ditur e pa e kuptuar pse, edhe kur në shumë drejtime të tjera nuk përputhen.

Kaman Aliko i filloi seriozisht studimet e kantos dhe ushtrimin e këtij profesioni në një moshë relativisht më të madhe se ajo që konsiderohet normale. Si shumë të tjerë, nuk vinte nga një shkollë me profilin profesional që ndoqi më pas. Disa, me përpjekje dhe vështirësi të panumërta, ia dolën të dilnin në breg dhe të krijonin figurën e tyre në skenën e Operës, e cila nuk është aspak e lehtë. Përkundrazi!

Por Kamanit natyra i kishte dhënë një dhunti të veçantë: një zë basi të thellë, që pakujt i jepet në jetë. Bashkë me të, i kishte dhënë edhe natyrën e një artisti me ndjeshmëri të hollë dhe me një dëshirë të madhe për arritje, të cilën jo të gjithë ata që e kanë njohur e kanë kuptuar plotësisht. Unë e kam njohur, sepse kam punuar me të për vite me radhë, si pianist solist dhe koncertmaestër në Operë. E kam shoqëruar dhjetëra herë në koncerte gjatë sezoneve

Kaman Aliko ka realizuar kryerole në opera si ai i Don Basilio, tek opera “Il barbiere di Seviglia”, Gjon Flamura në operan “Skënderbeu”, Gjinin tek opera “Mrika”, Nourabad në operan “Peshkatarët e perlave” për të kaluar tek opera “Toka jonë”, “Borana”, “Carmen” “Traviata”, “Rigoletto”, “Tosca” etj.

Kaman Aliko, një humbës i madh!

Nga Agron Xoxa

artistike. E kam shoqëruar gjithashtu në procesin e përvetësimit të roleve kryesore operistike, së bashku me kolegë të tjerë, si Nermin Daja, Lili Tafaj etj.

Kaman Alikon e kam njohur nga afër dhe mund të flas e të shkruaj gjatë për të, sepse jam rritur profesionalisht krah tij. Ai filloi punë në Operë një vit përpara meje, sepse kursi i tij i kantos, i nisur njëkohësisht me kursin tim, ishte trevjeçar, ndërsa i imi katërvjeçar.

Por dua të ndalem këtu dhe ta shoh Kamanin jo më si mik, shok studimesh apo koleg institucioni. Dua ta shoh me syrin e artistit që vlerëson artistin; me syrin e njeriut që përpiqet të peshojë vlerat, sukseset dhe mangësitë e një kolegu. Dua të përpiqem ta shoh Kaman Alikon përmes asaj që ai la në skenë.

Kur mendova t'i vija titull këtij shkrimi ende të paplotë, në mendje më erdhi menjëherë fjala “humbës”. Jo për humbjen e parakohshme që pësoi familja e tij, edhe pse ajo ishte e madhe. As për humbjen që ndjen miqtë, kolegët dhe të afërmit që e deshën dhe e respektuan.

M'u kujtua kjo fjalë, sepse humbësi më i madh ishte vetë ai.

Me largimin e tij në kulmin e pjekurisë artistike dhe të forcës së zërit, ai humbi pikërisht atë që do të vinte më pas. Nëse jeta e tij njerëzore mund të konsiderohet e shkurtër, jeta e tij artistike ishte pothuajse tragjikisht e shkurtër dhe e ndërprerë. Të gjithë njohim raste kur jeta artistike e një liriku të shquar ndërpritet nga një fat i pamëshirshëm.



Nuk po flas vetëm për raste shqiptare, por edhe për raste botërore. Emra të mëdhenj, si basët Shalyapin, Ghiaurov, Ghiuselev, Talvela, Siepi e Moll, apo baritonët e thellë (bas-baritonët), si Hvarostovsky, Romey, Terfel etj., janë shembuj që flasin e dëshmojnë se jeta e një artisti lirik, bas apo bariton, mund të jetë e gjatë, aq sa zgjat jeta e artistit. Pra, në shumë raste, kemi këngëtarë me jetëgjatësi deri në 70–75 vjet, ndërsa, në raste të tjera, ndërprerja e parakohshme dhe e dhimbshme e jetës sjell edhe ndërprerjen e karrierës, si, për shembull, në rastin e Talvelës dhe të Hvarostovskyt, të cilët u ndanë nga jeta dhe karriera në moshën 50–54 vjeç.

Në këtë kuptim, ndarja e Alikos nga jeta pa mbushur 50 vjeç përbën një rast tipik e fatkeq të ndërprerjes së jetës dhe të karrierës, çka e kategorizon atë si një “humbës” të madh!

Janë të shumta rastet që kanë lënë pas plagën e një humbjeje të madhe për artin dhe për vetë artistin. Por ndërprerja e rrugës artistike në atë moshë e vendos Kaman Alikon mes atyre rasteve të rralla kur jeta nuk e lejon karrierën të përmbushë misionin për të cilin krijohet fizikisht një “zë” i rrallë, por pamundësia jetike e ndërpret karrierën dhe nuk e lejon zërin e rrallë të ketë edhe jetën artistike që i takon.

Që në rolin e Kryepriftit Nourabad, në operën “Peshkatarët e perlave”, që ishte roli i tij i parë në skenën e Operës shqiptare, dalloheshin qartë bukuria dhe harmonia e zërit. Zëri i thellë i kryepriftit të tempullit, në këtë operë, vjen si një jehonë nga një hapësirë pothuajse mbinjerëzore. Dhe këtë ndjesi Nourabad-i i Alikos e përcillte në mënyrë mbresëlënëse.

Së bashku me interpretuesit e tjerë të asaj veprë — Inva Mula në rolin e Lejlës, Kastriot Tusha në rolin e Nadirit etj. — ai kontribuoi në një realizim që la mbresa të thella, jo si një përpjekje për të përsëritur suksesin e madh të vitit 1964, me të papërsëritshmit Nina Mula, Gaqo Çako, Avni Mula, Ramiz Kovaçi dhe Lukë Kaçaj, por si një sukses më vete i një brezi të ri artistësh në skenën e Teatrit të Operës.

Më pas, Kaman Aliko realizoi role të rëndësishme, si Don Basilio në “Berberi i Seviljes”, si dhe personazhe që mbeten gjatë në kujtesë: Il Commendatore në “Don Giovanni”, Sparafucile në “Rigoletto”, Scarpia në “Tosca”, Morales në “Carmen”, Marchese d’Obigny në “La Traviata”, Gjon Flamura në operën “Skënderbeu”, Gjini në “Mrika”, Meti në “Toka jonë” dhe Tregtari venedikas në “Borana”. Megjithatë, rolet që Kaman Aliko i skaliti më fort në kujtesën e spektatorit dhe të kolegëve mbeten Don Basilio dhe Sparafucile.

Vlerat skenike dhe operistike të Alikos formojnë figurën e një personaliteti të veçantë artistik. Rolet e tij i përkasin atyre që në kinematografi quhen “role karakteri”. Ky tip personaliteti artistik përmbledh disa veçori të dallueshme: figuracionin dramatik e tragjik, ngjyrimin e veçantë të zërit, fizionominë imponuese dhe aftësinë për

të krijuar personazhe me peshë të madhe skenike.

Trupi i tij i gjatë e kockëgjerë, zëri i thellë i basit, fizionomia tragjiko-dramatike dhe teknika vokale ishin të orientuara natyrshëm drejt roleve të forta karakteriale. Zëra si ai i Alikos, pa bërë krahasime të panevojshme me Lukë Kaçajn apo Mentor Xhemalin, nuk janë krijuar për çdo rol basi. Ata duken sikur janë lindur posaçërisht për personazhe si Don Basilio, Sparafucile, Commendatore, Inkuizitori i Madh në “Don Carlos”, Rocco në “Fidelio”, Princi Gremin në “Eugjen Onjegin” dhe shumë të tjerë që vazhdojnë të jetojnë në skenat lirike të botës.

Një bas i thellë nuk është një zë që formohet lehtë. Përkundrazi, ai arrin pjekurinë e tij të plotë pas dekadash pune dhe përvoja skenike. Është një nga ato kategori zërash që plaken më ngadalë dhe që ruajnë gjatë karakteristikat e tyre themelore. Për këtë arsye, karriera e vërtetë e një basi të tillë shpesh fillon pas moshës dyzet apo dyzet e pesë vjeç dhe mund të vazhdojë për shumë vite, deri në fund të jetës artistike e njerëzore.

Por pikërisht këtë mundësi jetike për të jetuar dhe për të ndërtuar një karrierë të ndershme profesionale Kaman Aliko nuk e pati. Mundësitë dhe dhuntitë e tij ishin të tilla, sa mund ta kishin shndërruar në një këngëtar të madh. Ndoshta jo domosdoshmërisht botëror, sepse, në kushtet e një sistemi krejtësisht të mbyllur, që ngjante me një “kamp përqendrimi” të padiskutueshëm, Kaman Aliko, si artist i formuar brenda atij sistemi, ishte i detyruar t’i bindej një diktati dhune dhe ligji, i cili penalizonte rëndë çdo artist të madh apo gjenial që kërkonte të dilte jashtë atij “kuadrati” gjeografik për t’u matur e për të ndërtuar një karrierë përkrah artistëve të mëdhenj të botës.

Shembujt janë të shumtë dhe aq domethënë, sa mund të mbusheshin arkiva të tëra me ta, të shpërndarë në të gjitha fushat e jetës, përfshirë edhe artin dhe artistët.

Vitet e fundit të jetës së tij i kujtoj me dhimbje. Kamani nuk ishte njeriu i duhur për t’u rreshtuar verbërisht. Nuk ishte as artisti moskokëçarës, servil apo llapaqen që të pranonte gjithçka pa qenë i bindur në ndërgjegjen e vet.

Pas rënies së skemave piramidale dhe kaosit tragjik të vitit të mallkuar 1997, me gjithë depresionin që ai solli në jetën publike, jo të gjithë qytetarët e këtij vendi, përfshirë artistët, shkencëtarët, akademikët e profesorët, arritën ta përballonin njësoj atë traumë. Jo të gjithë mundën ta kalonin pa plagë që mbeten të hapura dhe që shpesh të çojnë drejt apatisë, dëshpërimit dhe bllokimit të personalitetit.

Pikërisht këtu ndahen fatet e njerëzve: fati i atij që arrin të ngrihet mbi fatkeqësinë dhe fati i atij që rrëshqet drejt fatalitetit psikofizik.

Muajt, javët dhe ditët e viteve 1997–1999 i jetova pranë tij si mik i hershëm. Flisnim shpesh. Por në çdo takim shihja tek ai një rënie të ngadaltë drejt dëshpërimit, një tërheqje graduale nga lufta për të rezistuar dhe për të përballuar vështirësitë e jetës së përditshme.

E pikërisht këtu qëndron arsyeja pse e quaj Kaman Alikon një humbës të madh. Jo sepse humbi përballë artit. Përkundrazi. As sepse humbi përballë talentit. Edhe më pak.

Ai humbi përballë jetës.

Me ndryshimin rrënjësor të kushteve të jetesës, me vështirësitë e përballjes me realitetin e ri dhe pikërisht në kulmin e pjekurisë së zërit të tij, ai humbi jetën. Bashkë me të humbën edhe shumë vite krijimtarie artistike, nga të cilat opera shqiptare mund të kishte përfituar ende. Pikërisht për këtë arsye, në kuptimin më të dhimbshëm njerëzor dhe artistik të fjalës, Kaman Aliko mbetet një humbës i madh.

MYNXYRAT E KRITIKËS LETRARE

Nga Agim Vinca

Përkufizimi i objektit

Në këtë shkrim do të bëhet fjalë për *kritikën recensioniste*, e cila është një nga format elementare të mendimit kritik dhe si e tillë qëndron në shkallën e parë të hierarkisë së shkrimit diskursiv. Kritikë recensioniste quhet ai lloj i kritikës që realizohet në mjetet e informimit publik (në radhë të parë në gazetë, pastaj në radio, në televizion apo edhe në revistat e specializuara për letërsi) dhe që ka për detyrë themelore përcjelljen e rregullt dhe të vazhdueshme të produksionit letrar të një letërsie, informimin e publikut lexues lidhur me librat e rinj të poezisë, të prozës, të dramës, të letërsisë për fëmijë apo edhe të vetë kritikës e të shkencës së letërsisë.

Kritika recensioniste, të cilën disa e quajnë gazetareske, publicistike apo edhe kritikë e ditës, ka si formë kryesore të të shprehurit *recensionin*, prandaj natyra e saj kërkon që ai të jetë i shkurtër, i qartë dhe konciz. Ndonëse dendësia dhe lakonizmi i shprehjes varen prej atij që shkruan, është e dëshirueshme që kritiku aktiv ta ketë këtë veti, domethënë me pak të thotë mundësisht sa më shumë, gjë që praktikohet pothuajse në të gjitha ato mjedise ku ky lloj kritike ushtrohet më me rregull, më me dije e më me kompetencë.

Prej kritikut recensionist kërkohet, në radhë të parë, ta përcjellë flakë për flakë zhvillimin aktual të letërsisë amë, të shkruajë për produksionin letrar të vitit, në atë mënyrë që kritika e tij të jetë reagim i shpejtë, i mprehtë dhe efikas përkitazi me botimet e ditës. Së këndejmi, detyrë parësore e këtij lloji të kritikës, të cilën një kritik dhe teoricien i shquar i kohës sonë (R. Barthes/ Bart) e pati quajtur *kritikë-kronikë*, është të informojë për daljen e një vepre të re dhe, duke i njohur lexuesit me përmbajtjen, formën, shtresat dhe dimensionet e saj, të bëjë njëkohësisht edhe *vlerësimin*, të gjykojë për vlerat dhe të metat, për cilësitë dhe mungesat, për atë që sjell apo nuk arrin të sjellë akëcili libër, për peshën dhe cilësinë që ka ai etj.

Me rëndësi është që kritiku, i cili duhet të jetë i pajisur me disa dhunti mjaft të çmueshme e relativisht të rralla, si talenti, invencioni, shija, mprehtësia dhe guximi, ta hetojë frymën e veprës, specifikën e saj, individualitetin e saj; të dijë të gjëjë atë që është karakteristike për një autor ose për një vepër, me një fjalë, ta hetojë të veçantën e ta vendosë atë në kuadër të së përgjithshmes së një letërsie.

Kritika: reklamë apo gjykim?

Kjo është njëra nga pyetjet që shtrohen shpesh sa herë që flitet për kritikën letrare të gazetës apo për kritikën letrare në përgjithësi. Nga radhët e shkrimtarëve, por edhe të njerëzve të kulturës, dëgjohen zëra të kundërt lidhur me çështjen se çfarë duhet të jetë kritika letrare: lëvdatë apo qortim, reklamë apo gjykim? A duhet të jetë ajo pozitive apo negative dhe kur duhet të jetë kështu e kur ndryshe?

Në fushën e letërsisë kritiku e luan rolin e atij që ndan të drejtën, të drejtën letrare. Për këtë arsye detyra e tij i përngjan më tepër detyrës së gjykatësit sesa asaj të avokatit. Ka nga ata që i krahasojnë kritikët me policët dhe tagrambledhësit, prandaj thuhet se profesioni i kritikut, i cili te ne thuhet nuk ekziston si i tillë, hyn në radhën e “zanateve” më jopopullore që ekzistojnë.



Kritiku, pra, ka për detyrë ta gjurmojë të vërtetën dhe ta ndajë të drejtën. Ai duhet të jetë i drejtë, i sinqertë dhe objektiv. Por, nga ana tjetër, kritika letrare, jo vetëm sipas teorie më të reja, është një veprimtari që bazohet në gjykimin subjektiv mbi veprën. Kritika është një punë që ushtrohet nga individë dhe, si e tillë, ajo mban vulën personale, individuale, domethënë subjektive.

Si të arrihet atëherë *objektiviteti* i kritikës letrare? Po të shpreheshim në mënyrë paradoksale, do të mund të thuhej se kritiku duhet të synojë objektivitetin subjektiv. Ç’do të thotë kjo? Kritiku duhet të jetë i pavarur në gjykimet e veta, të mos bjerë nën ndikimin e rrethit dhe të mos mitoset. Ai duhet të jetë i vetëdijshëm për misionin që i është ngarkuar, kur është kritik i “mecenatit”, çfarë te ne është përafërsisht kritiku i “Rilindjes”, dhe të jetë i ndërgjegjshëm për misionin që i ka ngarkuar vetes, gjë që u referohet atyre që me këtë punë merren pavarësisht nga ndonjë institucion, domethënë vullnetarisht e me vetiniciativë.

Si është e mundur që kritiku ta arrijë maksimumin e objektivitetit dhe t’i ekspozohet minimumit të lajthitjeve? Së pari, kritiku duhet të jetë i formuar drejt në pikëpamje letrare (teorike, estetike e kritike), të ketë dije e njohuri të mjaftueshme, e sidomos shije e nuhatje të mprehtë ose, nëse doni, intuitë e invencion.

Së dyti, kritiku duhet të jetë një lexues i kujdesshëm dhe i pasionuar i veprave letrare, një hulumtues i palodhshëm dhe inteligjent i tekstit letrar. Nuk thuhet më kot se kritiku i mirë është, para së gjithash, një lexues i mirë. Sido që të jetë, kritika recensioniste duhet t’i bëjë shërbim të mirë librit, jo duke e lëvdur me çdo kusht, por duke e lexuar dhe interpretuar drejt atë, duke kapur semantikën e veprës dhe, në fund, duke ia dhënë vendin që meriton: as më lart, as më poshtë.

Dy skaje të një litari

Nuk është fjala këtu për atë vargun lapidar të Migjenit nga *Kanga skandaloze*, ku poeti, kundruall murgeshës, e vendos veten në skajin tjetër të litarit metaforik, por për një konflikt, për rivalitetin e moçëm ndërmjet shkrimtarit dhe kritikut, ndërmjet autorit dhe “tutorit”.

Historia e letërsisë është dëshmitare e goditjeve dhe sulmeve reciproke të këtyre dy taborëve (shkrimtarëve dhe kritikëve), të cilët pothuajse gjithmonë kanë qenë në gjendje lufte dhe vetëm rrallëherë e kanë nënshkruar paqen. Janë të njohura mendimet aspak

të favorshme të disa shkrimtarëve të shquar botërorë për disa nga kritikët e tyre ose për kritikën në përgjithësi.

Të gjitha këto gjykime, të dhëna në kohë, vende e kontekste të ndryshme, sillen rreth një pike të vetme: kritika është diçka më minore se vepra; ajo nuk mund ta mësojë atë; vepra i prin kritikës e jo e kundërta; kritika është parazite e letërsisë etj. Pavarësisht nga fakti se letërsia dhe mendimi mbi të janë në marrëdhënie dialektike dhe e kushtëzojnë njëra-tjetrën, ky lloj polarizimi tradicional ndërmjet tyre është pothuajse i pashmangshëm.

“*La critique est aisée et l’art est difficile*” (Kritika është e lehtë dhe arti është i vështirë), shkruante qysh në shekullin XVIII një shkrimtar francez (Destouches/ Detush), i pakënaqur me kritikën që u ishte bërë veprave të tij. Për më se dy shekuj me radhë ky mendim është përsëritur në forma e variante të ndryshme, të cilat takohen në një pikë: lehtë është të gjykos, vështirë është të krijosh.

Por historia e letërsisë na dëshmon edhe një gjë tjetër, që i bie ndesh këtij mendimi për kritikën: numri i shkrimtarëve të mëdhenj, pothuajse në të gjitha etapat e zhvillimit të letërsisë, ka qenë më i madh sesa ai i kritikëve të mirë. Një ligjësi e tillë nuk përjashtohet as në zhvillimin e letërsisë shqipe, madje as në kohën tonë, kur atë e karakterizon një dinamizëm dhe intensitet i paparë më parë.

Çka tregon përvoja jonë?

Por t’i kthehemi temës së bisedës: kritikës gazetareske, publicistike apo recensioniste. Është e qartë se kritika jonë recensioniste (e parapëlqej këtë term, për disa arsye), sikurse edhe mbarë kritika jonë, nuk arrin ta përcjellë sa e si duhet momentin tonë letrar, as të vendosë kontakte më të qëndrueshme me lexuesin, të cilit, njësoj si letërsia, i drejtohet.

Shkaqet e ngecjes së kritikës sonë letrare, pati shkruar jo fort moti një kritik yni (R. Qosja), nuk janë vetëm individuale, por edhe institucionale. Deri më tash vetëm gazeta “Rilindja” i ka bërë vend dhe e ka ushtruar në mënyrë të rregullt kritikën recensioniste, kështu që një pjesë e veprave të botuara janë përcjellë vetëm me ndonjë recension të shkruar shkel e shko në faqet e kësaj gazete ose kanë mbetur fare pa të, gjë që e dëshmon, ndër të tjera, edhe disa nga titujt për të cilët bëhet fjalë në këtë libër.

Nga ana tjetër, punën e kritikut në të përditshmen tonë, e cila vetëm një herë në javë rezervon një kënd të veçantë për rubrikën “Në botën e librit”, e kanë ushtruar njerëz që, në të shumtën e rasteve, nuk e kanë pasur as përvojën, as përgatitjen dhe as përkushtimin e duhur për këtë punë.

Mjetet e tjera të informimit e, për çudi, edhe periodiku ynë letrar, nuk i kanë kushtuar kujdesin e merituar kësaj forme kritike; nuk e kanë kultivuar me rregull, nuk e kanë nxitur e as inkurajuar. Ka munguar, pra, një qëndrim më konstruktiv dhe një politikë më parimore ndaj institucionit të kritikës si aktivitet krijues nga ana institucionale, gjë që është reflektuar edhe te faktori subjektiv.

Nga ana tjetër, pjesa dërrmuese e kritikëve tanë më me përvojë, të cilët një kohë të gjatë kanë qenë mjaft aktivë në këtë lëmi, kanë hequr dorë thuhetse përfundimisht nga ky lloj kritike, qoftë pse i janë kushtuar historisë së letërsisë, qoftë pse kanë heshtur fare. Ndërkaq, një pjesë e kritikëve më të rinj merren më tepër me teorizime, me çështje të interpretimit, pa e provuar thuhetse asnjëherë veten në interpretimin e veprave konkrete të letërsisë shqipe.

Më duket se në mjedisin tonë është i pranishëm edhe mentaliteti se kritika recensioniste është një zhanër më minor se llojet e tjera të mendimit kritik dhe se të merresh me të do të thotë t’i ekspozohesh rrezikut të komprometimit intelektual. Një pikëpamje e tillë është e papranueshme, sepse e përzien kriterin e llojit me atë të vlerës. Në letërsi, e edhe në kritikë, gjithçka varet nga mënyra se si shkruan e jo nga ajo çfarë shkruan; pra, ekziston hierarkia e vlerave e jo hierarkia e llojeve.

(1978)

A ka pasur gazetaria apo shkrimtaria jonë gjatë njëqind viteve të fundit më tepër individualitete erudite? Cila prej këtyre dy fushave ka evidentuar më shumë enciklopedistë dhe sfidantë përmes dijesh për dijeninë publike të shoqërisë shqiptare? Këtë pyetje retorike e kam mbartur në ndërgjegjen time gjatë tridhjetë viteve, nëpër të cilat kam udhëtuar me dashurinë për të dytën (letërsinë) dhe po me dashuri, ambicie dhe sakrificë profesionale për të parën (gazetarinë).

Gazetaria jonë, kryesisht ajo e periudhës së viteve '30-të të shekullit të kaluar, më ka krijuar bindjen se ka përfshirë dhe angazhuar më tepër eruditë. Mirëpo, rishtazi më është lëkundur kjo bindje, pasi në të gjithë rastet e verifikimeve të mia, për personalitetet më të spikatura të gazetarisë në njëqind vjetëshin e fundit, më rezultojnë njehërësh edhe kontributi dhe qenësia e tyre si shkrimtarët më të rëndësishëm të shekullit të fundit letrar. Kjo plejadë personalitetesh është e bollshme dhe tradita mbetet vijuese.

Emrat dominantë të jetës letrare dhe asaj publike, përgjatë kësaj periudhe, janë njehërësh fare kulturorë e letrarë që pati shoqëria dhe kultura kombëtare shqiptare, por edhe eruditët e institucionalizmit kulturor kombëtar. Duke lexuar në dorëshkrim librin monografik “Dhimitër S. Shuteriqi, rilindasi i fundit dhe regjimi komunist”, të studiuesit dhe gazetarit më të spikatur e më fakte-sjellës në publicistikën tonë memorialistike të dy-tri dekadave të fundit, të kolegut e mikut tim Dashnor Kaloçi, rishtazi më triumfoi bindja se gazetaria jonë është një dëshmi autentike e investimit intelektual e kulturor në jetën publike të një shekulli të plotë, të shoqërisë dhe kombit në tërësi.

Ndër ta, për gazetarinë dhe letërsinë

Libri i ri “Dhimitër S. Shuteriqi, rilindasi i fundit dhe regjimi komunist” i Dashnor Kaloçi

Një monografi antologjike dhe dokumentare për eruditin e kohërave të zymta

Nga Dr. Aleksandër Çipa

shqipe natyrshëm do të kryerenditet përherë edhe Dhimitër Shuteriqi. Por, me një diferencë dhe imponim prej produktit dhe kontributit të vet, i cili nuk mbeti si rast erudicioni veç në shkrime të publicistikës në dhjetëra e qindra periodikë e gazeta, por në miliona faqe të lidhura në periodikë e libra shumëgjuhësh.

Dhimitër Shuteriqi ishte filologu ynë erudit, i cili mishëronte atë preferencë kulturologjike të eseistit-filozof Emil Cioran për Francën e shekullit në të cilin ishte bashkëkohës edhe vetë profesor Shuteriqi: “Ëndërroj një kulturë orakujsh të logjikshëm, të Pithes-it të kthjellët..., dhe të një njeriu që do të kontrollonte refleksat përmes një teprie jete dhe jo nga rreptësia!”.

Jeta rinore e profesor Shuteriqit shkoi nëpër një epokë të ashpër, madje të rreptë, e të dominuar nga dy materie dhe dy ngjyra të ferrshme njerëzore: prej gjakimit dhe tym-e-flakës së Luftës së Dytë Botërore. Këtë kohë e jetoi dhe u angazhua në kontrast të plotë me imazhin vetjak të të riut të ardhur nga shkollimi në Francë dhe të studentit që la Europën dhe u bë partizan i viseve dhe vendit të ashpër.

Kjo kohë dhe ajo që pasoi, mjedisi dhe momentet e daljes nga lufta në një kohë rindërtimi nën regjim me shtypje dhe korniza, janë prova e madhe e izolimit dhe e fshehjes së erudicionit për krejt mendjerëndët e shoqërisë shqiptare, por më së shumti dhe, veçanërisht, për dy kategoritë që sjellin dhe shtojnë dijen e dijenitë në çdo shoqëri; për shkrimtarët dhe gazetarët.

Pavarësisht nga ky kufi i shpallur, i sofistikuar dhe i plotfuqishëm për t'u imponuar si regjim për mendjen dhe mendimin, Profesor Shuteriqi udhëtoi dhe shtoi triumfalisht disa rrugë të tjera për të thyer tabutë e erudicionit të pashpallur dhe të dijetarit që mund të ekzistojë veç duke u vetëburgosur në dijen, njohjen dhe historinë që e ka parë gjetkë si pakkush.

Libri i Dashnor Kaloçi “Dhimitër S. Shuteriqi, rilindasi i fundit dhe regjimi komunist”, (parathënien e të cilit e ka bërë shkrimtari i njohur me famë botërore, Ismail Kadare), është një antologji monografike për një personalitet kulture, i cili e shkoi jetën nëpër luftëra dhe përplasje të dukshme e të padukshme duke mbajtur si thelb, të mbështjellë brenda imponimeve të kohërave të hirta e të zymta, aristokracinë e qytetit të origjinës Elbasanit dhe atë të shkollimit, Francës.

Për këtë arsye, profesor Shuteriqi kur i hapte problem publicistika, zgjidhte të shtonte dhe pasuronte letërsinë autoriale e pse jo edhe atë shqipe, të lënë në harresë



thellësive të kohërave. Dhe kur shkaktonte problem letërsia e tij, ose jeta në Lidhjen e Shkrimtarëve, atëherë ai nisej në një udhëkërkim të ri në zanafillat dhe yjet e zanafillës së letërsisë shqipe.

Kur mbi tekstet e historisë së tij ngrinte hije dhe errësirë imponuese doktrina dhe ideologjia e regjimit, atëherë profesori udhëtonte nëpër albanologji duke zbuluar e sjellë gjetje prej studiuesi dhe akademiku. Kur rishfaqej sërish tehu i ndëshkimit ndaj shumëgjuhësisë dhe diturisë filologjike, atëherë Profesorit??? hynte rishtazi në një korsi tjetër dijeje dhe lëmie, ku kohë më parë kishte lënë punë të kryera e të ndërprera. (si, për shembull, në folklorin dhe poezinë popullore shqiptare).


Në këtë mënyrë, shkrimtari dhe shkencëtari ynë i filologjisë udhëtoi nëpër katër epoka të ndryshme, në jetën e vetë të mbi tetë dekadave. Ai e epitafonte për së gjalli me një shprehje jetën e vet: “Gjithë jetën kam shkruar duke kërkuar diçka...! Kam jetuar gjithnjë me shqetësimin për të punuar...! Merrja frymë kur më mbyste shkenca”. (Bisedë, shtator 1999).

Libri “Dhimitër S. Shuteriqi, rilindasi i fundit dhe regjimi komunist”, është një antologji e strukturuar mençurisht për një personalitet i cili e garantoj veprën e vet gjithë erudicion për një udhëtim në breza të ardhëm studiuesish dhe lexuesish. Në këtë monografi nuk flet kronisti i vonuar i tij, por është e plotë gjuha e fakteve, rrëfimeve dhe ndodhive, e miqve dhe kundërshtarëve e lëvduesve dhe qejfmbeturve, e të diturve të hidhëruar dhe e të famshmëve për letërsinë e triumfit si mendim dhe liri njerëzore, në shoqërinë e kohëve të zymta dhe kohëve të prishura.

Personazhi erudit i kësaj antologjie atipike është bashkëkohës në disa kohë i më të shquarve të kombit dhe popullit të tij. Për këtë arsye atij nuk mund të mos i vihet në dukje edhe një protagonizëm kontribuimi në ideimin dhe themelimin e shtypit kulturologjik në vitet '30 e në vitet '50. Janë dy kohë të ndryshme dhe diferencat janë edhe më të ndryshme. I njëjtë dhe i përveçëm mbeti gazetari dhe shkrimtari Profesor Shuteriqi.

Shumë gjera të tjera në jetën dhe bashkëkohësinë e tij janë pandashmërisht të lidhura dhe substancë e kohërave me privime dhe dhimbje, me lëvizje dhe ndrydhje, me ndriçim të kufizuar dhe errësim të padenoncueshëm. Libri i Kaloçi ka një pasuri dokumentesh e dëshmish, rrëfimesh dhe konsideratash, sikundër ka gjithë vlerën e një materije fjalësh me peshë e çmim për eruditin dhe profesorin e gazetarisë dhe shkrimtarisë sonë, i cili vijon të rezervojë në kohë të ardhme dukjen dhe shenjën e një merituri.

Ky libër monografik na përmend ne si lexues, e veçanërisht brezin tim të publicistëve dhe gazetarëve të shekullit XXI, të mbartim konsideratën dhe kujtesën e vlefshme. Kujtesën për personalitetin e ardhur nga disa kohë dhe i cili, në mugëtirën e gjallimit fizik të tij, ishte për ne i moçmi me dije dhe vepër të lënë.



Autori i librit, Dashnor Kaloçi

Armela Hysit i kam lexuar fillimisht poezinë dhe zbulova një poete ndryshe, me zë të veçantë, që lë gjurmë në krejt hapësirën e letrave shqipe. Me frymë postmoderne, poezi të shtratis psikologjik e filozofik, të ngarkuara emocionalisht, ku ndërthurren vetmia, mungesa, kujtesa, femërorja. Poezi imazhesh të forta e të befta, ku dhimbja dhe ngushëllimi, butësia dhe ashpërsia bashkëjetojnë. Që nuk marrin përsipër të shpjegojnë, lihet vetëm të ndjesh.

U ndala pak tek poezia e saj për të mbritur te proza, romani “Prekje në mjegull” që promovojmë sot. Krijuesi s’mund t’i shpëtojë vetes dhe talentit të tij, kështuqë ishte e pritshme për mua që dhe në prozë do hasja Armelën që gjeta në poezi. Dhe vërtetë, romani i parë, duket se ka po atë vazhdimësi fryme perceptimi që ndeshim në poezi. Është si një manifestim a zgjerim natyral i botës së saj poetike drejt prozës. E prirur për nga atmosfera introspektive, emocionale, filozofike e simbolike. Ku mjegulla e hasur në titull, funksionon si metaforë e kujtesës, humbjes dhe kërkimit të vetvetes. Ashtu si edhe në poezi, nuk mungojnë elementet e stilit të saj poetik, gjuha lirike mbështetur më tepër te ndjesia dhe atmosfera, duke operuar kryesisht me ekzistencializmin, nëse do t’i referoheshim një metode letrare, ku kanë spikatur emra të mëdhenj të letërsisë botërore, si Dostojevski, Kamy, Kafka, Sartre, sesa rrëfimit klasik linear.

Siç kuptohet që në faqet e para të këtij libri, ngjarjet i përkasin epidemisë botërore të covid-19, të cilën të gjithë e kemi të freskët në kujtesën tonë. Secili ka përvojën e vetë të përballjes me të, mbresat e kujtimet e veta dhe, si lexues, kur të bie në dorë një tekst me këtë temë, do kërkojë të mësojë ç’të veçantë ka sjellë autori për diçka që të gjithë jemi dëshmitarë. Ekziston kështu rreziku i zhgënjimit, që ushqehet nga pandehma e mosbesimit, në kuptimin, e çdo thotë autorja më tepër për një fenomen mbarë botëror, aq shumë të përfolur e për të cilin dihet pothuajse gjithçka?!.. Megjithatë, kur e mbaron së lexuari “Prekje në mjegull”, kupton më shumë nga ç’ke kuptuar për epideminë e tmerrshme, mëson më shumë nga ç’ke ditur. Has ndjesi që vërtetë mund t’i kesh përjetuar, por nuk ke mundur t’i vesh deri në fund thelbit domethënës të tyre. Nuk e ke shijuar sa ç’duhet ngarkesën emocionale që përcjellin ngjarjet, faktet, dramat a bëmat në jetën e njerëzve. Dhe kjo, si arritje, është krejtësisht meritë e autores. E cila kam bindjen se që në fillim, akoma pa hedhur në letër fjalinë e parë, ka vendosur a marrë përsipër të sjellë një periudhë që mund të vjetërohet si kohë, por nuk harrohet kurrë si ndjesi. Të kapërcehet si ngjarje, si fakt, veç të jetojë gjatë përshtypja, mbresa e lënë.

Dhe për ta përmbushur këtë angazhim letrar, si çdo shkrimtar zakonisht, është pozicionuar qartë në atë se “çfarë do thotë” dhe “si do ta thotë”. Për dimensionin e parë, i është dashur të ndërmarrë një kuturisje të dyfishtë: të hulumtojë brenda vetes dhe njëkohësisht ta vendos veten në kuadrin e përgjithshëm të ngjarjeve. Duke parë brenda vetes, sjellë mendimet, ndjenjat, dyshimet, brerjet e ndërgjegjes, kujtimet a përplasjet shpirtërore e psikologjike. Pa lënë pas dore edhe dukjen në skenën e madhe, të qenit qelizë e trupit të të gjithë botës. Një zë në korin shurdhues të të gjithë globit. Kam lexuar dhe autorë të tjerë që kanë trajtuar temën e covid-19, por e veçanta e këtij romani është se dilet shumë jashtë guackës individuale të heroit a heroinës

“Prekje në mjegull” i Armela Hysit

Libër i dhimbjes globale

Nga *Thanas Medi*

kryesore. Gjëma, fatkeqësia e botës është parë apo ka përcaktuar dhe gjëmën e një individi të vetëm.

Nga ana tjetër, ky përkushtim e angazhim, gjithmonë në aspektin e asaj se si do ta thotë, mëshirohet nëpërmjet dy linjave kryesore, që janë lehtësisht të evidentueshme në këtë libër. Nga një anë kemi ecurinë e epidemisë, lindjen, përhapjen, pushtimin e gjithë botës, alarmin, shqetësimin, ankthin, tmerrin, revoltën, solidaritetin, numrin në rritje të të prekurve e viktimave, që funksionon edhe si një shtysë subjekti a nyje kompozicionale; nga ana tjetër është fati i një familjeje emigranti, në vorbullën tragjike të një epidemie të frikshme. Me heroinën kryesore që lëviz fjet e i jep tonin gjithë veprës.

Nëse dëshiron të flasësh për “Prekje në mjegull”, do të merresh patjetër me heroinën kryesore, si shtylla qendrore dhe pothuajse e vetme e romanit, përderisa dhe rrëfimi është në vetë të parë. Duke mos dashur të rrëfejë ngjarjet, por veç ta grish lexuesin për ta lexuar këtë libër, është interesante të bëjmë një qasje ndaj rrëfimit në vetë të parë, në kuptimin e avantazheve dhe disavantazheve, grackave e rreziqeve që mund të ketë kjo mënyrë interpretimi në letërsi. Kështu, si anë pozitive mund të themi se krijon afërsi emocionale me personazhin, lexuesi hyn drejtëpërdrejtë në mendimet, ndjenjat dhe përjetimet e narratorit, duke e bërë rrëfimin tepër intim. Siguron besueshmëri psikologjike e shton dozën e realizmit, një frymë më subjektive, ndoshta të pa hasur më parë, nëpërmjet përvojës personale, fjalorit lokal, humorit apo tonit emocional. Fiton intensitet e tension të madh, meqë lexuesi di vetëm sa ç’di narratori, kështu që do mbetet i

gozhduar pas tij. Misteri dhe reagimi ndaj të papriturave rritet më tepër. Të ofron gjithashtu një ndjesi të fortë autenticiteti, aqsa të të duket se po lexon një ditar, libër me kujtime apo vepër autobiografike. Që gjithsesi e bën rrëfimin edhe më të vërtetë e realist.

Nga ana tjetër nuk janë pak dhe disavantazhet, kufizimet a rreziqet e mundshme të kësaj mënyre rrëfimi. Kështu, mund të përmendim perspektivën e kufizuar, narratori nuk mund të dijë gjithçka, ai njeh vetëm atë që ka dëgjuar, parë ose kuptuar. Duke u vështirësuar të japë larmi personazhesh, fenomenesh a ngjarjesh, historike e shoqërore. Ekziston mundësia e të rënit në monotonin, nëse zëri i narratorit nuk është interesant, tërheqës, i dallueshëm, i gjithë romani mund të bëhet i lodhshëm. Apo gracka e mosbesimit, pasi narratori mund të mashtrojë kur i kupton gabimisht ngjarjet. Autori, në vetë të parë, nuk mund të hyjë lirshëm në botën e personazhit, në mendimet e përjetimet e tij, siç ndodh fjala vjen me vetën e tretë. Ngjarjet paraqiten vetëm nga një këndvështrim, ndaj lexuesit mund t’i jepet një pamje e kufizuar e jo e plotë mbi ngjarje e fenomene të cilave u referohet shkrimtari.

Mes këtyre peripecive krijuese padyshim se është gjendur dhe autorja e këtij libri, veta e parë e rrëfimit e ka grishur më tepër dhe ka qëndruar tek kjo meqë është ndjerë më e sigurtë. Por duke ditur dhe rreziqet që përmendëm më lart, si për t’iu shmangur atyre, sjell një rrëfim në vetë të parë të dyfishtë. Duket sikur ka dy sy që operojnë të pavarur nga njëri-tjetri e njëkohësisht janë pjesë të një kurmi a shpirti të vetëm. Me njërin vështron botën rreth e përtej saj, duke nisur nga më të afërmit në familje, miqtë



e më gjerë, gjithë universin e ngecur në kthetrat e epidemisë së tmerrshme; kurse me tjetrin, të drunjtin siç thuhet në libër, bën eksplorimin e ftohtë e të paanshëm brenda vetes. Sigurohet kështu ecuria e njëkohshme e ngjarjeve, bashkë me bëmat që po trondisin botën, shpalosen edhe zhvillimet e brendshme të heroinës kryesore. Jepet raporti me veten, parë në kuadër më të gjerë, pa përjashtuar njerëzit që e rrethojnë, ingranuar në rrjedhat e ndodhive universale, kaluar gjithçka në sitën e dashurisë. Duke e parë këtë si shpëtimtaren e vërtetë të botës dhe të vetes.

Si përfundim mund të themi se Armela Hysi, ashtu si dhe në poezi, ia ka dalë me sukses prozës së gjatë e më të komplikuar, romanit. “Prekje në mjegull” është libri i dhimbjes globale, parë nëpërmjet pasqyrës së një individi të vetëm. I dashurisë universale filluar së pari nga vetja. Përmes fatkeqësisë a tragjedisë më të fundit, ndriçohet fytyra e bukur e botës, harruar e nëpërkëmbur jo pak në kohrat moderne. Ngrihet lart fryma kolektive në raport me individualitetin, humanizmi vendoset mbi çnjerëzoren, e mira mbi të keqen, pozitivja mbi negative, dashuria mbi urrejtjen. Është si një trokitje në kujtesën e botës së sotme, për të mos harruar vlerat më të mira të së kaluarës. Ashtu siç fokusohet edhe mbi individin, duke lënë të kuptohet se kur s’është vonë për tu vetëpërsosur. Për t’u çliruar nga mangësitë a dobësitë e tua dhe sfiduar demonët e të tjerëve. Mëshiruar të gjitha këto, përmes një stili të shkathët e origjinal. E që i ngjan së tepërmi një vërshimi përroi psiqik, intim, filozofik, emocional, shoqëruar vazhdimisht me frymë lirizmi e nerv poetik.



Sikur të mos kishte qenë porosi e Leko Lekut, Satë punë s'do ta merrte përsipër sikur ç'të bëhej. Jo lekë të qenë, po edhe shinik me flori të paskej qenë! Qe palca e korrikut. Perëndia sikur i kishte vënë saçin dheut ta piqte si lakror. Edhe hijeve të gurrës e lisave të Korijes së Madhe të shullëshe për qejfin tënd, prapë do të zihej fryma e do laheshe në djersë e në sëkëlldi. S'qe parë i tillë korrik që kur se mbahej mend behar atyre anëve.

Mirë po fjala e Leko Lekut nuk kthehej kollaj.

Të dielën e fundit të muajit u martuakej Gole Ligëtira.

"...I ka mbetur vetëm dollapi pa marrë për dhomën e gjumit. Copa-copa nuk mund ta bjerë, se Çanua s'është për punë hafife... Gjer në gjysmë të rrugës, në rrëzë të Topullaraj, do ta bien me një makinë. Ia bëri hall dhëndri që kemi në komitet. Ç'mbetet gjer në fshat..."

- Rroftë kurrizi i Kiços... - u tall me veten Kristo Kromidha. - Me këto ta ha kokën ky. Ec e prishja, po ishe burrë! - i tha vetes me mendje të ndarë.

Punëtorët e komunales e kishin shkarkuar e lënë në një si ledh të lartë dollapin e madh. Farfurinte në diellin që qe ngritur dy hostenë, ashtu puthitur me rimeso arre e mbytur në lustër. Dukej punë për merak.

"Për dhëndër aq...", tha me vete dhe mori samarin.

Ngriti kokën në të përpjetën e Topullaraj, si ta maste me sy e të bënte hesap në i arrinte apo jo takati për t'i dalë në krye.

"Sikur i ka vënë dreqi shpatullat në themel dhe e ka ngritur sot...", tha me vete.

U habit që Topullaraj iu dukën më të larta e më thikë se ç'qenë zakonisht. Ndjeu angështi që nuk i pëlqeu.

"Akoma pa vënë kurrizin barrës i mbushe poturet, o Kiço ziu..."

I kishte folur vetja, se rrotull s'kishte frymë të gjallë.

Samarin qepur e mbushur me kashtë për merak, ia pati punuar samarxhi Saraf Sinomieri. E kishte dyqanin në të sosur të sokakut që zbriste nga Varoshi, atje ku zinte fill zallishtja.

Qe bërë si i derdhur për Kristo Kromidhën. Kish dhënë e kish marrë andej këtej, po më në fund i qe dorëzuar hamallëkut si zanat. Nxirrte shumë njerëz nga thileja në ato tri copë fshatra ngjeshur brinjë më brinjë prej një jete të tërë. Qe bëra rruga e madhe ndanë luginës së Drinos, gjer në Shën Todhër, po fshatrave s'kishte rrugë të shkonte makina. Shkonin vetëm kafshët dhe Kristo Kromidha ngarkuar si ato, po ndryshe nga ato, ecte në dy këmbë, jo në katër.

I shkoi krahët samarit. Kohën e mori era që fryu në luginën e Drinos. Po pllakoste mesdita, pika e vapës. Zhuzhë e ndezur. Në brinjat e Topullaraj të çante "zhzhzhzhzh..." e cinxurit. Milingonat tërbonin nëpër vilarët e lyer me lëngjet e tyre si me tutkall nëpër shtufin që nxirrte tym.


- Hajt, në këtë botë sekush ka punën e vet. Unë kam timen. - mërmëriti me zë.

Iu qas ledhit, e mati me sy. Dollapi duhej ruajtur nga drizat dhe degët e thata të shkozave që dilnin mbi ledhe, gjer në rrugën ku do shkonte Kristua ngarkuar që zinte gjerësi sa për dy kafshë barre bashkë. Dollapi duhej shpurë, po duhej shpurë i paprekur, se ndryshe sa para bënte e shpura.

Në feksëtirën e rimesos dhe lustrës pa veten në këmbë. Në mjegull nga dielli që i binte drejt dhe i deformuar e si në tym, po prapë dukej.

Rrallë herë i rastiste të shihej në pasqyrë, ashtu në këmbë. Në mot-mot një herë, hiç mos në raste si ky i sotmi. Po edhe ndonjë qejf të madh nuk se u kishte pasqyrave edhe pse një goxha burrë. Pa shkelur të tridhjetë e pestat, shtatlartë, shpatull bollshëm, me këmbë të forta e të derdhura si prej hamshori edhe pse kishte mbetur s'dihej pse, pa martuar. Përcillte fuqi burrërore Kristo Kromidha, sido që në ballë i kaltëronin dy sy të butë, vënë gjithë merak në anët e kreut të hundës së gjatë e të drejtë, me majë ovale, e gjerë e me flegra për çudi shumë delikate.

Gojën ia kishte ormisur perëndia si për



Arben
BLLACI

Tabuti i Kristo Kromidhës

Tregim

të thënë tërë jetën fjalë të buta e të ëmbla. Buzët e plota nën hijen e mustaqeve gati të verdha kishin marrë trajtë të përjetshme në të buzëqeshur. Se që fëmijë vetëm qeshte. Kishte aq lulëzim gjithë e brendshmja dhe e jashtma e tij, sa s'do qe asfare çudi që nëse çirrej gjëkund, të mos i dilte gjak, po klorofil.

U përkul praptazi dhe tereziti buzën e samarit në fund të dollapit. Si u sigurua që e kishte karfosur mirë, i dha trupit përpara dhe u ngrit në këmbë. E peshoi edhe një herë mbi samar, mori shkopin që s'e ndante sa herë mbarte plaçka në udhë të gjatë dhe u nis.

Nuk e ngriti më kokën të shihte të përpjetën e Topullaraj. Do stepej, do ta linin këmbët. Zuri të ecte duke ndjekur rrahun më të gjerë të monopazit të zbuste të përpjetën. Këmba sikur i punonte më vete nga opingat. Këmbët sikur ecnin, opingat sikur s'bindeshin. Maja e të përpjetës iu duk aq larg sa s'do ta kaptonte dot kurrë.

Ndjeu ta përshkonte një si e ngjethur e lehtë, thua fryu veri dhe e gjeti në djersë. Ecte dhe bënte kujdes.

Të përpjetën thikë që iu tremb kur e pa si ta shihte për herë të parë, e ngjiti pa mendje, shumë më lehtë nga ç'e mendoi para se t'i qepej. Ktheu kokën e pa edhe një herë dhe u ndje si i rënë nga qielli drejt e në rrafshin e Topullaraj ku po dilte hap pas hapi.

Kuptoi që zoti e di pse, ia kishte hequr mendjen nga rruga. Ecte si në bosh, si me mendje pezull, endej mbi gjithçka e nuk ulej askund. Ndaj s'e ndjeu thuaje fare tërë atë të përpjetë që trembte ta bëje dhe me duar ne xhep, lere me një dollap dykanatësh në kurriz. Një zë nga brenda sikur e nxiti të ecte.

Vetiu iu dha këmbëve si për të fituar kohë. E ndjeu se do ishte gjendje e përkohshme. Në të vërtetë, thellë - thellë ndihej si asnjëherë tjetër i lodhur. E mbushura me frymë, pas çdo hapi po i bëhej punë e bezdisur. Për çudi do ndihej më mirë po të hiqte dorë fare...

"Ç'është kështu, i tha vetes, sikur m'u sos e sosura..."

Mu kur donte ta rrallonte frymëmarrjen, ndjeu t'i hapeshin flegat e hundës, iu hap gryka, iu tendos si markuç kur i vërshon uji. Përpara iu shtrinë Blanjat, fusha e gjerë tej e tej, e tëra mbjellë me pjeper në pik të vjeljes.

Duhma e ëmbël e veshi të tërin si një bletë të madhe mbuluar me polen. U bë i tëri hundë e mushkëri. Sikur ta thithte e të mbështillte në gjoks si në shakull, ajrin e Blanjave që kundëmonte tej e përtej pjeper i pjekur mirë.

Sikur u çlirua nga një ngërç. Më mirë të thuash nga një lajmërim ngërçi që hë e mbërthente tani, hë pastaj qysh se ndjeu në kurriz dollapin. Ngriu ashtu, me dollap ngarkuar, i vërshuar nga shkulme aromash si shkulmë narkoze, trung i çuditshëm, disa herë më i gjerë se i gjatë që e trembte hija e vet...

"Irena..., i ndriti në mend sikur një vetëtimë të kishte shkrepur e t'ia kishte llamburitur kafkën rrëzë më rrëzë. Irena..."

Ia njihte çapet. Kishte diçka prej keçeje në të shkëputur nga toka dhe diçka tjetër prej fluturë në gjendjen pezull sa të zinte shesh prapë, këmba e Irenës.

I kishte bërë këngë. Një herë ia këndoi te muri i kroit.

"Vallë ke a nuk ke zemër,

Irenë, moj kec i egër..."

Ajo qe shkrirë së qeshuri pa ngritur kokën. Për fat, sa mbaroi Kristo Kromidha këngë, gjymi u mbush e u derdh, vajza e rrëmbëu nga lugu i kroit dhe fryu përpjetë nëpër sokak.

Koka e verdhë, citë me kaçërrela e Irena Rehovës, dukej natën si hënë endacake, ditën si koka e të bukurës së dheut gdhendur ne dyll.

Le zëri! Zëri i saj e varroste fare Kristo Kromidhën. Ç'bilbila! S'qenë gjë hiç bilbilat. Cicërima e saj qe e ç'qe! Breshër kënge bilbilash i dukej Kristo Kromidhës.

U pështet pas murit të koshtit dhe futi dorën e madhe në xhepin që mezi i nxinte dy kokrra shegë të mëdha, majoshe.

Ashtu, trup e shpirt në një përgjëratë si në përshpirtje, i nxori me nxit shegët dhe tek po ia zgjaste, Irena nxitoi këmbët, thua mori vrapin.

"Samarin... Kristo! Samariiii!", tha dhe vetëm sa ktheu një çikë kokën me bishtin e syrit.

Sytë i quajti tepër...

Kristo Kromidha u shkund e u drodh! E përmendën zilet e karvanit të vogël, me tri pela dhe një mushkë, ngarkuar me kofina me pjeper. Koço Kalistiri, kafshari s'e kishte vënë re fare. Në atë pik vape s'qe çudi t'i qe dukur si ndonjë vidh i madh ngulur në mes të udhës.

Nuk e mori vesh ç'qe ajo e shkuar gjumi në këmbë, nën dollapin që e kishte vënë nën vete. Si s'qe gremisur!

Pa rrotull i humbur dhe i habitur si ditën që i erdhën sytë dhe pa botën për herë të parë. Shkundi kokën leshragjatë, u tendos mirë, rregulloi edhe një herë dollapin në samar dhe zuri të çapitej.

Ngadalë.

Jo se s'kishte fuqi, ndihej mirë. Duhma e pjepriti ia shpuri shpirtin dhe frymën në vend. Po u çudit tek e gjeti veten si të grabitur nga një ngadalësi prehëse. Mendja sikur i mbetej pas hapave, në zallin e hollë të udhës që shtrihet buzë Korijes së Madhe. Aq në buzë, sa në shumë vende derdhej hija e drurëve, lisa e ahe të vjetër. Qe bërë se bep nënkryetari i komitetit, Sevo Sevasteri t'i shpëtonte shpyllëzimit. S'la gur pa lëvizur. Jo ka vlera historike, jo ka drurë që s'gjenden, jo ka zogj e fruta të egra e të rralla... Jo andej, po këtej... Bëri ç'bëri, Korja e Madhe shpëtoi nga çrrënjosja.

Tani po ziente. Të merrej mendja nga ajo stuhi e papërmbajtur kënge zhuzhakësh e fluturakësh. Dukej si kulm dasme kur gjithë dasmorët janë të dehur.

Ashtu e kishte dashur gjithnjë dasmën Kristo Kromidha. Pa rregulla. Në dasmën e tij njerëzia do vinin të dehur mejhaneve, hazër për të bërë gjullurdinë gazmore në konakët e Kromidhajve.

Dasmë, o dasmë! Do frushullonte kënga. Ja, si kjo zhaurima plot melodira që erdh e iu vesh Kristos si shall në qafë. Si këmishë e endur me pah gjethesh. Si kollare sythash e filizash të mbjellë për të mbirë e për të lulëzuar në qafën, në gushën dhe në kraharorin mbuluar me lesh drizë të Kristo Kromidhës.

Aq e fortë iu bë kjo pandehje, sa ecte, ngrinte dorën e lirë dhe sikur ndreqte kollaren në jakë...

U ndje i dehur, i dorëzuar në krahët e atij gazmendi të natyrës. Të mos kishte dollapin në kurriz, do t'ia kishte marrë valles pa u stepur nga lodrat e pa u lodhur nga ritmi i stuhishëm. U ndje në valle, jo në ecje. Në shpinë sikur kishte një krushk të dehur që e shpinte përposh, në kashtë, jo dollapin e Gole Ligëtirës.

Ashtu, hidh një hap e shih një ëndërr, Korja e Madhe i mbeti pas krahëve. Edhe gazmendi po fashitej lehtë e me këmbëngulje, mu ashtu siç shuhen dasmat ndaj mëngjesi.

Mbajti këmbët dhe ngriti kokën nga rruga Ndihej i hutuar, ndihej si i goditur. Ashtu la pas zhurmërimën e korijes. Në vete ndjeu sesi iu ngjiti si lëbyrje, si vlagë në eshtra, shija e dasmës së drurëve dhe shpezërisë.

Dollapi sa vinte i rëndonte më shumë.

- S'ka ç'të bëjë më tani. Ja dhe pak... - nisi të thoshte me vete, po e tha me zë Kristo Kromidha.

"Ja... dhe paaak...!"

Bëri habi e s'u besoi veshëve. Fjalët që ia

tha vetes, ullinjtë e Korkoles i kishin ngritur jehonë që si iu vesh ciklon e shtjellë prilli Kristo Kromidhës. Vërshoi sipër, në bllokun e bajameve e si pështjelloi aty, rrahu grykën e Grabovicës dhe u fashit e iu rrokullis te këmbët Shkëmbit të Orrëllës.

Kristo Kromidha që fare pa mendje po e ndiqte si të mos qe ajër po një shtjellë blu që dukej, shqeu sytë.

Ç’bëhej kështu! Ishte fund korriku. Ç’ne bajame, ç’ne...

Bloku i bajameve kishte lulëzuar sikur rregullat e botës të qenë kthyer së prapi. Gjithë ajo brinjë mbjellë me pemë, gjithë ai lulëzim i çuditshëm, arratisur nga një stinë tjetër, iu duk Kristo Kromidhës si një tog i madh me nuse veshur në të bardha e kësula rozë.

Nusëronin e lodronin. Kthyer të gjitha nga djaloshi. Duke fërgëlluar degë e lule, sikur i flisnin secila me melodinë e vet:

“Më zgjidh mua, Kristo! Mua, muaaa!”

Thoshte një tjetër e një tjetër... Dhe bënin të gjitha bashkë një simfoni që plaste gurët. Shkundnin e shkundnin pa mbarim lule që era i mbarte teposhtë dhe ia vishte Kristo Kromidhës si kostum të bardhë.

Ngriti dorën të zgjidhte litarin që mbante dollapin lidhur me veten. Po vetëm e mblodhi hinkë në gojë. Donte t’i thoshte diçka asaj trumbe me nuse. Po nuk diti se çfarë dhe hoqi dorë. Ndjeu dëshirë vetëm të shihte veten në feksjen e dollapit.

Ndjeu të ligështoej. Jo aq sa të mos iu tundte dorën nuseve që e thërrisnin e lodronin. U vu të bënte edhe ato qindra metra për të arritur te kroi i poshtëm i Ajazmës, ku siç e lanë, e priste Gole Ligëtira.

Harku i madh i kroit iu shfaq menjëherë, hijerëndë, pastaj ndjeu vërshimin e ujit dhe pas hapave të fundit pa dy koritat e gurta. Mbase që kur se kishte lerë sefte bota, ato nxirrnin e nxirrnin ujë.

Kristal. Akull...

Ishte aq i etur sa sikur të mundte, ashtu me dollap në kurriz, jo do kishte vënë buzët në koritë, po do ta gëlltiste ashtu, xhëng guri me fit!

U përkul pak sikur t’i falej kroit, pastaj u kujtua, u kthye praptaz dhe mbështeti dollapin në pezulin e lartë, bërë me gurë e shtruar me çimento.

Si e la në peshë të vet dhe u sigurua që të katër këmbët kishin zënë vend në rrafshin e pezulit, liroi litarët e lidhur në gjoks. Rrotull s’pa këmbë njeriu. Mbase kishte ardhur herët, ose Gole Ligëtira qe harruar pas angarive të dasmës.

- Më mirë! - tha me zë dhe u ngjit nga ana e pasqyrës.

Befas qe kujtuar që dollapi kishte pasqyrë. S’e mbante vendi sa të shihej. Ndjeu t’i merrej mendja. Mbylli sytë dhe iu afrua duke bërë kujdes të mos i binte xhamit me kokë.

Ndaloi dhe i hapi njëherësh.

Shtangu.

Dhëndër!

Në pasqyrë lulëzonte buzëqeshje Kristo Kromidha, veshur me kostum. Në të bardhën e bajameve dhe në të blertën e Korijes se Madhe. Pasqyra thithte e përcillte një qeshje të pafundme fëmije që sapo i kishin falur botën.

Fërkoi sytë. Pa nga kroi, harkun e lartë, kamaret, koritat, ujët që si gurgullonte pak metra, derdhej në bendin e madh, shtruar me beton dhe mblidhej në katër mure të lartë mbi tri metra, suvatuar me llaç betoni. Llamste nga pastërtia, farfurinte nën diell si pasqyrë përrallash rënë nga qielli...

Doli me vrap në shesh të kroit, para pezuleve. Si së largmi, ndjente tek ziente si kazan në zjarr, koka i gjëmonte si e rrahur vareje thellë Shpellës së Dudit, gjoksi i dhimbtë si t’i kishin futur plorin për t’ia bërë qilizme...

Zuri të zhvishej. Me kujdes, thua do zhvishte qelqe të hollë.

Zhveshi... këpucët lustrafine, hoqi... xhakëtën e bardhë si bora, zgjidhi... kollaren, pastaj këmishën e gjelbër, zbërtheu... pantallonat e ngrira në hekur. I... palosi plot kujdes siç bënte mëma me rrobat e sepetit, u tërhoq pak pas t’i shihte a qenë në radhë dhe...

- Buuukuuur! - tha në ajër tek mori hov dhe u hodh në bend.

Sa të hapje e të mbyllje sytë u dëgjua një shungëllim i thatë. Kolona e ujërave pak çaste më parë të qeta, u trazua egër dhe shtjella u ngrit gjer ne mes të rrapit që varte degët mbi sipërfaqen xham. Shtati i madh i Kristo Kromidhës ra mbi ujë me krahë të shtrirë para si për zhytje. Gropa e ujtë që u hap nën të, nuk u mbush më.

Kristo Kromidhës nuk iu bindën më krahët e shtrirë për të bërë tutje në ujë. Pak lëvizje të çrregullta këmbësh e krahësh, një si përpëlitse qengji me thikë në fyt, nuk mjaftuan që të mund as të zhvendosej, as të ngrinte së paku kokën mbi ujë. I zënë në ngërc si në kurth të lig, u fundos ngadalë në gropën që hapi vetë në mes të bendit. Shtjella e ujit që i ngrit, ra, e mbuloi përzishëm.

Në pak çaste gjithçka u qetësua si të mos qe trazuar asgjë. Nga thellë bendit ku fekste si i lyer me argjend trupi që nuk lëvizi dot më, u ngritën fluska që mbetën pezull mbi ujërat e qeta shtruar si me vaj.

Qe fryma e fundit që dërgonte sipër Kristo Kromidha...

Çano Çerepi, si asnjëherë më parë e pa veten në prag të turpërimit për mot e për jetë. Në marangozanë s’kishte as edhe një fije të saktë dërrase të mund të mbërthente tabutin e Kristo Kromidhës.

Kishin mbetur dhoga të shtrembra e ta pa rokanisura, S’qe bërë mukajet të furnizohej me ndonjë material për të qenë. Nuk pritej të vdiste njeri në fshat. Në Ajazmë, rrallë që të mos thuash fare, ndodhte të prishej radha e vdekjes. Ndonjë i mbytur lumenjve a ndonjë e ngrënë gjarpri që nuk proftasej dot, jo gjë tjetër. Edhe kjo bënte vaki aq rrallë, sa i këndohej kënga.

“Prit kur të më këndohet mua kënga tani!”, tha me vete ashtu, pa rrugëdalje dhe i dëshpëruar sa s’thuhet.

Në këto e sipër, jashtë dëgjoi zëra dhe zhurmë. Dera u hap dykanatësh. Në pak minuta katër djem lëshuan në mes të marangozanës një dollap dykanatësh. Fekste si i larë me diell. Llak e rimeso që mbanin akoma erën e punishtes.

- Na tha Golja ta binim, xha Çano. I thoni me këtë do bëhet tabuti i Kristos. Për më shumë fol me Golen, ikëm ne!

Çano Çerepi u ngrit rëndë, sikur dollapin t’ia kishin lënë në kurriz, jo në mes të marangozanës. E kuptoi menjëherë ç’po bënte Gole Ligëtira.

Iu qas dollapit si të qe një tra i befasishtëm shpëtimi që ujërat ia prunë mu kur po ndihej i mbytur.

Fekste...

- Punë e bukur, jo shaka! Duket puna me maqineri... S’e gëzove dot, o Gole dhëndri. Paska qenë taksur tabut për Kristo nxirin...

S’mbahej mend te qe parë atyre anëve varrim si i Kristo Kromidhës. Shkulur i madh e i vogël nga tre fshatrat ngjitur, nga qyteti dhe fshatrat rrotull. Mbi dheun e hedhur me kujdes ndanë varrit, qe vënë arkivoli punuar me dhembshuri e dashuri nga Çano Çerepi. S’kishte mbetur njeri pa marrë vesh bëmën e Gole Ligëtira më dollapin.

“Ashkosun, ashkosun t’i jetë që nderoi veten!”, s’pushonin së thëni njerëzia.

Ja tek e kishin para syve, tabutin me Kristo Kromidhën brenda, qarkuar me dritë dielli, me llamburitje dhe me kurora. Kurrë më parë, as për më të kamurit e krahinës, s’qe parë i tillë tabut. Qenë bërë me dhoga të mira, veshur me cohë të çmuar, me doreza te argjendta... Lloje - lloje. Po të tillë, kurrë!

- Si në tabut mbreti u fute, o djalë! Të këputet shpirti t’u mbulosh me dhe, o korbi ti, korbi! - tha që ta dëgjonin, Reto Rebi duke fshirë sytë me shami të bardhë.

Pas një fjalimi të shkurtër që u duke edhe më i shkurtër se nuk e dëgjoi njeri, tabuti u kall në varr. Mbi të, si mbi çdo tabut ranë lopatat e para me dhe. Përpara se të mos dukej më asnjë shenjë, nga mes dheut ndriti një si rreze.

E fundit, para se luzma e dritës të mbulohej për t’i bërë tërë jetën e jetës dritë në parajsë Kristo Kromidhës...

I. S. Turgeniev DITARI I NJË NJERIU TË TEPËRT

Përkthyer nga Bujar Hudhri


Një tablo e gjallë e shoqërisë ruse të shekullit XIX, por, mbi të gjitha, historia prekëse e një njeriu për të cilin vdekshmëria bëhet i vetmi aspekt i jetës që e ka të përbashkët me njerëzit e tjerë.

I shtyrë drejt shtratit të vdekjes nga një sëmundje e pashëru-eshme, fisniku i varfëruar tridhjetëvjeçar Çulkaturrin vendos të shkruajë një ditar, duke hedhur vështrimin pas mbi jetën e tij të shkurtër. Pasi përshkruan zhgënjimin e rinisë dhe rënien e familjes së tij nga pozita e dikurshme, bashkë me humbjen e statusit shoqëror, rrëfimi përqendrohet te dashuria e tij për Lizën, vajzën e një nëpunësi të lartë shtetëror, te rivaliteti me princin N., të hijshëm e plot sharm, dhe te poshtërimi që pason. Këto faqe ndihmuan në formësimin e arketipit të “njeriut të tepërt”, një figurë e përsëritur në letërsinë ruse të shekullit XIX.

Botuar për herë të parë në vitin 1850, “Ditari i një njeriu të tepërt” fillimisht u censurua nga autoritetet, pasi disa prej pasazheve të tij u gjykuan si tepër kritike ndaj shoqërisë ruse.

I. S. Turgeniev

Ditari i një njeriu të tepërt



Trishtil

TË DIELAT E DIMRIT

Pa ty ngricake janë
Të dielat e dimrit
Me lotë harabelash mbi xhama
Vijnë dhe ikin.

Mbllaçis një re,
Një re më mbllaçit
Si këmishë e harruar hëna
Në ballkon u ngjit.

Xhami i thyer
Era kuit lartë,
Imazhi yt vetëtimthi
Më torturon si mëkat.

Të dielat vdesin
Me lot harabelash
Cijasin vetëtimat
Kanë marrë flak telat.

Si gjarpërinj telat
Shurdhmemece mbesin,
Si ta shkrij dëborën
Të dielat të qeshin?

ÇAST...

Trak-truk hapat mbi kalldrëme
shkel mbi eshtrat e gurit,
eci mbi qepalla hëne.

U poq vishnja që kam në oborr
Premtim puthjesh buzë e ngrenë.

Eci nën një qiell të argjendtë
era e mbrëmjes
si një flaut që fryn ëndrra
këngëzon emrin tënd.

MË LËNDON GËZIMI YT

Më lëndon gëzimi yt,
si gotë që qesh me buzë të çara
tekta bie kambanorja e dhimbjes.

Sytë e tu, dyer pa mure.
I hap dhe bie në venat e errëta
të një kohe pa gjak,
ku orët kullosin hije mashtruese.

Qesh. Dhe e qeshura jote
shtyn retë nga kafka ime.

Gëzimi yt vesh dorashka drite
dhe zgjon bishat e fjetura
nën pelerinën eshtrore të natës.

Përkulem të shoh kush jam
dhe gjej një zog të gozhduar
në retinën e syve të tu.

Ti ikën si fllad. Unë mbetem
duke mbledhur qirinj të shuar
nga shandani i trishtimit.

Sepse gëzimi yt
vrapon zbathur mbi nervat e tokës
dhe humbet befas
në greminën e dëshpërimit.

NË AKROKORINTH

Ngjitesha në kështjellën e Korinthit.
Në njërin sup më rëndonte dielli,
në tjetrin hëna linte pluhurin e saj të
argjendtë.

Muret e lashta zbardhnin si lavdia.
Mes gurëve të plasaritur
Hyjnesha Athina kishte gdhëndur një copë
mendimi,
Afërdita një shishe parfumi deti.

Ngjitesha. Pas meje ngjitej Gjiri i Korinthit,
me një det të thellë si kujtesa,
i kaltër si një ëndërr që s'gjen port.

Kolonat dorike mbanin ende peshën e
shekujve,
si punëtorë të heshtur nën qiellin e historisë.
Këtu kishin kaluar ushtri,
tregtarë, skllavër, perandorë,
dhe dashnorë që besonin
se puthja i mbijetonte kohës.



Preka mermerin. Ishte i rrudhur, i plasaritur
si balli i një njeriu të gjallë.
Atëherë e kuptova:
hyjnesha Athina nuk banon më në tempuj,
por në mendimin që i reziston territ.

Afërdita nuk fle në statuja,
por në etjen njerëzore
për të dashur e për t'u dashur.

Dhe një puhizë nga deti, e vjetër sa mitet,
më ledhatoi ballin
me frymën e përjetshme antike.
Në Akrokorinth
deti më përkundte mes dy hyjneshave.

ÇFARË NDODHI?

Nuk e di ç'u bë kopshti
me zambakët e hënës të rënë nga gjinj të e
saj.
Në mëngjes mbeti veç
një iluzion pranvere
në syrin e turbullt të ujit.

Një korb shqyente barkun e ditës,
një violinë gërvishte sedefin e premtimit.

Vishnja derdhte gjakun mbi velin e
mbrëmjes,
bajamja e hidhur pikonte
helm në grykën e këngës.
Çfarë ndodhi me ne?

Era shkelte sytë e gjelbër të shpresës
aty ku silueta jote
ravijëzohej prej jasemini.
Dhe befas duart më mbetën bosh,
dy cungje nën një abazhur të fikur.

Flutura lidhi kordhelën e saj
mbi floknajën e pemëve,
kopshti u ndez dhe u shua si puthja
dhe vdekja e ditës e mori mbi ballë.

Unë mbeta statujë pranë dordolecit
në shkretëtirën e verdhë të pikëllimit.

STATUJA E LIRISË

Ha përnatë
nga një Çe Guevarë prej zjarri.
Pastaj ulet në Kongres
mes senatorëve prej dylli

dhe ndez purot me flakën e armëve
që qëllojnë mbi mishin e gjallë
besën e pabesisë.

Pas një pauze ngrihet e qetë
me pishtarin mbushur
me hije të djegura

dhe niset të bekojë tragjeditë
që mbjell si trëndafila të zinj
në brigje të tjera.

TË TAKOVA NË NJË
ËNDËRR...

Të takova në një ëndërr.
Qielli kishte harruar të mbyllte sytë
dhe yjet kullonin argjend mbi supet e natës.
Të humba në një monopati
që lëvizte si gjarpër nën këmbët e mia.

Ndoshta në një kufi të verbër
ku rojet nuk ruajnë njerëz, por ëndrra,
dikush e qëllloi me plumb hijen tënde
dhe na vrau hijen
shallin e dashurisë e rrëbeu era.

Kam lundruar aq dete,
sa kripta ka hedhur rrënjë në gjak.
Jam kacafytur me demonë
që mbanin fytyrën time
dhe qeshnin me zërin tënd.

Më rrëmbyen furtuna, më përtypën
vorbullat,
më hodhën nga një breg në tjetrin si një
guaskë
që kërkon detin dhe muzikën e vet.

Tani, në këtë breg të panjohur
ku më nxori dallga, ti më buzëqesh
me dy sy të fikur,
si kandila që kanë harruar flakën.

Prit edhe pak. Mos vdis. Ti je ylli im.
Kam ardhur me xhepat plot agime
dhe me frymën e fundit të pranverës
që të shtroj rrugët ku kalon.
Prit, të ta pulsoj zemrën me një puthje.
Prit, të ta fryj shpirtin
si Zoti baltën ditën e parë të botës.

Të takova. Të humba. Të gjeta.
Dhe prapë kam frikë se mos zgjohet ëndrra
dhe të merr me vete.
Prit. Mos më braktis.
Në çdo braktisje humb ekuilibrin bota.

Mos më lër vetëm në sketërrën e kësaj dite
që ha njerëz dhe përtyp kujtime.

Rri edhe pak. Ti je e vetmja urë
që më lidh zemrën
me anën erotike të universit.
Ti je lumturia ime. Dhe nëse duhet të vdes,
le të vdes brenda ëndrrës
ku të takova për herë të parë.

SHI I ARTË, MË HIDH
NJË YLBER

Shi i artë, më hidh një ylber
Të mbahem nga sytë e saj
E të buzëqeshë qielli im adoleshent.
U përkul molla të të përqafojë
Dhe uji trëndafilloi ëndrrën.

Më hidh ca fije pesëngjyreshë,
Një lumnajë shprese
Një floknajë drite,

Të kapërcej terrin
E të ndez një llambadar yjesh
Në qiellin e dhomës së saj.

Me çelësin e cilit dëshpërim
Ta hap këtë derë kokëfortë,
T'ia shqyjej natës
Kominezonin e mëndafshhtë të ëndrrës?

Lotët e trëndafilit
Purpuruan faqen e mëngjesit.
U zgjova pëllumb në dritaren tënde.

Qielli, merr lotët e mi,
Laji hënëzat e tua dhe fali asaj një,
Të ndriçojë herbariumin e kujtesës.
E të nanuriset mbrëmja
Në karuselin e përqaimit.

BARET VERORE

Dikur nxitonim drejt bareve verore
me xhepat plot mungesa
dhe zemrat me monedha të padukshme.

Një birrë e papirë
na dehte më shumë se nata,
një vallëzim me një trompon të vetëm
na mbante pezull mbi trotuare.

Buzëqeshja e një vajze ishte një zog surreal
që ulej për një çast në supet tona
dhe ikte,
duke na lënë flatra në vend të duarve.

Sot baret janë po aty,
por tavolinat pinë vetminë e njerëzve,
ndërsa vera harron
të marrë zjarr nga gotat tona.

Dhe ne endemi ngadalë,
si hije që kërkojnë ende
vajzat që na buzëqeshën dikur
dhe kamarierin e rinisë.

SOFIA DHE DETI

Sofia, mbesa ime nëntë vjeç,
luan me detin...
apo është deti që ka zgjedhur
të luajë me Sofinë?

Valët zgjasin duar
dhe e duartrokin sa herë qesh,
ndërsa shkëmbinjtë hapin xhepat e gurtë
për t'i falur guacka që mbajnë brenda
zërin e hënës.

Ajo zhytet dhe uji, për një çast,
mbledh një palet ngjyrash
krijon ylbere.

Noton, bëhet gorgonë,
me flokët si alga që ëndërrojnë erën,
dhe peshqit admirojnë notin e saj
si nxënës të vegjël të kaltërsisë.

Dielli zbret nga qielli me duar rrezesh,
i shtrydh flokët, i përkëdhel ballin,
ndërsa deti qesh me shkurpë
sikur të kishte gjetur më në fund
lodrën e tij të humbur.

PRITJE

Të kam menduar gjithmonë,
të shfaqesh si mirazhi i një ishulli
që duket e zhduket mes dallgëve
se ta kërkonte zemra.

Ah, sa të kam pritur,
me orët të varura si lakuriqë nate
në tavanin e heshtjes.

Kapesha nga hallka e pasigurisë
megjithëse, nuk ëndërroja asgjë prej teje.
As dritë, as fjalë, as premtime.
As puthje, as përqafile

Sa e çuditëshme! Mjaftonte të kaloje
si një nimfë e qeshur nëpër gjakun tim,
që mungesa të më shdrohej në flatra.

DORIU I KUJTIMEVE

Jam kapur fort pas kujtimeve,
siç kapet nata
pas krahëve delikatë të një fluture.

Jam varur te ligjërimi i një zogu,
te pëllëmba e një gjethjeje
që më ledhaton ballin me vijat e fatit.

Pastaj shalova doriun e dikurshëm.
- Ku do të më çosh? e pyeta.
Ai tundi krifën e kuqe
si një pyll që digjet pa zjarr.

- Dikur të çoja te dashuria,
ku qielli na hidhte yje mbi supe.

Tani... Qielli përpara nesh
na kërcënon me gremina resh
dhe horizonti është veshur me mjegull.

TRISHTIMI KA DHËMBË.

Trishtimi ka dhëmbë
të kafshon ngadalë, dhe në plagë mbin
një kërcell i thatë që pret me etje
të mësojë ngjyrën e blerimit.

Por trungu
ka harruar gjuhën e pranverës.

Trishtimi ulet përballë teje,
me buzëqeshjen e një pasqyre të thyer,
ta shtrëngon zemrën
si një grusht me zaje lumi.

Pastaj të fal një palë syze dielli.
Dhe ti nuk e dallon nëse ka vdekur pema,
apo rrënjët kanë filluar
të ëndërrojnë një tokë tjetër.

VËSHTRIMI VJESHTOR

Vështrimi yt vjeshtor
troket në portën time.

Ia hap. Hyn në dhomë
me hapa gjethesh të zverdhura,
ulet në kolltukun e heshtjes
dhe ma merr pëllëmbën
si një kiromant që lexon
hartën e një lumi të tharë.

Rri gjatë pa folur.
Pastaj m'i lëshon gishtat.
-Vijat e fatit të janë shuar, thotë.
-Koha e ka braktisur dorën tënde.

Ngrihet. Më kthen krahët, dhe del.
Vetëm vjeshta
harroi pallton e saj
në varësen time.

LULËZUAN PANSETË

Lulëzuan pansetë në ballkon,
lule me ngjyra ylberore.
Në çastin që të njoha,
u bëra Tiresia*) i famshëm,
i verbër në verbërinë e kohës.

Një engjëll zbriti nga qielli.
Ma pastro dëgjimin, o hyjneshë Athina,
ta dëgjoj zërin e saj, simfoni zogjsh,
vajzë-thëllëzë, me krahë të ndritshëm
pritjeje.

Atë mbrëmje shtrove çarçafët,
shtrove lulet e një pranverimi të ri;
shtrati zgjatej në valëzim erotik.
Brenda ferrit, solle aromë parajse.

Përballë pasqyrave ujore
valëvitje këmishën e pafajësisë,
dhe unë ndjeva aromën tënde grua,
aromë dehjeje, hyjneshë e dritës.

Dashuri, qëndron pranë meje,
shëmbëlltyrë e Afërditës,
mes banjave dhe trëndafilave.

Hyjneshë e ëmbël, me buzëqeshje kafshon
mollën e zemrës.
Engjëll mbi tokë,
rreze dielli, më puthin butësisht
sytë gazullorë të mëngjesit.

Trëndafil i jetës,
ti i hap agimit qepallat e detit.
Uji vesh ngjyrën e syve të tu,
dhe bota zgjohet
si një zog në pëllëmbën e universit.

*) Tiresia – profeti i verbër i mitologjisë
greke, të cilit, sipas mitit, iu dha dhuntia e
parashikimit.

FLAKA E TRËNDAFILISHTES

Sytë i kam të mbyllur, verbëri universale.
Një hije ecën pas shpinës sime,
dhe pas saj një hije më e errët
me kamë në dorë kafshon pa mëshirë.

Rri ulur në bordin e anijes dhe ëndërroj...

Një muzg magjik, një botë pa urrejtje,
që ta ngrejë diellin në fronin e mirësisë.
Mjaft më me iluzione!
Një zambak çel
mbi turirin e egër të dimrit.

Cili lumë do të rrjedhë
për të larë mëkatet tona?
Mëkatet e tua, o botë e çmendur,
T'i marrë larg nesh,
të na çlirojë nga prangat dhe paragjykimet.

Përfytyroj një botë...
Mos e kafsho mollën!
Mos iu dorëzo gjarpërit,
dëshirës së tundimit.

Bota nuk e fsheh më lakuriqësinë e saj
pas gjetheve të fikut.
Dje duartrokisja atë që sot e shkel me këmbë,
dhe nesër i ngre përmendore
atij që dikur neverisja.

Hapi sytë o njeri!

Do të doja të isha buzëqeshja
që të shoqëron çdo mëngjes në rrugë.
Jo buzëqeshjet e detyruara,
as fytyra prej maske.

Ndaluni, fotografë,
mos i shtrembëroni fytyrat,
mos falsifikoni mirësinë e zemrës.
Hapeni perden, të vërshojë drita!

Prometeu, Ujori i dritës, i theu zinxhirët,
përleshje me shkëmbin e zgabonjën
lotët iu shndërruan në shkëndija;
kështu lindi flaka
në pëllëmbët e njerëzve.

Dhe ti, që di vetëm të japësh,
ofron supin, që të qani së bashku.
Bota është e plagosur
nga gurët e pamëshirshëm.
E unë pres... shuplakat dashurore
atje ku rreh zemra e trëndafilishtes.

SAPFO-SË

Të njoha në breg të një ishulli.
Një dorë më ftonte nga dallga,
nuk e dija nëse ishte Qiprida,
apo puthja e Hënës
që kishte harruar buzët mbi ujë.

E megjithatë, ishe ti.
Më dhurove një guaskë;
kur e afrova te veshi,
nuk dëgjova detin, dëgjova dashurinë
tek shkruante me pulëbardha
mbi qepallat e erës.

Që atëherë, çdo natë zëri yt
kalon mes oleandrave,
mes ullinjve dhe portokalleve,
duke ndezur hënëza të vogla
mbi gjethet e argjenda.

Sa herë jap një puthje, universi hapet
si një shegë plot yje,
e unë humbas në përjetësi,
atje ku fjalët nxjerrin petla jasemini.

Motër shpirti i poezisë dhe i erosit,
ende ecën zbathur mbi ujë, dhe deti,
që të mos humbasë gjurmët e tua,
pëshpërit përmendësh emrin tënd.

Zylfi Tola

Vajza nga Kolonja që më fali nje dorë thana, dy dardha e ca kumbulla

Tregim

Nëntori 1957.

Në drejtim të Ersekës u nisën dy makina “Zis” me ushtarë nga Kukësi, mes të cilëve isha edhe unë, një 20-vjeçar që bashkoja qiellin me tokën.

Më zgjodhi komisari Spiro Robo mes ushtarëve dhe për dy vjet qëndrova në këtë batalion. Isha shkrues. Në stërvitje shkoja vetëm kur doja vetë, kur s’kishte stërvitje dhe kontrole speciale. Gjithsesi, unë organizoja gjithnjë aktivitete të tjera, politike, artistike dhe sportive, që bateria jonë të ishte nga më të dalluarat.

Në lumin e Taçit, që buronte në themelet e malit madhështor të Gramozit, çdo të diel ushtarët lanin pecet, kambalet e gjëra të tjera personale. Unë shkoja veçmas, gjithnjë më vonë. Njëherë, një vajzë rreth 18–20 vjeçe kaloi aty pranë meje, ndërsa unë po laja pecet; më përshëndeti dhe u kthye, pasi i la lopët në pyll, e më pyeti se nga isha. Unë, me sinçeritet, i tregova se isha nga Kukësi. U përshëndetëm me njëri-tjetrin, më tha ditën e mirë dhe, kur u largua, e ndoqa me sy deri poshtë, kur u fut mes pemëve të lagjes e të shtëpisë së saj.

Ishte vërtet një vajzë e bukur, hyjnore, trëndafil me ngjyra, me trup të drejtë; sytë e faqet sikur nxirrnin shkëndija. Pas dy javësh, unë përsëri u gjenda po në atë vend dhe kolonjarja kaloi përsëri me lopët drejt pyllit. Më përshëndeti përzemërsisht; edhe unë e përshëndeta po ashtu. Kur po zbriste për në fshat, më tha se mamaja e saj i kishte thënë: “Merr atë ushtarin, që t’i japim të hajë si në shtëpinë e vet: përshesh me kos.” Gjithashtu, mbi kapelën time, që po thahej mbi një gur, ajo më vendosi një dorë me thana, dy dardha e ca kumbulla. Vendosa të shkoja, jashtë çdo rregulli ushtarak, në shtëpinë e saj.


Në shtëpi më priste nëna e saj, po edhe ajo, e gjallë e bukur, si portreti i brishtë i vajzës së saj.

Më pyetën hollë e gjatë. Më bënë një tas me përshesh, vetëm me kos, pa ujë. Nuk kisha shumë uri, por më e madhe ishte kureshtja, qoftë për mobilimin e shtëpisë, oborrin e gjithçka tjetër. Them se kam qëndruar gati një orë e gjysmë. Teshat e mia i kisha lënë në breg të lumit dhe u thashë se do të ngrihesha; ato qenë dakord.

Në një letër më mbështollën djathë të njomë, bukë misri, dy vezë dhe një shami të qëndisur me gajtan. U bëra gati të nisesha, siç isha, pa kapele dhe pa rripin e mesit.

Nëna e vajzës doli përpara dhe ne pas saj. Ajo vajzë, te dera e dhomës, ku ne ishim shumë pranë njëri-tjetrit, më puthi në faqen e djathtë, se ashtu ishte pozicioni ynë. Unë u trondita shumë; trupi më mori flakë, por edhe ajo u trondit, gjithashtu. Më përcollën me sy derisa u ngjita në shkëmbinjtë e lumit që buronte nga mali i Gramozit.

U ktheva në repart dhe atë ditë, por edhe natën, jetova me atë vajzë nga Taçi i



Sipërm i Kolonjës.

Në mëngjes, pasi ishte e hënë, kreuva të gjitha veprimet e radhës. Bateria shkoi në stërvitje, ndërsa unë u ktheva në zyrë. Pas një ore erdhi korrieri i shtabit dhe më tha se më kërkonin në komandë.

- Po kush? - e pyeta unë.

- Vetëm kaq di, - m'u përgjigj ai.

U rregullova, mora kapelen dhe gjithçka tjetër dhe u paraqita te oficeri i rojës. Pyeta se kush më kërkonte. Pas disa minutash më thanë të paraqitesha te shefi i sigurimit. Ashtu edhe veprova.

Shefi Koço më priti disi ashpër. U ula. Më pyeti, në radhë të parë, se çfarë bëja në bateri dhe cila ishte detyra ime, pastaj kaloi te shkolla, te karakteristika familjare dhe te pyetjet nëse isha i fejuar, i martuar, i dashuruar etj. Pasi i mori gojarisht të gjitha të dhënat, më pyeti se si njihesha me atë vajzën nga Taçi. I tregova me shumë hollësi si njihesha me të dhe deri ku kishin shkuar marrëdhëniet tona. Unë i shpjegova me ndershmëri gjithçka, ashtu siç ishte e vërteta, por përqaftimin me vajzën jo.

- Ti, - më tha shefi i sigurimit, - je komunist, njeri tepër i besuar për komandën dhe për ne. Ajo vajzë e ka babanë në Amerikë dhe vëllanë e tij në Greqi, të arratisur nga pushteti popullor. Pra, janë me biografi të keqe dhe ti as që duhet t'i flasësh, e jo më t'i shkosh në shtëpi. Po qe se ti nuk do të shkëputesh nga çdo marrëdhënie me të, menjëherë do të të transferojmë në Vlorë. Gjithashtu, nuk do të shkosh më t'i lash teshat në lumin e Taçit. Besoj se u kuptuam. Tani gjithçka e ke ti në dorë, - përfundoi shefi Koço.

U ndamë dhe, kur po më jepte dorën, përsëri më porositi: - Besoj se jemi kuptuar dhe gjithçka mbaje tepër sekret.

Pasdite më takoi komisari im, Spiro Robo, që më donte si djalin e tij. Veç të tjerave, më pyeti nëse kishim marrëdhënie intime me atë cucën. Komisarit i thashë ashtu siç kishte ndodhur, se ajo vetëm më kishte puthur në faqe. Qeshi shumë; vërtet qeshi shumë komisari im.

- Tani, Zylfi, e kupton edhe vetë: me atë çupën shkëputi të gjitha marrëdhëniet, - më porositi ai.

Ashtu veprova. Ajo vajzë kishte pyetur disa ushtarë për mua, vetëm me emrin Zylfi, pa e ditur mbiemrin. Kur kalonte afër repartit ndërsa ne luanim futboll, unë, sapo e shihja, shtrihesha në tokë që të mos më shikonte.

Një histori e largët, plot 60 vjet më parë.

Para pesë vjetësh, së bashku me shokët e mi Ylber Elezi dhe Zyber Jata, shkova në Kolonjë, ku unë, 90-vjeçari, u befasova dhe u mrekullova nga ndryshimet që ishin bërë. Me shumë mall shëtita nëpër repartin tim ushtarak dhe, me nostalgji e tepër i mallëngjyer, kalova edhe andej nga lumi i Taçit, afër shtëpisë së vajzës së mrekullueshme nga Kolonja dhe afër Ersekës së vogël, plot dritë e përballë Gramozit legjendar.

Të nesërmen, në orët e vizatimit teknik nuk punova mirë. Ndieja një si të dridhur, që nga krahët e deri te gishtat e dorës. Më dridheshin në duar edhe vizoret, që nuk i nxirrnin figurat siç duheshin.

– Po ç’ke kështu ti sot? –më foli Valentina. –Vizatimit teknik ti ia ke dalë mbanë! –S’e ndiej veten mirë, –fola unë, –jam në një gjendje ankthi e lodhjeje, sa s’qëndroj dot në këmbë. S’kam fjetur mirë mbrëmë.

– Dhurata, kam kaq ditë që po të shoh kështu, kaq të tensionuar, të shqetësuar... E ke marrë me shumë frikë këtë fakultet. Do sëmuresh kështu! –vazhdoi ajo.

Po i afroheshim konviktit. Pa e vënë re, vizorja në formën e T-së më kishte rrëshqitur dhe po e tërhiqja zvarrë. Pashë se edhe Jakovi me Teodorin ishin aty.

Jakovi u shkëput nga grupi e na doli përpara. –Kaq shumë të rëndon kjo vizore, sa po e heq zvarrë?! –foli duke qeshur e duke u përkulur ta merrte për të më ndihmuar. Mua m’u sulën në kokë fjalët e Despinës dhe ndjeva se po skuqesha. Po më përvëlonin faqet.

Megjithatë, fola duke e ngritur vetë vizoren: –S’e kisha vënë re... Faleminderit!

– S’u mësove që s’u mësove me vizatimin! Por është degë e bukur arkitektura! – tha, duke menduar se gjendja ime e tensionuar lidhej me problemin që tashmë e dinim të gjithë.

–Pikërisht se është e bukur mërzhitem! Se s’e pranoj dot për veten time. Për Valentinën, për shembull, është e bukur.

–Por edhe mua te letërsia më rri mendja...–ma preu ai.

Ngrita supet pa i dhënë përgjigje dhe bëra disa hapa përpara, për të ecur vetëm. Pastaj pa vetëdije, iu ktheva: –E di ç’ke ti, shoku simpatik! Shiko... –por s’e mbarova dot mendimin.

E kuptova që po flisja më kot dhe nxitova hapat për të hyrë në konvikt.

–Ç’pati kjo? –pyeti Jakovi Valentinën. –S’i thashë ndonjë gjë të keqe!

–S’i eci mirë puna sot, –tha Valentina, e sikur filloi të dyshonte se mos kisha dëgjuar fjalët e tyre pak ditë më parë.

Atë ditë s’më hahej as bukë! U futa në qoshen time të studimit, por me gjithë përpjekjet, nuk arrija të përqendrohesha. E ndieja ende dridhjen e brendshme në krahë, në duar e gjer te gishtat. Megjithëse i futa në ujë të ftohtë, bëja lëvizje me ta, por e dridhura qetësohej për pak e rifillonte përsëri. Ashtu shkova në fjetore, e për çudi të shoqeve të dhomës, sidomos atyre jugosllave, rashë në shtrat e përgatitur për të fjetur.

Gjumi s’më vinte. Numërova qindra e qindra dele e qengja. U përpëlita e u përpëlita, por s’qe e mundur. Në të gdhirë shkova në infermierinë e konviktit. Infermierja, sapo më dalloi rrathët rreth syve, kuptoi se s’kisha fjetur dhe isha e lodhur, e tensionuar dhe në akth. Pa folur, më dha një qetësues dhe nuk ndjeva gjë, kur humba në gjumë aty në një shtrat.

Kur më doli gjumi, shoqet kishin ngrënë drekë dhe kishin ardhur të shihnin se ç’kishte ndodhur. Infermierja u këshillua me mjekun e studentëve, i cili erdhi e më vizitoi, duke pasur frikë se mos po kaloja ezaurim nervor dhe më këshilloi qetësi me dhjetë ditë pushim.

Qëndrova aty, pa lëvizur nga shtrati. Në infermieri më mbajtën gjithë ato ditë, ku treguan shumë kujdes. Më jepnin qetësues dhe ankthi sikur u largua. Koka po më qetësohej, mendimet dalëngadalë po më kthjelloheshin. Në ditët e fundit, Valentina vinte dy orë pasditeve dhe punonim, për të mos mbetur pas në mësim, kurse shoqet e tjera vinin menjëherë sa hanin drekën. Kthansipi vinte çdo ditë e më përgatiste ndonjë gjë të lehtë në dhomën e saj. Ishte e shqetësuar e më pyeste si mund të më ndihmonte.

Një pasdreke erdhi edhe Jakovi. Qëllova vetëm, shtrirë në shtrat. Sa e pashë, u kapa te hekuri i kokës së shtratit dhe u ngrita ndenjur, mbështetur në jastëk. Mbaj mend që foli vetëm ai, gjë që s’e kishte zakon. Në fillim për gjëra të ndryshme. Pastaj më tregoi për letrën që kishte marrë nga i ati, si dhe për takimet e tij me babanë tim. Më foli për studimin që bënin bashkërisht i gjithë grupi i juridikut, për motin që po ndryshonte, për dimri në largim etj.

Fliste e lëvizte vazhdimisht dhe unazën që kishte në gisht, e hiqte dhe e vinte prapë, pastaj e rrotullonte dhe vetëm fliste.

Ajo lëvizje e vazhdueshme e ndihmonte, siç dukej, që tëmshmangte kushedi se çfarë!

(Vijon nga numri i kaluar)

Fundviti i studimeve në Beograd dhe afrimi me Jakovin

Nga Dhurata Xoxa

Ndoshta ndrojtjen që ndodheshim vetëm? Më në fund u largua duke më uruar shërim të shpejtë.

–E ndiejmë mungesën tënde, mos vono të vish! –tha në çastin kur mbylli derën.

Pas pak erdhi Kthansipi.

U ul po aty, ku pak më parë ishte ulur Jakovi, e po fliste si e kalonin atë pak kohë të lirë me Skënderin. Unë po haja petullat e pas kaq kohe, diçka sikur po më shijonte.

Papritur Kthansipi thirri: –Po kjo, ç’do këtu? –pyeti, duke rrotulluar në gishta një unazë me një gur të madh të rrafshët e të kuq.

–S’e di! –thashë edhe unë e habitur.

–Po kjo është e Jakovit, unë e njoh! –foli përsëri ajo.

–Ndoshta! –ia ktheva. –Ishte këtu para teje dhe e pashë që po luante me unazën.

–Hëmmm! –qeshi ajo.

–Seç ka këtu... –e më vështronte buzagaz.

–Po asgjë, të betohem! –i thashë dhe u skuqa.

–Do t’i ketë rënë nga dora, kur e rrotullonte në gisht.

–Mirë, po i them të vijë ta marrë, –vazhdoi ajo duke qeshur. –Harresë e zakonshme?

–Me siguri! –ia ktheva. –Merre me vete dhe jepja pasdite, kur të mblidheni për studim.

–E di si t’ia jap, –tha ajo dhe e futi në një kuletë, që hapej e mbyllej me një zinxhir.

Si mbeta përsëri vetëm, u ngrita dhe qëndrova te dritarja, që shikonte nga ana e prapme e konviktit. Dukeshin çati, tarraca dhe ndërtesat e mëdha, rrugët dhe rrugicat që i ndanin e i bashkonin. Prapa murit të konviktit ishte një vilë e bukur dykatëshe. Ndërsa fëmijë të gëzuar bridhnin nëpër oborr.

Vështrova kumbullat që kishin çelur.

M’u kujtua shtëpia, oborri, ne duke luajtur, mamaja duke u kujdesur për lulet. Ajo ishte puna që bënte me aq dashuri në atë oborrin e madh e të gjatë nga porta hyrjes e deri tek ato pak shkallë, kur hyje në shtëpinë dykatëshe të Takove nga Përmeti. Ajo shtëpi i përmblihte të gjithë. Babai, mëma, xhaxhai, një kushëri në papafingo të katit të tretë, dhe katër vëllezërit e mi... Ngjitur asaj shtëpie, në shtëpinë e dytë që kishte ndërtuar babai, rrinte motra ime e madhe, Nora...

“Atje do të kenë çelur lule-kumbullat, –thashë me vete. –Kajsitë, akoma jo!”

Sa do të desha të isha atje!

Shpërtheva në lot. Ajo e qarë malli m’u kthye në dënesë sapo vura kokën në jastëk.

Ashtu më zuri gjumi. Kur u zgjova, ishte errësirë. S’e merrja dot me mend sa ishte ora, por aty kuptova se shenjat e shqetësimit që më çuan në infermieri nuk i kisha më.

Të nesërmen në mëngjes, ende pa u ngritur njeri, zbrita në fjetore.

Shoqet e dhomës sapo ishin zgjuar dhe, sapo më panë, erdhën e më përqafuan me gëzim. U ngritën ashtu si ishin, ca me këmishë nate, ndonjë me pizhame, një tjetër gjysmë e zhveshur e më rrethuan te shtrati im.

Edhe shoqet jugosllave erdhën e treguan të njëjtën dashuri. Më qerasën me ëmbëlsira, që u kishin ardhur nga shtëpia.

Vajzat ndërkohë ishin bërë gati për në mensë. E më pas, të gjitha së bashku, për në fakultet. Ndieja njëfarë shqetësimi, duke menduar shoqet e shokët shqiptarë që, patjetër, do të më flisnin mbi sëmundjen.

Por unë s’do doja as të flisja për të e as të ma kujtonin. “Veç disa minuta do të zgjasë ky takim, – thashë me vete, – e do ta kalojë”. Këto po mendoja, kur po zbrisja shkallët e konviktit. Dhe ashtu ndodhi. Në fakt e kalova me emocion e me ndrojtje, por e kalova.

Nga larg më zuri syri Jakovin, duke diskutuar me zjarr mes një grumbulli shokësh, e padashur vështrimi shkoi te gishtat e tij. Te njëri gisht më saktë. Aty, te gishti i unazës, pashë të shkëlqente ajo unaza me atë gurin e madh të kuq. Sikur ta

ndiente vështtrimin tim, ai ktheu kokën e më pa. Kryqëzuam sytë, buzëqeshi me atë shprehjen aq të njohur për mua dhe ngriti dorën për të më përshëndetur...

Fillova të shkoj rregullisht në fakultet, e si përherë me Valentinën.

Në përvetësimin e gjuhës kishin filluar të ndiheshin ndryshime te të gjithë. Tani kishim arritur të flisnim e t’u përgjigjeshim studentëve jugosllavë jo vetëm në përshëndetje e fjalë të zakonshme, por mund të bisedonim edhe mbi tekstet. Një ditë, në përfundim të leksionit, profesoresha e jugosllavishtes na tha se kjo ishte java e fundit që do punonim bashkë dhe se tani e tutje do duhej të ishim në gjendje t’i përballonim vetë problemet e gjuhës.

Kur dolëm nga klasa prej asaj ore e po ecnim përgjatë korridorit, m’u afrua Jakovi e më foli zëulët:

–Thuaj si të duash, por mua po më vjen shumë keq që përfundoi kursi!

Unë e pashë në mënyrë pyetëse, kurse ai vazhdoi:

–Se s’do kem rast të marr ndonjë letër tjetër nga çanta jote! –tha dhe qeshi. –S’e paske harruar akoma atë të shkretë letër?! –ia ktheva si e zemëruar dhe u largova.

Në të ngrysur, shkova në postë që të bisedoja me të familjes.

I qetësova, kur u fola për shëndetin. Nuk ua dramatizova, sigurisht, por u thashë që kalova një rëndesë nga mësimet, por që tashmë më kishte kaluar.

Kur dola jashtë, te porta, pashë Jakovin. Po më priste.

–Dhuratë, kam dy bileta për kinemanë këtu afër, –më tha, duke më treguar me dorë. –Është një film shumë i bukur!

Unë e pashë disi e çuditur që po më kërkonte një gjë të tillë. Ishte hera e parë që do të gjendesha vetëm për vetëm me të në kinema.

–Mos ki merak! –më qetësoi, duke e vënë re habinë time. –Është edhe Teodori me ne, e me siguri do të ketë edhe të tjerë nga tanët...!

Pranova me sy. I shkova nga pas e bindur.

Te porta e kinemasë po reklamohje filmi “Doni i qetë”. Kur hymë brenda, kuptova që Teodori s’ishte.

–Do të ketë zënë tjetër vend, –tha ai, duke vënë re se po kërkvoja me sy në korridorin e kinemasë.

Hymë në sallë. Vende të lira te radha jonë ishin vetëm dy.

Por s’kishte as Teodor, as studentë të tjerë shqiptarë.

U shqetësova pak, por s’e dhashë veten dhe as pyeta për Teodorin a për të tjerët.

Te doreza e përbashkët e karrigeve ndjeva se na takoheshin bërrylat shkak e pa shkak, por kur puqeshin ama, i largonim menjëherë të dy, sikur të na digjeshin nga zjarri.

Kur dolëm jashtë, Jakovi filloi të fliste mbi filmin, duke e lidhur me romanin. Aty kuptova se sa e vlerësonte ai atë roman dhe autorin e madh rus.

–Film i mirë, –filloi të fliste, –por romani është gjë tjetër. Një botë tjetër për nga shtrirja, nga pesha e dialogut, nga ngjyrat e gjuhës, për nga madhështia e natyrës ruse dhe njeriut të punës, gjithë halle e probleme të mëdha ekzistenciale...

Unë nuk po e dëgjoja, se e kisha mendjen te tjetër gjë, e pa dashur thashë: –Për mua është hera e parë që shkoj në kinema me një djalë!

Jakovi e ndërpreu atë që po thoshte, e vijoi: –Në çdo gjë e ngjarje ka gjithmonë një herë të parë! –tha me zë të qetë.

Nuk po qeshte, siç kishte bërë me letrën. Përkundrazi ishte serioz.

–Edhe unë, për herë të parë në jetën time, harrova në dhomën e një shoqeje unazën! –vazhdoi me ton serioz, e filloi të luante përsëri me unazën. Ecëm pak pa folur e më pas ai shtoi,

duke ndërruar bisedë:

–E di ti, që ky gur këtu është shumë i moçëm, i kohës antike? Është nga Apolonia. Dhe sa shumë e shumë të tjerë si ky janë gjetur! Shumë njerëz atje i kanë gjetur në rrugët për në Apoloni, nxjerrë nga ujërat gërryese të shiut, dhe i marrin brazdave pas shiut e i kthejnë në stoli. Shiko pak, sa interesante

është! – tha dhe hoqi unazën nga gishti e ma zgjati.

Unë e mora dhe po e shikoja më me kujdes, se atëherë kur e pashë në duart e Kthansipit.

Guri kishte një e kuqe të bukur, të vrarë në ngjyrë e jo e shkëlqyer. Vetëm rrethi, i cili kishte zgjatim dy si gonxhe floriri e që mbanin gurin nga të dyja anët, kish njëfarë shkëlqimi.

Në gur ishte gdhendur diçka mu në mes të tij. Ishte një figurë e dukshme, që shëmbëllente me dragua.

–Interesante vërtet, e bukur! –thashë unë dhe e pyeta. –Ke qenë në Apoloni?

–Shumë e shumë herë. Është vend i mrekullueshëm. Dalëngadalë dhe heshtur, ai qytet antik ngrihet në një madhësi tërë dhe më të heshtur, por që të rrëmben e të godet sikur të ishte një dallgë gjigande. Poshtë kodrës së Apolonisë shtrihet fshati Pojan. Ajo kodër, Dhuratë, fsheh ende në gjumë një kohë të lashtë, një histori që bashkon grekët e vjetër me ilirët. Në atë kodër janë zbuluar shumë kolona madhështore, monumente, statuja mermeri të plota e të gjymtuara, objekte të kohës së lashtë. Herë-herë shkojnë grupe me arkeologë, që nxjerrin të tjera gjurmë. Uroj të të vijë rasti t’i shohësh! –mbaroi frymën Jakovi, por nuk zgjati veç një çast, e kur filloi sërish e s’ndalej më.

Binte menjëherë në sy një afërsi, një dashuri shumë e thellë e tij për atë vend. E sa më tepër që e njihja atë, aq më e thellë bëhej ajo dashuri, e sa më tepër i hyra gjatë tërë jetës në thellësi asaj dashurie, aq më tepër zbuloja se ajo që njihja ishte vetëm një pjesë e vogël.

Ishte si t’i ngjiteshe një mali gur pas guri, e diku gjeje një vend të shenjtë; pastaj ngjiteshe e ngjiteshe përsëri, e gjeje një tjetër, e një tjetër si ai e kështu pambarim.

–Në majën e asaj kodre, –vazhdonte ai, –gjen një vend si më të sheshtë, ku ngrihet Kisha e Shën Mërisë, një kishë e vjetër brenda oborrit të manastirit. Që aty njeriu shikon rreth e qark peizazhin e mrekullueshëm, që nuk e harron dot kurrë e që shtrihet deri aty, ku toka shkon e futet në pyll dhe pylli lag detin. Kjo kodër vijon më pas me një tjetër pak më të lartë, në majën e së cilës është ngritur vila e Leon Reit. Që aty, pamja bëhet edhe më madhështore...

–Kush është ky? –s’e lashë ta përfundonte atë ligjërim, por e entuziazmuar nga tregimi i tij.

–Ah, po! Leon Rei është një arkeolog i famshëm francez. Ai ka bërë zbulimet e para të Apolonisë, e në atë kodër që ngrihet mbi manastir është një si vilë njëkatëshe, ku ai ka ndenjur, jetuar e studiuar. Dhe vazhdon akoma. Është kaq bukur atje në Apoloni! –shtoi me sytë nga unë, e me pyetje me to nëse e kishte tepruar. –Zakonisht atje familja ime dhe disa të tjera nga Fieri, –vazhdoi ai,–i bënë piknikët dhe I Majin, dhe ishte një kënaqësi e parrëfyeshme. Ne e kishim shtëpinë në Sop, që është më në jug të Pojanit dhe ndonjë njëqind a dyqind metra larg fillimit të kodrës! –përfundoi ai.

–Lum si ti! –i thashë. –Mua s’më ka rënë rasti të shoh ndonjë vend të tillë! Vende e fshatra të bukur po, kam parë plot. Të tillë kemi rreth e qark Përmetit, qytetit tim nga vij, apo Bënjës ku linda, të cilat janë fshatrat e gjyshërve dhe i babait tim. Apo plot të tjerë. Në Novoselë është një kishë e vjetër, e cila me kalimin e kohës e dalëngadalë po hyn thellë nën tokë. Ka shumë historira për fshatra të braktisura, që po zhduken gradualisht...!

–Mirë! –tha me një si premtim të heshtur. –Ndonjë ditë ti do të shohësh Apoloninë dhe unë Bënjën tënde! Jetën e kemi përpara... –dhe e mbylli bisedën.

Ndërkohë ishim fare afër konviktit.

U futëm në mensë të hanim darkë. Kur dolëm nga mensa e unë po nisja të ngjitesha nëpër shkallë, Jakovi më tha: –Më lejo të të them diçka, por mos u zemëro, se e ke një çikë zakon të zemëroresh e të marrësh zjarr!

Unë ngrita kokën dhe po e shikoja. Ai vazhdoi: –Ky kostumi blu të shkon shumë! –tha thjesht dhe në sytë e tij pashë një si shkëndijë.

–Faleminderit! Por edhe kostumi yt është shumë elegant...! –ia ktheva pa mbaruar fjalën, kompliment për kompliment. Ai qeshi.

Dhe në këtë lloj bisede tëmafërt, u ndamë: ai mori për nga porta për të shkuar në konvikt, kurse unë ngjita shkallët me vrap dhe hyra në fjetore.

Të nesërmen më solli të lexoja disa vjersha, që i kishte shkruar për Apoloninë.

Fillova të lexoj: Agimi apolon Një kohë e bukur përmbi dhe’ në fron, mermeri rri dhe flet e flet si për mijëra gojë. Flet si e gjallë, për djem atletë plot bukuri vajza peri e gjithë dashuri. Me mijëra gojë tregon. E ç’nuk ka parë Ajo! Dikur... E moçmja Apoloni, çdo agim, çdo perëndim. ----- Apoloni, gusht 1942

Ditët merrnin rrjedhën e zakonshme, të lodhshme, monotone. Kalonin për ne ngadalë nga konvikti në fakultet e nga fakulteti në konvikt.

Pranvera kishte ardhur. Moti ishte ngrohur. Kaloriferët nuk ndizeshin më, e pasi pastrohej mensa, futeshim aty e studionim. Ndonjëherë shkonim në konviktin “Gajret”, se atje kishte sallë studimi e mjaft nga ne, që s’kishin nevojë të shkruanin, të vizatonin etj., hapnin librat e studionin edhe në shtrat.

Grupi i studentëve të fakultetit juridik ishte shembull.

Ata ecnin më shpejt me përgatitjen e provimit të parë. Jakovi fliste me emocion, por edhe i kënaqur për provimin që po afronte. Ndërsa unë po përgatitesha pa kaluar as minutën kot. Ankthin e vizatimit e kisha të përhershëm. Sa herë e kujtoja, sikur më shtrëngonte diçka në grykë. Por nuk flisja si më parë me zë të lartë. E pse t’i shqetësoja të tjerët me problemin tim! U kisha folur, kisha qarë para tyre sa e sa herë... E tani e kaloja atë bisedë pa u zgjatur, sa të tjerët mendonin se unë kisha ndryshuar mendim; sikur ajo lëndë nuk ishte më diçka që s’bëhej dot. Nxërkohë filloi puna student-pedagog; studentë të dobët-studentë të fortë; zhvilloheshin konsultime në lëndët më të vështira e, krahas tyre, nisën të bëheshin ushtrimet e parakalimit për 1 Majin. Në ato ushtrime merrnin pjesë vetëm studentë jugosllavë dhe ata me trupat më të mirë. Të tjerët, bashkë me ne studentët shqiptarë, përgatiteshim për parakalim të gjithë bashkë.

Po afronte festa. Edhe kryeqyteti po përgatitej ta priste. Kudo po viheshin pankarta, banderola, pllakate e zbukurime të ndryshme festive. Kurse në qendër po ngrihej tribuna, ku do qëndronte Presidenti Tito dhe udhëheqësit e tjerë.

Dhe 1 Maji erdhi.

Ai 1 Maj qëlloi të ishte ditë e bukur dhe e ngrohtë.

As xhaketat nuk mbaheshin dot. Të gjithë ishim shpërndarë nëpër fakultetet tona, ku do të bëheshim grupe-grupe dhe prisnim të na vinte radha e të parakalonim, së bashku me studentët jugosllavë.

Unë rrija me Valentinën në krah, si dhe me studentë të tjerë, e po prisnim të niseshim në parakalim.

Por edhe aty, teksa ishim të gjithë bashkë, herë flisnim për provimet e herë për periudhën që vinte më pas: pushimet. Sidomos djemtë tregonin gjëra të gëzuara e interesante nga jeta studentore. Por nuk e shmangia dot vështrimin, që më hidhej për “ndonjë” nga ata të fakultetit juridik. Sigurisht te Jakovi! Ku do të ishte? Ç’kishte veshur atë ditë feste?

Por nuk e pashë gjëkundi.

Pas parakalimit, të lodhur nga orë pa fund qëndrimi në këmbë, nga vapa e djersa, u ulëm në mensë dhe hëngrëm shpejt e shpejt dhe u shpërndamë nëpër fjetore a konvikte, si ta kishim bërë me fjalë.

Pasdite dola me Valentinën e me një shok të inxhinierisë të shëtisnim nëpër Beograd, veshur si për festë. Edhe në mbrëmje, me t’u kthyer, preferuam të pushonim në shtrat dhe aty, të hapnim librat për të përsëritur mundësisht diçka.

Jakovin nuk ma zuri syri përsëri as në mensë, as në korridor e as te porta e konviktit.

As Kthansipin dhe Skënderin nuk m’i zuri syri, megjithëse i kërkova t’u uroja festën. Atë

vit 1 Maji qëlloi ditë e shtunë. Të nesërmen ishte dita e Pashkës së Madhe, Dita e Ringjalljes së Krishtit. Shumica e studenteve jugosllave kishin vajtur pranë familjeve të tyre, për ta kaluar së bashku atë të ditë të kremte fetare. Fjetoret thuajse ishin bosh.

Korridoret dhe mensa “ishin pushtuar” nga ne, studentët shqiptarë, por edhe ushqimi ishte më i mirë e më i bollshëm si asnjëherë.

Atë mëngjes Pashke zbrita më vonë se çdo ditë tjetër.

Jakovin përsëri s’e pashë. Por në drekë u takuam papritur te korridori para mensës dhe pa më përshëndetur, pyeti: –Po qysh s’të gjeta dot dje! Ai fakulteti juaj nga ishte futur? Ku s’ju kam kërkuar!

–Po qysh, po qysh...? Ti thuaj njëherë “gëzuar”, e pastaj pyet! –dhe shtova menjëherë, se m’u duk se ngeli keq: –Po ku do të ishim! Aty ku qenë grumbulluar të gjithë studentët. Por në atë mizëri që ishte atje, e gjeje dot gjilpërën?-

Ajo shprehja “po qysh” ishte tipike myzeqare, edhe pse Jakovi e përdorte rrallë, e përdorte sidomos kur kishte shpoti e gëzim, fshehur bashkë në atë fjalë.

–Ke të drejtë! Ashtu ishte dje! Por gëzuar, dy herë gëzuar, një për dje dhe një për sot! –qeshi ai.

–Gjithashtu! –ia ktheva. –Gëzuar e për shumë vjet!-

Hymë në mensë veç e veç. Si hëngrëm bukë e po shkoja drejt shkallëve, më thirri:

–Dhuratë, qëndro pakëz!Ndalova. Jakovi m’u

afrua e kur u mat të më fliste, ndryshoi në fytyrë.

– Të kërkova dje, në fakt... se desha të të them diçka! A takohemi sot pasdite? Bëjmë një shëtitje pranë Danubit. Si thua? A të vij të të marr?! –e po më shikonte në sy.

Unë ula sytë nga forca e vështrimit të tij dhe si pa kontroll më doli ngadalë: –Mirë...

– Po vij në orën katër! –foli i gëzuar e pastaj shtoi: –Vish atë kostumin blu me bluzën e bardhë! –dhe iku me të shpejtë.

Zot, sa u emocionova! Mendja më rrinte në një vend: “Ç’do të më thotë vallë?! Vetëm po ta ketë seriozisht! Ai është shumë simpatik... dhe i talentuar. Ç’do të më thotë? Mos erdhi çasti...?”

Në orën katër, e veshur siç më kishte porositur dhe rregulluar më së miri, zbrita poshtë në korridor. Kisha mbathur këpucë të reja. Ishin në ngjyrë shumë të bukur, midis të kuqes e të verdhës.

Modeli ishte i veçantë. Jakovi i vuri re menjëherë dhe tha: –Ti gëzosh! Qenkan si vezët e Pashkës këto këpucë! I gëzofsh edhe një herë!

Ecëm në ca rrugë e rrugica, ku s’kisha kaluar deri atëherë dhe as i kalova më, më pas.

Më tregoi një letër: –Është nga babai im... –tha. –Do të çuditesh kur ta shikosh ç’ka shkruar!

– Po, lexoje! –i thashë. –Pse më mban në kureshtje?

–Prit, prit edhe pak! –ma ktheu dhe vazhduam të ecnim në ato rrugë të ngushta të Beogradit, që vazhdimisht zbritnin e zbritnin.

Pastaj, për një moment, ato rrugë papritur filluan të ngiteshin e të ngiteshin. Përballë nesh ishte një malore mjaft e thiktë, e cila mbaronte me një majë shumë të lartë dhe të kreshtë.

–Sot do të shkojmë atje! –foli ai, duke marrë frymë një hop. –Kur të ngitemi lart, do të shohësh një pamje që zor se mund ta shohësh përsëri. Një panoramë, që do të ngelet në mendje për gjithë jetën. Atje lart do të shohësh malin ku vishet me gjelbërimin e pyllit, ndërsa poshtë do të shohësh bashkimin e madhërishtëm të dy lumenjve: Danubi madhështor dhe Sava gjithë ngjyra! Nga aty do të shohësh si pleksen dhe bëhen njësh të gjitha llojet e ngjyrave e të lartësive të ndryshme-, përfundoi ai me pasion.

Nuk mbaj mend ç’pashë në të vërtetë, aq shumë u mahnita nga ajo bukuri e vendit.

Poshtë nën këmbët tona vështrova lumin Danub, që diku sikur gjarpëronte në një lugine me gjelbërim, ku vinte qetë-qetë lumi Sava, i cili rridhte e shndrinte nën rrezet e diellit në mijra e mijra përngjyime grimcash ajri e uji përzier bashkë, derisa arrinte te vendi ku bashkoheshin! Sa madhështore! Sa e mrekullueshme!

–As po të vjen më në mend letra! –buzëqeshi Jakovi.

Ktheva sytë nga po vinte zëri. Jakovi kishte ndaluar e po hiqte ngadalë petalet e një luledeleje: –Po, jo, po, jo, po...-filloi me një zë gati fëmije.

Ia mora lulen nga duart e qesha: –Po luan si fëmijët?



–Aspak! –ma ktheu. –Nuk po luaja, po parashikoja...!

–Ma trego atë letërën, lëre lulen e deles!

–Por, a do ta kesh mendjen te letra, se sikur u hutove fare!

M’u duk se nuk e kish mbroth ta hapte atë letër.

–Epo s’kisha parë deri më sot një vend të tillë! Këtu si në taracë dhe poshtë shtrihet ajo luginë e bleruar dhe madhështore! Kemi pesë muaj në Beograd dhe s’kemi ardhur kurrë deri këtu. As me korin, nuk kemi ardhur ndonjëherë...!

–Ky është “Kalimekdani”, parku më i madh e më i bukur i Beogradit!

– Mirë...!- e ndërpreva, -Tani na e lexo tani se ç’të thotë babai.

Dhe ai fi lloi të lexojë, e unë dëgjoja përherë e më e habitur: “Mua dhe nënës na vjen mirë që shoqërohesh me vajzën e Takove. Na gëzuan edhe fjalët që na shkruaje për të. Ne themi ta mbarosh... S’ka gjë se je më i vogël se Lekoja. Ti e di, që dhe unë ashtu u fejova me Marien, përpara Uanit...”

(Tani që po shkruaj këto radhë, nuk mund të mos buzëqesh, se m’u kujtua se edhe më pas, nga dy djemtë e mi, Arbeni e Agroni, Agroni u fejua dhe u martua përpara Benit. Dhe kur u fejua Agroni, Jakovi më tha me atë të qeshurën e tij:

–Edhe brezi ynë i ri e “respektoi” traditën e familjes Xoxa. Prej katër brezash te ne, i vogli martohet përpara të madhit.)

Vazhdonim të ecnim në heshtje. Unë rrija si e ngrirë, sikur kisha harruar të flisja, sikur nuk po më bënin përshtypje ato bukuri që shfaqte “Kalimekdani”, sa më shumë hapsirë kërkonim të rroknim me sy.

–Po ti, Dhuratë, ç’mendon? –foli ai më në fund, duke më kthyer në vete.

–Më erdhi kështu papritur... Jam e emocionuar... e habitur, e papërgatitur e, njëkohësisht, jam edhe e lumtur..., e gëzuar...! –fola, duke kthyer sytë e përlotur nga ai.

Edhe Jakovi ishte shumë i mallëngjyer.

Më mori për dore. Gishtat tanë, për herë të parë, u lidhën me njëri-tjetrin.

Ecëm pak kohë pa folur, me kokën ulur, si të kishim bërë ndonjë mëkat apo nga pesha e mendimit. Herë pas here shikonim njëri-tjetrin dhe buzëqeshnim. Pastaj erdhi aq natyrshëm. Ai ndaloi një çast... Po e prisja... U kthee nga unë dhe ma mori kokën me të dyja duart dhe ma afroi drejt vetes...

Më përqafoi, pa kërkuar të më puthte... Dhe ashtu do të rrijë tek unë ai moment, derisa të iki...!

–T’u them gjë njerëzve të mi, kur të flas në telefon? –pyeta, ndërsa zemra më rrihte fort.

–Shpresoj që edhe ata ta presin po ashtu si prindërit e mi! Do të shkojmë të flasim bashkë me ta–tha dhe më shtrëngoi dorën fort.

Nga aty u kthyem në një restorant të vogël, ku hëngrëm darkën vetëm ne të dy.

E para darkë bashkë, jashtë sallave dhe

mensës së konviktit.

Ai porositi gjeldeti me pilaf. Por gjuha dhe fjalët ama, sikur fsheheshin nga ne. Jakovi, si për ta thyer, zuri të fliste për pulat e detit të Myzeqesë së tij. Unë dëgjoja dhe qeshja. Gjella ishte shumë e

shijshme, por as që e kishim më mendjen aty, as unë, as ai.

U ngritëm, ndonëse pjatat ishin ende plot. Ajo mbrëmje ishte dhe e para, që po kthehesha në konvikt

aq vonë.

Te një lulishte e vogël, pranë një ndërtese të bukur zyrtare, ai ndaloi. Ndalova dhe unë dhe u ktheva me fytyrë nga ai.

–Shëtitja e sotme sikur kërkon ende të plotësohet me një diçka të veçantë... –foli ngadalë, e m’u afrua e më përqafoi përsëri: –Puthjen e parë i riu as di ta japë, as di ta marrë, as di ta fshehë...! –tha duke më puthur.

Ishte puthja e parë. Puthja e tij e parë dhe puthja ime e parë. Ishte dita 2 maj.

(Këto fjalë, më pas, ai i shkroi te romani “Lumi i vdekur” për Vitën dhe Adilin, por të dy e dimë, se ato ishin kushtim i takimit tonë të parë).U ndamë te shkallët e konviktit tim. Unë s’fola me njeri se çfarë kishte ndodhur atë pasdite. Por të nesërmen në mëngjes, sa zbrita shkallët dhe u nisa për në mensë, ata të “Gajretit” më dolën përpara e më përqafuan, duke më uruar. Vetëm Teodori qëndroi disi ftohtë. Po kështu bënë, por më pak, edhe ata të konviktit tim.

Ndjeja sikur babait s’do t’ia thosha dot, sidomos tani, që s’ishte më një e fshehtë që na përkiste vetëm ne të dyve. Kështu, si fillim kërkova në telefon të flisja me vëllanë e madh, Llukën, i cili punonte shef administrate në Teatrën Popullor. Ai e kishte ndier simpatinë tonë nga ç’i tregonte babai për njohjen e takimit me prindërit e Jakovit dhe kishte pyetur drejtorin e vet, K. J-në, nëse e njihte dhe ç’përshtypje kishte për Jakovin.

Drejtori i kishte folur shumë mirë. Dhe ai jo vetëm u gëzua kur i thashë që i kishim dhënë fjalën njëri-tjetrit, por më uroi shumë i emocionuar.

Në mbledhjen e parë që bëmë me studentët shqiptarë të Beogradit, blemë karamele dhe qerasëm të gjithë. Ne, të gëzuar e shend e verë, pritëm urimet e tyre. Por “përgjegjësit” tonë sikur s’i erdhi dhe aq mirë, e mezi na dha dorën. Kishte frikë mos ua varnim mësimëve apo mos edhe të tjerë fillonin e lidheshin me njëri-tjetrin.

Nga ana jonë na dukej se kishim vepruar drejt, aq më tepër që edhe prindërit tanë ishin aq të gëzuar! Nuk e kuptuam atë sjellje të tij, kur ne e dinim që ai dashuronte një studente dhe takohej me të, madje e dinin të gjithë se takoheshin në një dhomë, diku, por ai kurrë s’kish marrë guximin ta shpallte hapur.

Studimin e vazhduam si më parë. Ai me grupin e juridikut si në fi llim, kurse unë o me

Valentinën, o me vizatimet e mia të mjera. Por pasdarke, nuk rrinim me të tjerët, por bënim nga një shëtitje të vogël.

Erdhën provimet. Fundi i majit, fillimi i qershorit.

Të parët do të hynin në provim ata të juridikut. Iu luta Valentinës dhe shkua bashkë te fakulteti, ku do të jepnin provim. E gjetëm edhe sallën e provimit dhe po rrinim te dera, duke pritur të hapej e duke u hedhur përpara, sa herë hapej porta dhe dilte ndonjë student.

Një herë të vetme, më pas, e pashë Jakovin në një auditor provimi, dhe s'e harroj. Ishte aq i përqendruar te marrëdhënia profesor-student, sa s'e kishte mendjen tek asgjë tjetër. Shikonte jashtë asaj salle. Aty vura re sidomos sytë e tij. Atë ditë, si rrallëherë tjetër, sytë e tij ngjyrë gështenjë më janë dukur aq të mëdhenj, të butë, të ëmbël, të dhimbsur dhe sikur i shkëlqenin nga diçka brenda tyre.

Kur u takuam, ia shpreha këtë dhe ai më tregoi: –Edhe një vajze tjetër, disa vjet më parë, i pëlqenin shumë sytë e mi! Edhe unë e pëlqeja shumë... për bukurinë. Ishte vërtet e bukur, në fytyrë e në trup. Ishte vajza e tregtarit, në dyqanin e të cilit unë isha çirak. Dhe gëzohesha, kur tregtari më dërgonte me ndonjë porosi në shtëpinë e tij. Sepse do të shikoja atë. Dhe ajo dilte, më hapte portën, më pyeste për diçka e skuqej. Më jepte edhe ndonjë frutë.

–Çfarë të jepte, mollë? –e ndërpreva duke qeshur.

–Ç'të kishte! –ma ktheu po me të qeshur, e duke e marrë kuptimin e mollës sipas stinës. –Po pastaj, ç'ndodhi? –pyeta unë duke qeshur.

–Ajo ishte më e madhe se unë. S'bashkoheshim dot., ma ktheu butë. –Atë e fejuan prindërit, kur unë punoja ende çirak dhe s'kisha mbaruar as shkollën. Ohuuu, sa rrugë kisha unë përpara, sa të arrija atje ku ishte ajo! Por dukej që e pëlqenim shumë njëri-tjetrin, aq sa aty nga fundi e kuptoi edhe i ati dhe s'më dërgonte më në shtëpinë e tij me porosi...

–Po E-ja u martua me atë që i njohën prindërit, apo si? –foli ashtu si kot.

–Sigurisht! –ma kfheu, –Përpara dasmës më dërgoi fotografinë time, që ma kishte kërkuar dhe ia kisha dhënë si kujtim. E merr me mend se çfarë i kishte bërë fotografisë? –përfundoi, me zërin gjysëm hokatar gjysëm serioz.

–E kishte njomur, prishur me lot?

–Joooo, –tha ngadalë, –i kishte shpuar të dy sytë me gjilpërë dhe dukeshin si qorr.

–Pra, e paskam pasur diçka të përbashkët me E-në? –i thashë.

–Të përbashkët?! Hë, po, sytë... –foli ai.

–Po, sytë e tu! –ia ktheva.

–Edhe E-ja i pëlqente me sa duket shumë sytë e tu.

–Shiko, se mos bën si ajo, –tha hokatar. –Ajo m'i nxori sytë në fotografi, se vetëm aty i kishte. Se mos të shkon mendja dhe bën si ajo, se ti më ke të gjallë! –qeshi me gaz.

–Kushedi?! Kjo varet nga ti! –iu përvësua.

–Po qysh?! –tha ai pyetjen e përbashkët. –Po qysh?! –ia ktheva unë.

Kur u ndamë te porta e konviktit, më zgjati një letër të palosur e më tha:

–Lexoje, e kam shkruar për ty! Ishte një vjershë...

Qershia

Si një nuse plot kurora, lulëzonte një qershia dhe dhëndurët fletë-fl etë, vinin e puthnin

ca stoli,

ca stoli mbi gush'e faqe, çelur-çelur, për çudi!

Edhe bari me të mbirë rriti-rriti bukurinë, puthi rrënjët, puthi gjethet, po s'arriti gjer në gji.

Dhe zogjtë e bletët fletë-fletë vinin e ndillnin dashuri.

Priti, prit bar i shkretë të ikë dielli, të ikin retë

e ta ketë qershinë vetë.

Po stolitë zunë të rrallohen, zogj e bletë po largohen.

Qeshi, qeshi bar'i shkretë me stolit' në gji të vet.

Dhe qershia shtathedhur, nuk u mburr me ca stoli!

Qe një frym'e shkuan e vanë, po ç'frut i lanë pas, në gji!...

(Bukuria e jetës dhe qëllimi i saj ndrijnë jo te lulet, por te frutet)

Beograd, 20 maj 1948

Vështrime semiotike për romanin “Gega i Motit”

Nga Viktor Gjokolaj

Mbi gjithë çfarë është thënë deri më sot për romanin Gega i Motit të Ernest Markut, mendoj se ia vlen të shtohet edhe një vështrim në rrafshin semiotik, pra një analizë e mënyrës se si ndërtohet dhe funksionon narrativa përmes sistemit të shenjave.

Semiotika pohon se çdo strukturë narrative qëndron në themel të shumë formave të ligjëritit dhe jo vetëm të atij letrar.

Narracioni është i pranishëm edhe në diskursin politik, sociologjik, juridik e kulturor. Madje, mund të thuhet se ai qëndron edhe në bazën e konceptit tonë për të vërtetën. Studimet bashkëkohore mbi diskursin juridik kanë treguar se dëshmitë që ndërtohen sipas modeleve arketipore të rrëfimit perceptohen si më bindëse dhe kanë më shumë gjasa të besohen.

Një tjetër parim themelor i semiotikës është ai i niveleve të kuptimit. Niveli i thellë abstrakt prodhon strukturat sipërfaqësore të tekstit. Për këtë arsye, një vepër letrare duhet të lexohet jo vetëm në planin e dukshëm të rrëfimit, por edhe në shtresat e saj të fshehta ku ndërtohen kuptimet simbolike dhe kulturore. Në këtë drejtim, analiza semiotike mbështetet në modele interpretimi që ndihmojnë në dekodimin e mekanizmave të prodhimit të kuptimit.

Që në titull, romani hap një horizont të gjerë interpretimi. Togfjalëshi Gega i

Motit ngërthen dy shenja me ngarkesë të madhe kulturore. Emri “Gegë” e orienton lexuesin drejt identitetit historik dhe kulturor të Gegnisë, ndërsa “Moti” nuk nënkupton vetëm kohën kronologjike, por historinë, mitologjinë, folklorin dhe kujtesën etnokulturore.

Në këtë kuptim, romani shfaqet si një trupëzim artistik i një bote që bart vazhdimësinë e traditës shqiptare. Vetë “moti” na kujton se libri i parë në gjuhën shqipe u shkrua në dialektin gegë, pa përmendur këtu veprën e Budit, Bogdanit dhe autorëve të tjerë të letërsisë së vjetër shqipe.

Që në fillimet e krijimtarisë së tij, Ernest Marku është dalluar për përpjekjen për të ndërtuar një letërsi që largohet nga modelet kanonike të narrativës tradicionale.

Librat e tij të parë u botuan me siglën “Letërsi spartane”, të cilën autori e shpjegon si një mënyrë të shkruarit të përmbledhur, me dendësi mendimi, nëntekstesh dhe kontekstesh.

Edhe gjuha përbën një shenjë të rëndësishme identitare në krijimtarinë e Markut.

Ai parapëlqen të shkruajë në gegnisht dhe përpjekjen për të njohur e sistemuar shtresimet leksikore të saj e ka materializuar jo vetëm në prozë, por edhe në fjalorin Fjalë të turitme të gegnishtes letrare. Në

parathënien e këtij botimi autori shkruan:

“Kjo vepër duket surreale qysh në titull, pasi gegnishtja letrare, në kuptimin e një standardi, nuk ekziston. Sot është thjesht ëndrra për një gjë të tillë, ëndrra e Fishtës, Camajt, Koliqit, Mjedës, Zarishit, Migjenit, Shkrelit, Gjeçovit, A. Pashkut, Prenushit, Jak Zekajt, Mekulit, Donat Kurtit, Bernardin Palajt e shumë të tjerëve.”

Në romanin Gega i Motit autori mban një qëndrim më të moderuar ndaj standardit, duke përdorur një regjistër të ndërmjetëm ku gegnishtja shfaqet jo vetëm si zgjedhje stilistike, por edhe si bartëse e kujtesës kulturore. Në këtë mënyrë, shtresa dialektore nuk kufizohet në funksion estetik, por kontribuon edhe në pasurimin e shprehësisë së gjuhës shqipe.

Edhe hapësira ku zhvillohen ngjarjet është shenjë me funksion semiotik. Relievi verior nuk është thjesht sfond gjeografik, por pjesë organike e identitetit të personazheve. Gjuha që ata përdorin, sidomos në pjesën e parë të romanit, është ajo e folësve të këtij areali.

Dialogët ndërtohen me një dramaticitet të përmbajtur dhe me nëntekste që kërkojnë një lexim të kujdesshëm. Ata rikrijojnë atmosferën e odave, të kuvendeve dhe të pleqnimeve tradicionale, ku fjala fiton autoritet simbolik.

Raporti i autorit me të drejtën dokesore është përgjithësisht vlerësues, ndonëse jo gjithmonë i njëtrajtshëm.

Kjo lidhet edhe me debatet dhe keqkuptimet që kanë shoqëruar ndër vite këtë trashëgimi të rëndësishme juridike dhe etnokulturore shqiptare.

Nga pikëpamja kompozicionale, ndarja e romanit në një introduktë dhe dy pjesë krijon një kontrast të qartë ndërmjet dy realiteteve psikosociale të shoqërisë shqiptare, duke i dhënë strukturës së veprës një ekuilibër të menduar artistik.


Në pjesën e dytë vërehen disa tipare karakteristike të prozës bashkëkohore. Autori ndërhyr në rrëfim, komunikim me personazhet dhe ndërton skena që paraprijnë zhvillimet e ardhshme, duke përdorur atë që mund të quhet proknozë narrative. Edhe në letërsinë shqipe kjo teknikë është përdorur, ndër të tjera, nga Ben Blushi në romanin Komploti.

Një element me interes semiotik paraqet edhe mënyra e komunikimit ndërmjet personazheve. Marrëdhëniet intime dhe flirtet, që dikur ndërtoheshin përmes shenjave të heshtura, vështrimeve, gjesteve apo letërkëmbimit, tashmë zhvillohen edhe përmes teknologjisë digjitale. Zemra, ikonat dhe figurat grafike përbëjnë shenja të reja të komunikimit, të cilat kanë zgjeruar sistemin semiotik bashkëkohor dhe kanë ndryshuar mënyrën e ndërtimit të mesazhit.

Në këtë kuptim, përdorimi i shenjave nuk e pasuron vetëm komunikimin, por ndihmon edhe në organizimin e strukturës narrative. Kuadrati semiotik nuk paraqet vetëm marrëdhëniet e kundërshtimit ndërmjet kategorive kuptimore, por ndriçon edhe mënyrën se si këto marrëdhënie projektohen në sintaksën narrative dhe në organizimin e kuptimeve të veprës.

Vetë termi semiotikë rrjedh nga fjala greke semeion, që do të thotë “shenjë”. Në shekullin XVII, filozofi John Locke e përkufizoi semiotikën si “doktrinën e shenjave”, pra disiplinën që studion natyrën dhe funksionimin e tyre në procesin e të menduarit dhe të komunikimit.

Në këtë prizëm interpretues, Gega i Motit shfaqet si një roman ku sistemi i shenjave artistike ndërton një univers të pasur kuptimor. Përmes mjeteve stilistike, simbolikës kulturore dhe shtresëzimit të gjuhës, autori i përcjell lexuesit dije, emocione, imazhe dhe mesazhe që ndërthurin traditën me bashkëkohësinë. Për këtë arsye, romani përfaqëson një arritje të rëndësishme në krijimtarinë e Ernest Markut dhe një kontribut me vlerë në prozën shqipe të ditëve tona.



DITËLINDJE

Më shkrep të gjej fjalët e një urimi
Ditën e të lemit tand në bjeshkën e bortë
Të shkruaj, si këso rastesh, një kartolinë...
Asht fillim prilli, po vijnë Pashkët,
Çfarë mund t'i thuash më shumë njeriut
Se fjalët e Zotit - në ringjalljen e tij?

ME TË DASHT TY

S'e njoh gjithësinë si një lundruës qiellnajsh
Me tejqyrat ngritun mbi grataçelät e nalta,
S'e di nëse toka sillet rreth diellit a dielli rreth tokës,
Apo secila prej tyne asht thjesht një lodër?...

S'e di nëse mesnata asht fundi a fillimi?
Sa gjana të tjera s'di e s'kam me i ditë kurrë
S'mi thotë tejqyra ngado ta kthej hapsinë,
Aq ma pak kur shoh si andrrimtar kah qielli,
Jo për gja, po me dasht ty asht çeshtje shpirti
Në tokë, mes drandafillesh, jo mes yjzish!

Me dasht ty do me thanë me kcyë vals
Deri në krye të ditës, deri në muzg të jetës.

Grue ti e ban botën të rrotullohet rreth teje,
Pa ty ajo s'do të kishte ditë me qesh,
Thuej po deshe që s'je i vetmi planet?

MOSKOHË

Të shoh si ecën me hap të shpejtë
Udhës së qytetit shtruar me gur të shkruë,
Gjithnjë vrikon të njëjtës rrugë, përditë,
Ku shkon si një drenushë e hutueme?
Askush s'të pret prapa muresh veç meje,
Askush s'të lanë me shkumën e detit
Pos duarve të mia që zgjatën në pafundësi,
Të të rrokin për mesi si një shtojzovallë.
Nxiton të mbërrish diku në moskohë
Ku bota nuk shihet, por është po ajo...
U mësuam me këtë ritual *pagan*,
T'i ikim njëri-tjetrit, a thue se jemi në faj?
Si mundet kjo mos me qenë dashuri!
Ngado që të shkosh e sado të mos vish
Ti je prapë ajo e para, je ti...

LUL(J)A E RUBIGUT

Fabian Barkatës

Ku je? Unë të njof. Ku më paske humbun
Askush nën këtë shkrep s'asht se ti ma e bukur!

Lulja nuk mund të bahet nuse më thanë
Askush s'mund të thirret dhandër prej saj
Lula asht zanue prej zanës së Velës,
Do ta mbysin me gurë si Maria Magdalenën,
Jo njerëzit, se ata janë makatarë si ajo
Po shtrigat a kulshedrat a katallanët
Qeniet e frikshme me një sy në ballë!

Nuk mund të hysh për Lulen dorëzanë
S'mundesh me e shpëtue për të gjallë,
Veç për së vdekuni mundesh, hinin e saj!...

ATI YNË QË JE NË TOKË

Ati ynë që je në tokë,
po të lutem si i lutej Ndoc Gjetja
Tën'Zot - ani se ti je rob.

Rueje shpirtin nga t'zhigatunit
nga erenitë zemrake lindun prej gjakut
nga hajnat e bracat për çdo ferrë,
rueje në ballë një gisht nder...

Po të lutem ty që nuk je zot
rueje shpirtin nga shkimja e virtytit,
rueje gjakun mos të bahet uji,
ruejna nga qoftlargu me vulë.

Ati ynë në tokë - që je unë
lutu që i mbinalti At' i qiellit
mos të na lë në anën e hijes...

MOLLA E NJUTONIT

Ajo kokërr mollë
shkëputet nga dega si një meteor
e bie lehtë në dorën time
e kuqe, e verdhë, e gjelbër,
unë asnjëherë s'e mbaj për vete
ta hedh ty në prehër...

NDUE DEDAJ

Ati ynë që je
në tokë
Poezi

Nuk di si do të kishte qenë
nëse molla s'do më binte mua
si një globth në dorë
po do ngjitej drejt qiellit,
me siguri do zihesha me Njutonin,
ku të gjeja për ty një tjetër mollë?

Mollën e Adamit e kishin ngrënë
gjith' njerëzit para nesh me babëzi...
Atë mollë që tash sa mot
ti e ndanë me mua përgjysmë,
i pandërruar ky ritual
kjo alkimi...

Këputet ajo kokërr mollë
e bie në sytë tanë si një meteor;
të mos binte në tokë si farë,
njeriu do të mbytej nga vetvetja
ngase s'do të mundej
me ra në dashuri.

KANTATË E RE

Besianit

Ti ecën nëpër tokën “me gjuhë të fshehtë”,
Kozencë, Shën Mitër Koronë, *San Cosmo Albanese*,
Gjithkah me fytyrën e të madhnueshmit Skanderbe,
Ti e njeh atë gjuhë, asht folja jote e lisit të gjakut
Shkojnë e vijnë zogjtë e detit tash pesëqind vjet.
Ka ardhë sot për ty i madh e i vogël arbëresh
Milosao degën e ullinit ta lidh mbi krye kunorë,
Burrave iu qet kupat me venë të kuqe Kalabrie
Rina sajdis vashat me kanistrat plot mollë...
De Rada përkulet mbi regjistrin dymijëvjeçar
Shkruen solemnisht përgamenën tande *dyzet e nji*
Asnjëherë nuk kryen Rapsodia e tij...

25 shtator 2025

KA MUNGESA

Po ecja qytetit mesit të majit
ndërmend ktheva kryet anash
andej kah *duhej* të ishte ti,
u nisa të ngjisja shkallët...
ndoshta mes nesh kishte mbetun
pa u thanë ndonji amanet,
s'kishin mjaftue njëqind vjet,
ndoshta moti po mbante i vranët
e ti doje diell për ne në çdo hap,
porositë tua ndoshta s'kanë krye
e s'kanë me krye asnjiherë -
treqind e gjashtëdhetë e pesë ditë
s'qenkan asgja për mungesën tande,
ka mungesa që gjithë jetën
s'do të mësohemi me to...

15 maj 2026

ALEKSANDRI I MADH

Kaloj përherë rrugës “Aleksandri i Madh”,
I lagjes tonë të re ai ngjanë si një kumbar,
Kundrojmë lëvizjen e pluhunt nën Dajt,
Ai si perandor i rruzullit, ne si qytetarë.

Nuk jep konferenca shtypi për ngjarjet n'botë,
Ani se i di të gjitha dhe ka shumë se ç'thotë,
Vizitën e presidentit amerikan Trump në Pekin
Turrin për te Xi Jinping të shefit rus Putin.

Kështu e do gara, maratona e luftës e paqes
Si mos të mbyten në Hormuz fuqitë e naftës,
Si mos të bien predhat breshën mbi Hiroshimë
Si të lindë dielli me rreze prap mbi Ukrainë.

Çelin mimozat, harlisën degët, bien gjethet
Rroposën në vetvete shekujt para e pas Krishtit;
Ai mbërthye në një tabelëz në Unazën e Re
Mes blinëve e rapeve djersitun prej trafikut.

Kaloj herët e vonë rrugës së Lekës së Madh
Si gjind epokash rrufisim kafet në të njahtin bar,
Ne qeshim pa shkak - ai i menduem si Aristoteli:
Ah të mund ta endnit botën si Homeri!...

Tiranë, maj 2026

TAKAT BLU

Mund të ndodhë mos me u njoft ma për fytyrë
Nga pluhuni i moteve mbi flokët tanë ngjyrar,
Mund të ndodhë mos me u njoft nga ecja si dikur
Kërrusja e lehtë e shtatit si shëlg lotues,
Por do të njof patjetër nga zani yt i gurëzuem,
Sytë sy kroje të kulluem ahesh bjeshke,
Muzika e takave blu nëpër korridor
Që më shumë ikën se vjen tek unë...

U TUTA

Të kam pa veshun me të gjitha ngjyrat,
të shkonin aq shumë, të rrinin aq bukur,
po sot të pashë me një xhakëtë të purpurt
dhe u tuta, zemra si asnjëherë m'u drodh
nuk due që këmishën tande të pikturueme
ta veshë një stinë, që nuk asht e jona...

FRYMË

Në tapinë time s'ka asgja landore
kurrfarë sendesh që shiten e blihen
mademe vezullues e vreshta si të Dionisit,
përrenj malor që kërcëjnë shkrepave si ketrit
dete të gjallë kumbues e dete të vdekun
ara që mbillen me grurë e kallamoq,
toka që pushtohen mbi e nën dhé
kufij që vihen ditën e prishën natën -
në bujtinën time me flatra tingujsh
pres e përcjell kalorës të lashtë e rinj
të kësaj bote me lahutë e xhaz...

LUFTA E TRETË

(rapsodi moderne bese)

Mbas Luftës së Parë, Luftës së Dytë,
Luftave që vrasin tokën e qiellin
Javë për javë, ditë për ditë, orë për orë
Shiut të përgjaktë si atëherë n'Trojë
N'mëni të dragojve e kulshedrave -
Due me i marr gjithë njerëzit në besë,
T'i mbështjell mes krahëve Ajkunat,
Omerët e sapolindun t'i ruej në gji...
Djallit t'ia heq gishtin nga kambëza,
Globit i asht hollue aq fort lëvizhga
Sa mundet me iu thye si një vezë...
Kurrë mos pastë gurgac, unur e eshkë
Me kall t'nemunën Luftë të Tretë!

KOHË PASHKËSH

A i ndjen si këndojnë krushqit e lahutës?
Ata kanë ardhë nga larg për ne
Shtegtojnë Egnatias nga era e re.

Ah të ishin ato motet tanë të dikurshëm
Do kisha marrë detin në kambë si Serembe,
Ani se lirikat do i përpinin dallgët...

S'mbahet mend qysh se jemi dashtun,
Po afron me u mbush një faqe njëri
Nën këtë diell të pagëzuem në shi.

S'e dimë dhe sa lule do mbajmë në duer
Sa shira do na lagin, sa erna do na terin,
Sa eshkë me unur e gurgac do ndezim.

A i ndjen si këndojnë krushqit e lahutës?
Ata kthehen veç për ringjalljen
Shtegtojnë e s'ndalin nga era e re...

TRANDAFILA

Ka humbun era e luleve parqeve të blertë
Lulishtarët tash rrisin lule të ftohta pa erë,
Kanë humbun nuhatjen dhe qentë e rrugës
Ndihet veç era e Kopshteve të Babilonisë!...

Derisa dridheshja nga emocionet që nuk isha në gjendje t'i frenoja, një mendje e marrë më tha: si nuk e kupton që në djep gjendet fëmija yt, të cilin e ke sjellë në jetë para shtatë e ndoshta më shumë ditësh. Fëmija im, më duket sikur kam klithur me zë të lartë, sa shumë po gëzohem që e kam sjellë në jetë fëmijën tim, i cili më shkaktoi dhimbje të tmerrshme, nga të cilat nuk e kuptoj si arrita të shpëtoj pa vdekur. Për të shtatën herë e zgjasja dorën për ta prekur fëmijën në djep, po dora nuk më lëvizte. Sa shumë kisha dëshirë ta largoja faculetën e ta shihja fytyrën e fëmijës, ta shihja nëse ishte djalë apo vajzë. Mوندohesha të kujtoja çfarë më kishte thënë mjeku për gjininë e fëmijës, po mbi kujtesën time ishte shtrirë gjerë e gjatë një mjegull e zezë, e cila nuk më lejonte të shihja asgjë. Dëshiroja ta shihja fëmijën nëse më kishte ngjarë mua apo Dritit, i cili gjithnjë kishte bindje sikur fëmija do të ishte djalë, madje do t'i ngjante shumë atij jo vetëm në pamje, po edhe me mendje. Shpeshherë jemi grindur me të. Unë gjithnjë e kundërshtoja duke i thënë se fëmija do të ishte vajzë dhe se do të më ngjante në të gjitha aspektet mua. Në fund i thosha me bindje të plotë: edhe vajza jonë do të bëhet mjeke, madje gjatë kohës sa punon në spital do të njoftohet me një mjek të bukur me të cilin do të martohet.

Pas pak e pashë djepin si përkundej ngadalë, tepër ngadalë. Nuk e kuptoja nëse gjatë asaj kohe isha zgjuar apo fjetur, pasi kufiri në mes reales dhe ireales në mendjen time nuk ekzistonte. E kuptova se ai djep kishte një kohë të gjatë që përkundej, po nga amullia që më kishte kapluar nuk kisha qenë një gjendje ta shihja. Në një çast më ngjau sikur në djep gjendej Miri, vëllai im, i cili lindi dy vjet pas meje e për lindjen e të cilit u pata gëzuar aq shumë sa kisha frikë se nga gëzimi i madh do të çmendesha. Mirëpo një ditë kur u zgjova në mëngjes djepin në të cilin flinte ai ishte i zbrazët. Nga shqetësimi flokët m'u çuan përpjetë. Nuk vonoi e në dhomë hyri babai i cili me zë të mallëngjyer më tha: nëna jote e mori vëllain tënde e u largua nga shtëpia pa më treguar asgjë. Pasi kaluan disa vite e humbëm shpresën se nëna një ditë do të kthehej në shtëpi. Dy vjet pasi babai vendosi të martohej me një grua tjetër, nëna u kthye në shtëpi, po pa vëllain. Dukej tepër e dëshpër-ruar. Rrobat i kishte të leckosura. Flokët e pakrehura. Fytyrën e nxirë. I ngjante një endacakeje të pastrehë, e cila netët i ka kaluar në qiellin e hapur, në shi e në borë. Babai e pyeti për vëllain, po ajo nuk nxori asnjë zë nga goja. Pas pak zuri të dëneste me zë të përvajshëm, i cili i buronte nga zemra e plasur. Shtatë muaj nëna qëndroi në shtëpi e kredhur në vorbullën e një heshtjeje të çuditshme. Pas shtatë muajve tha: djalin ia dhash babait të vet, i cili jeton përtej shtatë bjeshkëve! Ai erdhi një ditë në shtëpi kur isha vetë dhe m'u kërcënua se do të më vriste nëse nuk largohesha bashkë me të dhe fëmijën. Nga frika se do të më vriste mua dhe Mirin u desh të shkojë pas tij. Udhëtuam katër ditë e katër net me tren. Një ditë e një natë pastaj udhëtuam me një anije. Tërë kohën as ai, as unë nuk kemi nxjerrë asnjë zë nga goja. Miri herë pas here më pyeste pse ishim larguar nga shtëpia dhe ku ishim duke shkuar. Megjithatë unë ia bëja me shenjë që të mos fliste asnjë fjalë. Të dërrmuar nga rruga e gjatë, e cila m'u duk se nuk do të përfundonte kurrë, arritëm në një fshat malor. Ecëm disa çaste nëpër një rrugë të ngushtë, e cila rrethohej me disa shtëpi të vjetra, disa nga të cilat ishin të lyera me baltë. O zot, sa shumë u frikësova kur hymë në një shtëpi të vjetër, e cila gjendej afër një kodre të lartë, e cila e pengonte diellin të shfaqej gjatë pjesës më të madhe të ditës. Kur hymë brenda në atë shtëpi m'u bë sikur hymë në një varr për së gjalli. Më kot u pendova që shkova pas atij njeriu, me të cilin kisha pasur një lidhje të fshehtë, për të

Fragment nga romani, BUZUKU, 2026

BISER MEHMETI

Drita e zezë



cilën nuk dua të flas asnjë fjalë, sepse më vjen turp. Jeta në atë shtëpi për mua ishte një denim i rëndë, të cilin ia shqiptova vetes për një gabim që e bëra kur nuk duhej ta bëja. Pas katër muajve i thashë vetes: do të gjej një mënyrë që të arratisem nga ky ferr mbi tokë ose do të ngjitem në një kodër të lartë e do të bëj vetvrasje. Një ditë kur mbeta vetëm në shtëpi, ngase Miri dhe babai i tij kishin dal për gjah, i thashë vetes: edhe nëse gjatë rrugës vdes do të nisem të kthehem në shtëpi. Më mirë e vdekur sesa të jetoj në këtë vend të shkëputur nga bota. Gjatë gjithë ditës qëndroja mbyllur në shtëpi. Njeri i gjallë nuk hynte as nuk dilte nga ajo shtëpi e vjetër, në të cilën kam bindje sikur tërë kohën sorollatej një mall-kim i vjetër. Kur arrita te anija pata fat, sepse u takova me një kushëri të largët, i cili më ndihmoi të kthehesha në shtëpi. E di që më urreni pse e kam mbajtur të fshehur për një kohë të gjatë një gjë të këfillë, po nuk kisha çfarë të bëja.

Nuk më kujtohet pas sa kohësh nëna erdhi te shtrati ku qëndroja e shtrirë tash e një kohë të gjatë. Në fytyrën e saj e shihja lumturinë si lodronte pa pra. Sa herë e shihja nënën të gëzuar gëzohesha edhe unë. Edhe kur e shihja të hidhëruar hidhërohesha edhe unë. Gjithnjë kam menduar se unë e nëna jemi një shpirt i ndarë në dy pjesë të barabarta. Disa herë një mendje më thoshte: nëse vdes unë atëherë do të vdes edhe nëna!

– Bija ime, sa shumë po gëzohem që e solle në jetë fëmijën tënd... është vajzë, siç ke pasur ti dëshirë. Driti e ka pagëzuar me emrin Dora. Tha se kështu ke pasur dëshirë ti gjatë kohës sa ke qenë shtatzënë. Edhe mua më pëlqeu ky emër. Eh, sa shumë ke përjetuar vuajtje të tmerrshme derisa e solle në jetë sa kam dyshuar se do të vdesësh. Mjekët tërë kohën kanë qëndruar te koka jote të shqetësuar shumë. Njëri prej tyre më tha: gjasat për të shpëtuar janë shumë të vogla, sepse ka një sëmundje të rëndë. Ke pasur dhimbje të tmerrshme sa nuk ta merr mendja. Dy herë kam lindur, po asnjëherë nuk kam pasur dhimbje të tilla. Kur të kam lindur ty, nuk kam ndier kurrfarë dhimbjeje... sikur të mos e dëgjoja vajin tënd nuk do të kisha besuar se të kam sjellë në jetë. Sa shumë po pikëllohem që nuk je në gjendje të ngrihesh nga shtrati e ta përkundësh vajzën tënde në djep. Mirëpo, shpresoj shumë që një ditë të shërohesh e të ngrihesh nga ky shtrat i mallkuar që ta përqafosh fëmijën tënd, pastaj ta përkundësh e t'i këndosh ninulla, siç të kam kënduar unë ty dikur. Ndoshta nuk ke harruar se në këtë djep dikur të kam përkundur edhe ty... ndoshta gjatë kohës sa ke qëndruar pa ndjeja si në ëndërr e ke dëgjuar zërin tim si i këndon ninulla vajzës tënde, e cila është e bukur si hëna.

Sa kisha dëshirë ta dëgjoja edhe më tutje

zërin e ëmbël të nënës, po nuk isha në gjendje ta dëgjoja. Një mendje më thoshte sikur prej lindjes kisha jetuar në botën e heshtjes relative, të asaj heshtjeje të vdekur që më miklonte ditë e natë me duart të gjymta e pastaj sikur mوندohet të më ngushëllonte për fatkeqësinë që më kishte pllakosur. Nuk je vetëm e shurdhër, po je edhe memece, më tha një zë me tinguj të vrazhdë. Nuk ke lindur as e shurdhër, as memece, po gjatë procesit të lindjes së fëmijës ndodhën disa komplikime të rënda gjatë së cilës e humbe dëgjimin dhe të folurit. Sa keq që nuk je në gjendje t'i flasësh as nënës, as fëmijës tënd, i cili sa herë e rrëmben në përqaftim të fletë me zë të këndshëm, po ti gjithnjë e vështron e habitur dhe nga trishtimi që nuk je në gjenjide t'i flasësh asgjë, lotët të shkojnë rrëke nëpër fytyrë e pastaj e mallkon fëmijën tënd që të shkaktoi fatkeqësi të madhe. Fëmija yt në vend që të të sillte kënaqësi të solli fatkeqësi. Disa nëna fatkeqësisht janë të denuara për të lindur fëmijën e tyre duhet të vdesin vetë. Kjo është e tmerrshme, po kështu funksionojnë ligjet e natyrës së vrazhdë. Ka njerëz që prej lindjes e deri në vdekje nuk përjetojnë asnjë çast lumturie dhe ky është një mister i madh të cilin nuk është në gjendje ta zbërthejë askush. Të pakët janë njerëzit që nuk e shijojnë helmin e dhimbjes kryeneçe. Njerëzit janë të denuar gjatë gjithë jetës së tyre të kërkojnë lumturinë, megjithatë askush prej tyre nuk është në gjendje ta gjejë burimin e saj. Kam filluar të dyshoj sikur lumturia nuk ekziston fare, madje sikur atë e kanë trilluar njerëzit për ta ngushëlluar shpirtin e vrrarë. Lumturia është vetëm iluzion që shfaqet në një skaj të mendjes e pastaj zhduket sa çel e mbyll sytë. Ne kot vrapojmë tërë jetën pas saj, kurse ajo ikën prej neve si e marrë. Edhe shumë gjëra të tjera në botë ekzistojnë, po njerëzit nuk janë në gjendje t'i gjejnë. Eh, kjo botë është e mbushur me gjëra të mistershme...

Do të kisha notuar si një peshk i ngordhur nëpër detin e mendimeve që më rëndonin si një gur i varrit sikur në një çast të mos e shihja nënën si e largoi shikimin nga djepi në të cilin vajza ime bënte një gjumë të ëmbël. Shikimin e rënduar me copat e kujtimeve e orientoi drejt meje. O zot, kur shikimet tona u ndeshën në mes veti, më duket sikur po tretesha si vesa e mëngjesit, sikur po zhdukesh nga kjo botë pa lënë gjurmë. Nuk jam në gjendje të kuptoj çfarë magjie të madhe kishte shikimi i nënës. Megjithatë e vetmja gjë që mund të them është se shikimi i saj nuk ishte i zakonshëm. Ishte diçka përtej së zakonshmes, përtej kohës e përtej çdo gjë magjepëse. Sa shumë kisha dëshirë të gëzohesha, po kisha frikë sikur pas çdo gëzimi të madh do të më ndodhte një pikëllim i madh. Edhe ditën kur kuptova që mbeta shtatzënë më kaploi

një gëzim i madh, po në atë çast i thashë vetes: nuk duhet të gëzohem, sepse gëzimi i madh sjell një pikëllim të madh. Kurrë nuk e kam kuptuar pse ndodh një gjë e këfillë. Çfarë misteri fshihet brenda kësaj?! Shikimi i nënës ka arritur të depërtojë thellë në skajet më të errëta të shpirtit e pastaj të më sjell një ngrohtësi të çuditshme, të cilën nuk e kisha ndier kurrë në jetën time, madje as atëherë kur për herë të parë më kishte marrë në duar e më kishte përqaftuar...

Nëna e ka zgjatur dorën e majtë drejt meje. Sa shumë dëshiroja ta zgjasja dorën time e ta shtërngoja si në kohën e fëmijërisë atë dorë të dashur, po dora ime ishte e paralizuar. Diçka më thoshte sikur edhe shpirti më ishte paralizuar. A është e mundur çdo gjë të jetë para-lizuar në këtë botë, e pyeta veten derisa orvatesha ta mbysja dëshpërimin që po më robëronte. Po, po, edhe koha është paralizuar, edhe toka është paralizuar, edhe njerëzit janë paralizuar. Diçka më thoshte sikur unë dhe nëna kishte disa vjet që qëndronim të shtangura si statuja antike duke e mbajtur dorën e zgjatur drejt njëra-tjetrës, edhe pse e dinim se kurrë nuk do të mund t'i shtërngonim. Ndoshta një gjë e këfillë mund të ndodhte vetëm pas vdekjes sonë, e cila më dukej sikur tërë kohën na vështronte nga një skaj i dhomës së mbushur me aromë të athët ilaçesh. A është e mundur unë e ajo të jemi pjesë e një legjende për të cilën nuk jam e sigurt kur e kam lexuar. Dihet se në të gjitha legjendat ka shumëçka të vërteta. Ato janë pjesë e jetës së njerëzve që kanë jetuar para shumë kohësh.

U mundova të nxjerr një zë nga goja e shkrumbuar, po nuk isha në gjendje të nxirrja asnjë tingull. Në atë mënyrë dëshiroj t'i tregoj nënës se isha e lumtur që po e shihja sërish duke qëndruar afër meje. O zot, i thashë vetes, a ke gjë më të tmerrshme sesa të mos mund t'i thyesh muret e heshtjes...

– Bija ime e dashur, jam frikësuar se kur të kthehesh në shtëpinë e lindjes trupin tim do ta gjesh nën dhe... kisha frikë se dhimbja për ty do të më mbyste... zemra më dilte nga kraharori kur të shihja të shtrirë në shtrat me sy të mbyllur, tamam si të ishe një kufromë që ka mbetur pa u varrosur. Disa herë dyshoja se nuk merrje frymë. Shpeshherë dyshesha sikur ti nuk ishe e vërtetë, sikur mendja ime nga mallëngjimi i madh trillonte gjëra që nuk ekzistonin në botën reale. Sa shumë njerëz të dashur kanë vdekur e janë varrosur, kurse ti nuk ke qenë në varrimin e tyre... Babai im, i cili është dergjuar dy vjet në shtrat e te i cili shumë rralë kam mundur të shkoj për shkak tëndin, vdiq para dy javësh... Eh, vdiq me mall për të të parë ty në këmbët e tua! Fjalët e fundit që i nxori nga goja ishin: po vdes me mall për ta parë mbe-sën time të dashur, e cila po dergjet në shtratin e vdekjes! Edhe pasi e mbuluam me dhë nga varri dëgjoja zërin e tij si thoshte: nëse ndonjëherë mbesa ime arrin ta mposht vdekjen, thuaji le të vjen te varri im të vendos lule të freskëta, sepse vetëm atëherë do të jem në gjendje të gjej prehje në amshim... Edhe vëllai im Loni, i cili të ka dashur tepër shumë, dy vjet pasi ti u martove shkoi me disa shokë për të luftuar kundër armikut e prej asaj dite më nuk kam dëgjuar asnjë lajm për të. Kam frikë sikur ai ka kohë që ka vdekur nga plagët e marra në luftë, kurse trupi i tij ka mbetur mbi dhë ngase nuk ka pasur kush ta varrosë. Kam frikë se trupin e tij e kanë ngrënë korbat. Sa shumë më dhemb në shpirt që as varr nuk ka për të qarë! Megjithatë unë edhe më tutje për çdo mëngjes dal të dera duke shpresuar se ai do të kthehet nga lufta bashkë me shokët e vet. Një ditë një fqinj me të tha se lufta ka përfunduar para gjashtë muajve, një tjetër më tha: mos e humb shpresën se biri vëllai yt nuk është në mesin e shumë të vrrarëve. E gjora unë mbeta vetëm në shtëpi duke pritur vdekjen të më merrë me vete, po ajo si për inat nuk më merr.

Poezia dhe letërsia në jetën time janë shfaqur në një kohë krize, një krizë që ishte personale dhe kolektive njëkohësisht. Ishte një kohë kur shtigjet për të jetuar një jetë normale ishin të mbyllura, dhe unë, si njeriu që mëson kur kërkon shtigje, siç këshillon Franz Kafka, shtigjet i gjeta te letërsia.

Në atë kohë, gjithçka në jetën time ishte e mjegullt, e pakët, e varfër. Njerëzit flisnin për varfri, luftë, vrasje, ikje, ndërsa letërsia hapte një shteg para meje, duke më ofruar ngushëllim. I tmerruar prej realiteti, zemrën ma rrëmbeu arti dhe ideja e parë që formova për artin lidhet pikërisht me lirinë. Më vonë, si lexues e pastaj si krijues, te letërsia gjeta, përveç lirisë, dritën për ta zhbërë errësirën e madhe dhe dashurinë për ta mundur urrejtjen.

Dihet, prej kohëve, se letërsia është e lidhur me eksperiencat dhe lidhja ime me letërsinë në përgjithësi dhe poezinë në veçanti, lidhet pikërisht me eksperiencat personal: përpjekjet për ta gjetur lirinë shpirtërore në kohën kur ajo mungonte në vendin tim, Kosovën, dritën kur errësira ishte e madhe dhe dashurinë kur sundonte urrejtja.

Shpesh, kur kthehem prapa në kohë, i them vetes se letërsia ma ka shpëtuar jetën dhe dëgjoj si më tingëllojnë në zemër dy vargje të shkrimtarit Czeslaw Milosz, laureat i Çmimit Nobel për letërsi, te poezia *Dedikim*:

Ç’është poezia që nuk shpëton

Kombet apo njerëzit?

Veç një sajese e gënjeshtreve zyrtare.

Dhe i them vetes: poezia më ruajti mua, por edhe popullin tim. Sepse, në vitet e nëntëdhjeta, ne kishim një udhëheqës politik, që ishte shkrimtar, njeri i librave - Ibrahim Rugova - i cili përmes refuzimit estetik e krijoi një model të refuzimit politik. Ai vetë besonte te fuqia e fjalës, si arma e vetme në betejën për liri. Për një adoloshent si unë, ky besim ishte një forcë me përmasa pothuajse qiellore.

Dhe tani kur e pyes veten ose më pyet ndokush - si erdhi poezia e letërsia në jetën time?- kthehem në adoloshencën time dhe përpara më shfaqet romani “Kronikë në gur” i shkrimtarit të madh shqiptar, Ismail Kadare, ku ka një frazë goditëse: *“Ju nuk mund ta kuptoni dot se ç’do të thotë qytet i lirë, sepse ju rriteni në robëri”*. Jam vërtitë në këtë fjalë si në një mjegull të madhe, duke ndie thellë peshën e tragjizmit që përcillte, dhe më dukej sikur Kadare më drejtohej pikërisht mua, duke më thënë - se isha unë ai që nuk e kuptoja ç’do të thotë liri se po rritesha në robëri. Kjo fjalë më pikëlloi me pamasën e tragjizmit që ngërthente, por, në anën tjetër, romani i Kadaresë më magjepsi aq shumë sa e kam rilexuar disa herë.

Në këtë kohë, unë rashë në dashuri me poezinë e letërsinë, teksa përpiqesha ta kuptoja ose gjeja lirinë, që më mungonte në jetën reale.

Ishin vitet e nëntëdhjeta, gati një dekadë, kur unë kam jetuar pa liri fizike, por me lirinë që më jepte artit. Poezia, në ata tunel të pafund errësire m’u shfaq si dritë për ta orientuar vetveten që të mos vdisja në errësirë. Ishte një realitet i rëndë - fuqia shtypëse e kishte katandisë vendin tim në mjerim të madh, ku shtypeshin të gjitha liritë njerëzore. Asokohe, gjuha e urrejtjes dhe ndarjes, ishte e pranishme edhe në ajrin që e thithnim.

Realiteti ishte i ashpër. Një regjim shtypës e kishte katandisur atdheun tim në mjerim të thellë, ku, të gjitha liritë njerëzore ishin të cenuara dhe gjuha e urrejtjes dhe përçarjes ishte edhe në ajrin që e thithim. Gjatë kësaj kohe të vështirë, ne shqiptarët e Kosovës, ishim të privuar prej mundësisë që të shkonim në shkollë, gjimnazet dhe universiteti u kidnapua dhe ne filluam një sistem mësimi paralel nëpër shtëpi-shkollë. Pikërisht në këtë kohë, unë u arratisa në një realitet tjetër paralel, në botën e letërsisë, që më magjepsi: se ishte një botë shumë e pasur, krahasuar me atë realen, shumë të varfër. Dhe në këto kushte, u kurorëzua lidhja ime me letërsinë, si martesë nga një dashurie e

Poezia, hapësirë e lirisë, dritës dhe dashurisë

Nga Ndue Ukaj



madhe, në të cilën poezia mbetet kurora e kësaj lidhje.

Gjithmonë e mendoj poezinë si një aktivitet shëlbues njerëzor, si hapësirën më e bukur ku njeriu zhvillon betejat për liri të njëmend, një liri, që shfaqet në trajtat më sublime, përmes gjuhës së bukur e kohës pambarin.

Pse ky besimi te letërsia?

Arsyet, me siguri janë shumë dhe enigmatike, siç është vetë ekzistenca artit, por ka edhe një lidhje reale me fuqinë e poezisë dhe letërsisë në jetën e kombit shqiptar, në të cilin, ky aktivitet njerëzor, dhe gjuha, u bënë paradigma të kërkimeve për liri, të identitetit, kurse shkrimtarët shqiptarë, prej mesjetës së vonshme, përgjatë Rilindjes e deri në kohët moderne, ngjanin me role profetike. Shumë vjet më vonë, kur ne fituam lirinë fizike dhe unë u bëra shkrimtar, e lexova fjalën e shkrimtarit dhe nobelisti Isaac Bashevis Singer, të mbajtur në ceremoninë e Nobelit, ku ndër të tjera thoshte se “në historinë e letërsisë së vjetër hebraike kurrë nuk kishte pasur ndonjë dallim themelor midis poetit dhe profetit. Poezia jonë e lashtë shpesh bëhej ligj dhe një mënyrë jetë.” Në fakt, unë kisha jetuar me këtë përfytyrim për poezinë, përpara se ta njihja në thellësi, dhe arti që herët u bë një mënyrë jetese ku gjeja shëlbimin, një mënyrë jetese ku forma ishte e rëndësishme po aq sa përmbajtja.

Poeti i amerikan Walt Whitman – kërkon prej nesh si lexues e poetë - që kurrë të mos pushojmë së besuari se fjalët e poezisë mund ta ndryshojnë vërtet botën, prandaj ai i këshillon lexuesit që kurrë të mos pushojnë së ëndërruari, sepse ëndrrat na shpijnë kah një botë më e mirë dhe më e vërtetë. Një kërkesë e tillë në kushte sociale, kur vriten ëndrrat njerëzore, duket si një dritëz shprese.

Këtë lloj besimi kisha për poezinë, që kur u ngjiz ajo në mua - ndoshta kishte lindur bashkë me mua - si një dashuri e madhe drite, për ta ndriçuar errësirën, atë kohë, kur unë jetoja në terr e frikë të madhe dhe ankthin e sfidoja me armën e vetëm që kisha në dorë, letërsinë. Kështu, në rininë time, poezia u bë shprehje e lirisë dhe bijë e dritës, një përkufizim që atëkohë nuk e bëja, por e jetoja.

Atëherë kur koha reale duket se është ndalur, e vetmja kohë që ka kuptim është koha e letërsisë. Duke jetuar në një kohë shumë të vështirë, të varfër, ku izolimi është kryegjëja e jetës dhe gjuha e urrejtjes një barrierë që njerëzit i dehumanizon, është poezia një hapësirë lirie, drite e dashurie, por edhe një mundësi për t’i tejkaluar këto vështirësi. Unë besoj te forca e letërsisë dhe te mjetet e saj, që përherë më bëjnë të besoj se mund të kapërcehen atë pengesë. Dhe siç na thërret të kujtojmë shkrimtari Thomas S. Eliot, derisa gjuha përbën një barrierë,

është vetë poezia ajo që na jep një arsye për të provuar ta kapërcejmë atë pengesë. Përmes fuqisë së poezisë, unë kam kapërcyer pengesa të shumta dhe e kam gjetur lirinë në formën më sublime të mundshme, një dritë rrezatuese dhe një dashuri të madhe, që më ka mundësuar të udhëtoja nëpër udhët e Firences me Danten e të Pragës me Kafkën.

Pas shumë viteve, unë besoj më shumë si atëherë te kjo forcë e poezisë, por tash për arsye tjera: besoj se ky aktivitet njerëzor shërben si një mundësi për t’i tejkaluar pengesat e barrierat që i vendos gjuha, dhe në përkim me atë që thotë Mario Vargas Llosa, “jam i bindur se një shoqëri pa letërsi, ose një shoqëri në të cilën letërsia është lënë – si një ves i fshehur – në margjinat e jetës shoqërore dhe personale, dhe është transformuar në diçka si një kult sektar, është një shoqëri e dënuar të bëhet shpirtërisht barbare, dhe madje të rrezikojë lirinë e saj”, pra, besoj se letërsia mund ta nxisë ndjesinë e vëllazërisë, që ta njohim më mirë tjetrin dhe të gjejmë të pasuria e saj, të përbashkëtën humane.

Pra, lidhja im i parë me poezinë lidhet me idenë e lirisë, pastaj të dritës dhe në këtë mes, hyn kryegjëja, poezia, duke qenë një muzikë e jetës, dashuri dhe eros, në kuptimin edhe mitologjik dhe si agapizimi, në kuptimin kristian, një dashurie që nuk njeh kufizime.

Kështu, elementi i tretë, ndoshta motori që e vë në lëvizje njeriun, në kërkimet e tij për liri dhe dritë, është dashuria, dhe ashtu si drita që është burim i ekzistencës, dashuria është oksigjeni kryesor që i mirëmban krejt këto raporte, duke qenë jetëdhënëse, si dashuria ashtu edhe poezia.

Kështu, më duket sikur letërsia dhe dashuria njëjtësohen.

Ndoshta, ideja jonë për dashurinë, në kuptimin si e njohim atë, si ndjenjë sublime, ka burimin te Psalmet, ato Këngë të Këngëve, që i kanë mundësuar njerizimit t’i fisnikërojë ndjesitë për të bukurën dhe dashurinë, t’i njoh ëmbëlsinë e jetës dhe hidhërimit që shkakton humbja e saj.

Një poet i madh, poeti model, siç e kanë quajtur, Dante Alighieri, te Kënga 33 e Parajsës ka këtë varg: *“Dashunia, që lëviz diell e yje të vezullueshëm.”*

Shpesh mendoj **për këto** vargje dhe i analizoj në përkim me marrëdhëniet që ka krijuar ndër vite arti, letërsia e poezia shqipe, me ekzistencën shqiptare. Me ekzistencën time. Dhe kthehem në fillimet e letërsisë në gjuhën shqipe, që i përkasin mesjetës së vonshme, shekullit XVI, me disa priftërinj, që shkruan *për dashuni ndaj botës shqiptare*.

Mund të jetë si në fillime e kohëve është titulli i librit tim të fundit me poezi, që është botuar në Tiranë, vitin e kaluar. Sa herë shkruaj për poezi ose krijoj poezi, ndihem disi si në këtë kohë. Në zanafillë, në fillimet e kohëve, kur gjërave pa formë, imazheve të përfytyruara, ëndrrave e ndjesive, duhet t’iu

jap jetë, gjallëri, formë, në realitetin estetik.

Dhe shkruaj poezi sa herë një forcë misterioze brenda meje kërkon t’i nxjerrë jashtë mendimet e mia. Për shembull, shoh një gjethe të bukur vjeshte që këputet prej një degë dhe era e hedh në baltë dhe mendoj për atë ekzistencë. Është një ekzistencë misterioze, njëherësh magjike, sepse e di se në pranverën e re që e pres, ajo pemë sërish mbushet me jetë, me gjethe të reja. Por çfarë ndodh me gjethet që bien nga jeta e një njeriu? Kjo pyetje më shtang dhe mu këtu ndodh të lindë poezia.

Prandaj, vazhdoj te besoj se ne kemi nevojë për poezi, për arsye të pafundme, por paragjithash për të ruajtur të bukurën dhe humanizmin tonë. Sepse, një shoqëri që e heq poezinë, rrezikon të bëjë vetëvrasje shpirtërore, porositë Octavio Paz. Thënë ndryshe, shoqëria sa herë nuk ajroset prej bukurisë së poezisë, jeton në një atmosferë të tymosur dhe lëngon. Se poezia është oksigjen për mendjen e zemrën, se ajo ka ndriçon shumë errësira njerëzore, shpreh ndjesi të pashprehshme, regjistron në repertorin e vet të vërtetat më të mëdha se ato që i regjistron historia, sipas Aristotelit, dhe i jep mundësi njeriut përherë që të ëndërrojë për një botë më të mirë e më të lirë.

Në këtë drejtim, shkrimtarë të ndryshëm, në kohë të ndryshme, kanë përmendur dobi të shumta që jep poezia për njeriun, duke thënë se ajo e zhvillon aftësinë për të soditur dhe për të jetuar me kujtesën dhe “nuk mëson asgjë, përveç domethënies së jetës” Henry Miller).

Ka ndodhur shpesh që lexues të më pyesin:

Si ishte e mundur të besojte te letërsia, kur jeta reale ishte aq e ashpër?

Dhe sa herë përpiqem të artikuloj një përgjigje, më duket se fjalitë mbesin të varfra dhe nuk mund të këmbehen me të vërtetën e madhe me të cilën më mbështolli poezia atë kohë të pakohë, një kohë kur arti m’i dha sytë ndriçues që ta zhbëja errësirën ku jetoja, m’i dha krahët të fluturoja përtej kohës time e matanë kufijve dhe të përjetoja shumë realitete e jetë njerëzore, të ecja rrugëve të ferrit, duke ndjekë shenjat e poezisë, që kryenin për mua ato detyra që kryente Virgjili në ferrin e Dantes.

Secila kohë e shkruan poezinë e vet, që merr jetë përmes realitetit, duke shprehë gjakimet, ëndrrat, të pamundshmet e të mundshmet, duke dëshmuar njëherësh fizionominë reale të secilës kohë. Koha jonë letrare, ka detyra, që t’i përtërijë lidhjet e bukura që i krijon letërsia mes njerëzve dhe ta ushqej botën me të bukurën jetëdhënëse të artit. Poezia është ajo që e bën jetën më të bukur, më të vlefshme dhe edukon njeriun me ndjenjat e lirisë. Ne kemi nevojë për këtë edukim, si për ajër të pastër. Dhe unë vazhdoj të besoj se poezia mund të jetë shprehje e shpresës në një kohë apokaliptike, në një kohë kur cektësia tenton t’ia zë vendin thellësisë dhe gjuha e varfër e skematike, gjuhës së pasur të poezisë.

Shkrimtari Jorge Luis Borges, te ligjërata e famshme për poezinë, thotë se “estetika është aq e qartë, aq e drejtpërdrejtë dhe aq e papërcaktueshme, sikurse dashuria, sikur shija e një fryti, sikur uji. Ne ndjejmë poezinë, ashtu sikur e ndjejmë afërsinë e një femre ose sikur e ndjejmë aromën e maleve apo thellësinë e detit.”

Secili lexues i poezisë e ndien këtë përmasë të hatashme të estetikës dhe, ajo që është kryesorja, e mëson njeriun të kërkojë *shtegdalje*, dhe shtegdaljen më të mirë prej amullisë shpirtërore e dehumanizimit, e mëson poezia. Këtë derë, si lexues e poet, përpiqem ta mbaj të hapur përherë. Se poezia më ka mësuar të gjej shtegdalje në momente errësire, më ka mësuar të gjej brigjet e qetësisë, kur kishte dallgë të mëdha të jetës.

Kësaj force të letërsisë i blatohem përgjithmonë.

(Ky tekst është botuar si ese i javës në Versopolis - European Review of Poetry, Books and Culture - një revistë letrare paneuropiane që botohet online.)

Në vitin 1964, Zhan Pol Sartri refuzoi Çmimin Nobel për Letërsi që iu dha dhe u shpjegoi gazetarëve arsyet e vendimit të tij.

“Më vjen shumë keq që çështja mori përmasat e një skandali: çmimi jepet, ndërsa fituesi e refuzon.

Arsyeja është se nuk më njoftuan paraprakisht për atë që po përgatitej. Kur, në numrin e 15 tetorit të ‘Figaro Littéraire’, lexova njoftimin e korrespondentit të saj në Stokholm, ku thuhej se Akademia Suedeze po anonte nga kandidatura ime, por se zgjedhja përfundimtare ende nuk ishte bërë, mendova se, duke i shkruar një letër Akademisë - të cilën e dërgova të nesërmen, - mund ta ndreqja situatën në mënyrë që të mos kishte më nevojë t’i riktheheshim kësaj çështjeje.

Atëherë ende nuk e dija se Çmimi Nobel jepet pavarësisht nga mendimi i fituesit të ardhshëm dhe mendoja se ende mund ta pengoja këtë. Por e kuptoj fare mirë se, pasi Akademia Suedeze e ka bërë zgjedhjen e saj, nuk mund të tërhiqet më prej saj. Siç e shpjegova në letrën drejtuar Akademisë, arsyet për të cilat e refuzoj çmimin nuk kanë të bëjnë as me Akademinë Suedeze, as me Çmimin Nobel si të tillë. Në atë letër përmenda dy lloje arsyeshe: personale dhe objektive.”

Arsyet personale

Refuzimi im nuk është aspak një veprim i Rpmenduar, sepse unë gjithmonë i kam refuzuar shenjat zyrtare të nderimit. Kur, pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945, më propozuan Urdhrin e Legjionit të Nderit, e refuzova, megjithëse kisha miq në qeveri. Nuk kam dashur kurrë të hyj në Collège de France, siç më propozonin disa prej miqve të mi.

Në themel të këtij qëndrimi qëndron koncepti im për punën e shkrimtarit. Një shkrimtar që ka mbajtur një qëndrim të caktuar në fushën politike, shoqërore ose kulturore duhet të veprojë vetëm me ato mjete që i përkasin atij dhe vetëm atij, domethënë me fjalën e shtypur.

Të gjitha llojet e shenjave të nderimit ushtrojnë mbi lexuesit e tij një trysni, të cilën unë e konsideroj të padëshirueshme. Ka një ndryshim ndërmjet firmës “Zhan Pol Sartri” dhe firmës “Zhan Pol Sartri, laureat i Çmimit Nobel”.

Duke pranuar një shenjë nderimi të këtij lloji, shkrimtari lidh me veten edhe shoqatën ose institucionin që e ka nderuar. Kështu, simpatia ime për partizanët venezuelianë më përket vetëm mua. Mirëpo, nëse “Zhan-Pol Sartri, laureat i Çmimit Nobel” del në mbrojtje të rezistencës venezueliane, ai përfshin së bashku me veten edhe vetë institucionin e Çmimit Nobel.

Shkrimtari nuk duhet të lejojë që ta shndërrojë në një institucion, edhe kur kjo, si në rastin konkret, merr format më të nderuara.

Është e qartë se ky është një qëndrim krejtësisht personal, i cili nuk përmban asnjë kritikë ndaj atyre që janë nderuar tashmë me këtë çmim. Kam respekt të thellë dhe admirim për shumë laureatë që kam nderin t’i njoh.

Arsyet objektive

Në kohën e sotme, e vetmja formë e mundshme e luftës në frontin kulturor është lufta për bashkëjetesën paqësore të dy kulturave: asaj lindore dhe asaj perëndimore. Me këtë nuk dua të them se është i nevojshëm vëllazërimi i kulturave. E kuptoj fare mirë se vetë përballja ndërmjet këtyre dy kulturave duhet të marrë në mënyrë të pashmangshme formën e një konflikti. Por kjo përballje duhet të

zhvillohet ndërmjet njerëzve dhe kulturave, pa ndërhyrjen e institucioneve.

Unë vetë e ndiej thellësisht kundërthënien ndërmjet këtyre dy kulturave: jam vetë produkt i këtyre kundërthënieve. Simpatitë e mia anojnë në mënyrë të pashmangshme nga socializmi dhe nga i ashtuquajti bllok lindor, por kam lindur dhe jam rritur në një familje borgjeze. Pikërisht kjo më lejon të bashkëpunoj me të gjithë ata që dëshirojnë afrimin e dy kulturave. Megjithatë, natyrisht, shpresoj se do të “fitojë më i miri”, domethënë socializmi.

Prandaj nuk dua të pranoj asnjë çmim as nga instancat më të larta kulturore të Lindjes, as nga ato të Perëndimit, megjithëse e kuptoj fare mirë se ato ekzistojnë. Edhe pse të gjitha simpatitë e mia janë në anën e socializmit, po aq sa nuk mund të pranoja Çmimin Nobel, nuk do të mund të pranoja, për shembull, as Çmimin Lenin, sikur dikush të ma propozonte papritur.

E kuptoj mirë se Çmimi Nobel, në vetvete, nuk është një çmim letrar i bllokut perëndimor, por është shndërruar në të tillë dhe, për këtë arsye, janë bërë të mundura ngjarje që dalin jashtë kontrollit të Akademisë Suedeze.

Ja përse, në rrethanat e tanishme, Çmimi Nobel përfaqëson në të vërtetë një çmim të destinuar për shkrimtarët e Perëndimit ose për “rebelët” e Lindjes. Për shembull, nuk u nderua Neruda, një nga poetët më të mëdhenj të Amerikës së Jugut. Kandidatura e Aragonit nuk u diskutua kurrë seriozisht, megjithëse ai e meriton plotësisht këtë çmim. Është për të ardhur keq që Çmimi Nobel iu dha Pasternakut dhe jo Shollohovit, si dhe që e vetmja vepër sovjetike e nderuar me këtë çmim ishte një libër i botuar jashtë vendit dhe i ndaluar në atdheun e vet. Baraspesha mund të ishte rivendosur me një gjest të ngjashëm, por me domethënie të kundërt.

Gjatë luftës në Algjeri, kur unë dhe të

tjerë nënshkruam “Manifestin e 121-shit”, do ta kisha pranuar me mirënjohje këtë çmim, sepse në këtë mënyrë nuk do të isha nderuar vetëm unë, por do të ishte lartësuar edhe çështja e lirisë për të cilën luftonim. Por kjo nuk ndodhi dhe çmimi m’u dha kur lufta kishte përfunduar tashmë.

Liria dhe paratë

Në arsyetimin e Akademisë Suedeze flitet për lirinë: kjo fjalë mund të interpretohet në shumë mënyra. Në Perëndim ajo kuptohet vetëm si liri në përgjithësi. Sa më përket mua, lirinë e kuptoj në një plan më konkret - si të drejtën për të pasur më shumë se një palë këpucë dhe për të ngrënë sipas oreksit.

Më duket më pak e rrezikshme ta refuzoj çmimin sesa ta pranoj. Po ta pranoja, kjo do të nënkuptonte të pranoja atë që do ta quaja “kompensim objektiv të dëmeve”. Në “Figaro Littéraire” lexova se “e kaluara ime e diskutueshme politike nuk do të më merret për të keq”. E di se ky artikull nuk shpreh mendimin e Akademisë, por ai tregon qartë se në ç’kuptim do të interpretohej pranimi im në disa qarqe të djathta. Unë mendoj se kjo “e kaluar e diskutueshme politike” vazhdon të mbetet ende në fuqi, megjithëse jam i gatshëm të pranoj para shokëve të mi disa gabime të bëra në të kaluarën.


Me këtë nuk dua të them se Çmimi Nobel është një “çmim borgjez”. Por një interpretim të tillë borgjez do t’ia jepnin në mënyrë krejt të pashmangshme qarqe që unë i njoh mirë.

Së fundi, vij te çështja e parave: Akademia Suedeze vendos një barrë të rëndë mbi supet e laureatit, duke i shtuar nderimit të përgjithshëm një shumë të madhe parash. Ky problem më ka munduar. Ose ta pranoja çmimin dhe ta përdorja shumën e marrë për të mbështetur lëvizje dhe organizata, veprimtaria e të cilave konsiderohet e rëndësishme. Personalisht, mendoja për Komitetin e Londrës për Luftën kundër Aparteidit. Ose ta refuzoja në përputhje me parimet e përgjithshme dhe ta privoja këtë lëvizje nga një mbështetje për të cilën ajo do të kishte nevojë.

Por mendoj se kjo është një alternativë e rreme. Natyrisht, heq dorë nga 250 mijë korona, sepse nuk dua të lidhem zyrtarisht as me bllokun lindor, as me atë perëndimor. Por, njëkohësisht, nuk mund të më kërkohet që, për 250 mijë korona, të heq dorë nga parime që nuk janë vetëm të miat, por që ndahen edhe nga të gjithë shokët e mi.

Të gjitha këto e bënë veçanërisht të rëndë për mua si dhënien e çmimit, ashtu edhe refuzimin me të cilin jam i detyruar ta pres atë. Dua ta përfundoj këtë deklaratë duke shprehur simpatinë time për publikun suedez.”

Përkthimi © ExLibris



Hajnrih Bël, në një letër drejtuar përkthyesit Peter Urban, i cili kishte përgatitur botimin e plotë në gjermanisht të veprave të Çehovit, shkruan:

28 dhjetor 1983

I dashur zoti Urban,
As ju, as unë nuk mund t'i zgjidhim apo t'i zbusim ato marrëdhënie të çuditshme e të tendosura që më lidhin me Moskën, për të cilat jam vetë fajtor. E di që, si autor, zë atje një vend të caktuar, të cilin e kam "pushtuar" prej kohësh, natyrisht pa kurrfarë dhune. Në të vërtetë, kjo ndodhi krejt pa pjesëmarrjen time, dhe ndikimi im atje i ngjan veprimit të Kalit të Trojës. Nuk e dëshirova aspak këtë; thjesht kështu ndodhi vetvetiu, si të thuash, nga vetë natyra e gjërave.

Megjithatë, ndonëse vendi im atje është i qëndrueshëm, librat e mi, për keqardhjen time të madhe, janë bërë të rrallë. Kjo është jashtëzakonisht për të ardhur keq edhe sepse besoj se i përkas edhe kulturës së tyre.

Për Çehovin do të shkruaj me kënaqësi. Dhe le të bëhet ky improvizim imi për ju një ngushëllim dhe një "vlerësim zyrtar" që mund të botohet.

Dikur, në rini, kur isha rreth shtatëmbëdhjetë apo tetëmbëdhjetë vjeç, nëpërmjet një katalogu sendesh të vjetra – nuk kisha para për të blerë libra në librari – bleva për dy para disa vëllime të vogla me tregime të Çehovit. Ato më magjepsën jashtëzakonisht, por në atë kohë mbetën të pakuptueshme për mua. Ai Çehov më dukej tepër "i thatë", i ftohtë dhe disi rutinor. Përfundimet "e hapura" më shpëtonin, më dukeshin të mjegullta e të papërcaktuara.

Por, kur i lexova më vonë, pikërisht në këtë paqartësi zbulova forcën e prozës

Më 15 korrik 1904 (44 vjeç) Anton Çehov u nda nga jeta në Badenweiler, Gjermani


Hajnrih Bël për Çehovin

Laureati i Çmimit Nobel, shkrimtari dhe poeti - për vendin e tij në kulturën ruse, ngjashmërinë e Çehovit me Shopenin dhe përse punonjësit e organeve represive duhet medoemos të lexojnë "Ishullin Sahalin".

së Çehovit. Pikërisht këto përfundime të mjegullta më çuan te krahasimi: Çehovi është akuairelisti i madh ndër shkrimtarët e shekullit XIX.

Dhe nuk është rastësi që në trashëgiminë e tij jashtëzakonisht të gjerë, ndoshta një nga më të gjerat që njoh, një vend të veçantë e serioz zë përmbledhja me skica "Ishulli Sahalin". Këtu më lind një përfytyrim muzikor: Çehovin do ta krahasoja me Shopenin, të cilin tepër lehtë e renditin ndër kompozitorët "joseriozë".

Kur, në vitet e mëvonshme, e rilexova Çehovin, e kuptova se skicat, shënimet, figurat dhe përshkrimet e panumërta të qyteteve provinciale e të jetës fshatare, si në tregimet "Joniçi", "Violina e Rotshildit", "Fshatarët", "Në rrugë", "Pushuesit e verës", "Foleja e kulakëve", janë më pranë "Rusisë së vërtetë" sesa trajtimet e problemeve, figurave dhe ideve të mëdha, të cilat janë njëloj karakteristike për njeriun kudo, si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje, si te sllavët, ashtu edhe te antisllavët.



Kudo ato janë tendencioze, të ngarkuara ideologjikisht dhe dogmatike, siç u ka hije ideve të mëdha. Pikërisht në lidhje me këtë, Çehovin e konsideroj një realist më të madh se, të themi, Gorkin, duke u nisur nga hamendësimi se e dimë çfarë nënkupton


koncepti "realizëm" dhe se nuk kemi nevojë të debatojmë me javë të tëra për të. Ndërsa Gorki më duket më tepër "natyralist".

Dramat e Çehovit parapëlqej më shumë t'i lexoj sesa t'i shoh në skenë. Gjatë leximit jam më i aftë ta kuptoj e ta kap atë që është e mjegullt, mezi e ravijëzuar, e shprehur me aluzione dhe e thënë me pëshpërimë. Sa u përket vënieve në skenë, gjithmonë duhet pasur frikë se regjisori do të vërë në skenë vetveten dhe jo Çehovin.

Gjithçka të Çehovi është e mbuluar nga një tis melankolie pothuajse metafizike, falë së cilës kalimtarja bëhet e përjetshme. Ajo që më mahnit gjithashtu është zelli i tij i jashtëzakonshëm dhe vetëdija e tij si mjek dhe kronikan, kur shkruan për Sahalinin. "Ishullin Sahalin" duhet ta lexojë patjetër kushdo që, në çfarëdo vendi dhe në çfarëdo kohe, është përballur ose merret me të ashtuquajturin ekzekutim të dënimeve.


Përkthimi © ExLibris

Karikaturë nga Arben Mexsi



I. S. Turgeniev

Ditari i një njeriu të tepërt



Trishtil